DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 336 • VITI 32 • NËNTOR 2018 • SEFER - REBIUL EVVEL 1440 • ÇMIMI 1 €

Urime për Muajin e Mevludit!

Ky është Muhamedi a.s., i thjeshti, modesti…

E ke parë në shtëpinë e tij duke larë rrobat, duke arnuar xhyben, duke mjelë delet dhe duke qepur këpucët... E ke parë duke ngrënë me shërbëtorin, duke vizituar të sëmurin dhe duke i dhënë nevojtarit... E ke parë duke u falur dhe nipi i tij t'i varej mbi shpinë, ndërkohë që ai ishte në sexhde, e linte derisa të ndalej dhe ai vazhdonte namazin e tij. Dhembshuria dhe dashuria ishin të mishëruara... I donte njerëzit dhe kafshët... madje edhe bima u përmallua për të dhe këshillonte që pemët të mos priteshin. Deri edhe gjërat e ngurta i përfshiu me dashuri, sepse thoshte për malin e Uhudit: "Ky mal na do ne dhe ne e duam atë". Madje edhe dheu i tokës, me të cilin fshinte fytyrën e tij duke marrë abdes me dashuri dhe thoshte: "Fshihuni me dheun e tokës, sepse ajo për ju është mëmë". Ky është ai i madhi, i cili nuk e pëlqente madhështinë dhe u thoshte shokëve të vet, kur ata i ngriheshin në këmbë: "Mos m'u ngrini në këmbë, siç ngrihen në këmbë të huajt për mbretërit e tyre". Ishte bujari, të cilin shokët e tij e përshkruanin, se ai shpenzonte në mirësi dhe nuk e kishte aspak frikë varfërinë... Nuk ka ndodhur kurrë, që ai të kursente ndonjë dërhem... Vdiq, siç dihet, dhe parzmorja e tij ishte peng te një hebre. Dhe jetoi e nuk u ngop asnjëherë. E nuk e shijoi bukën e elbit dy ditë rresht dhe megjithëkëtë nuk e refuzonte dhuratën, që i vinte prej ushqimit të shijshëm dhe prej rrobës së butë, por ai refuzonte të rendë pas jetës së luksit apo të mendonte për të e të zinte veten pas saj... Për këtë e edukonte veten dhe e praktikonte me varfëri, uri, maturi në kërkesa dhe dëshira, për të qenë shembulli dhe udhëzimi i asaj që dëshironte Islami. Fe e ekuilibrit dhe e mesatares. Nuk ka murgëri e as vetëvrasje. E as shkatërrim e rendje pas epsheve, por mesatare dhe ekuilibrim.

Dr. Mustafa Mahmud, nga libri "Rruga për në Qabe"

Në këtë numër:

2 Ky është Muhamedi a.s., i thjeshti, modesti...

4 Të përfitojmë nga butësia e Muhamedit a.s.

5 Fjala e Myftiu të Kosovës në manifestimin "Pejgamberi a.s. dhe rinia"

7 Fjala e kryetarit të Dijanet-it, Myftiut të Turqisë

9 Disa cilësi të Muhamedit a.s. të përmendura në Kuran

12 Komentimi i kaptinës "El-Hashr" – (5)

16 Muhamed Reshid Rida-ja

19 Cilësitë e injorancës, fanatizmi dhe diskriminimi, nuk i përkasin Islamit

22 Veprat e Imam Tahaviut

25 Rrethanat kohore në interpretimin e Kuranit nga Sherif Ahmeti

27 Dituria dhe vlera e saj nën prizmin e ajeteve kuranore dhe hadithe profetike

29 Paqja në praktikën e Muhamedit a.s.

31 Universalizmi i thirrjes islame

35 Nuk është lehtë të shkruaj për ty, o dritë e Allahut Mëshirëplotë

36 Rënkoi me vaj dhe druri

37 Shtypi shqip në Kosovë për sulmet e policisë serbe ndaj Medresesë "Alauddin" në Prishtinë

39 Përmbajtja, efekti dhe forma sulblime e Kuranit (2)

41 Organizimi administrativ i Perandorisë Osmane model shembullor i organizimit juridiko-politik

44 Vetëvrasja sipas Islamit dhe faktorët që shtyjnë drejt një akti të tillë

46 Aktivitete

62 Konkurse

63 Fjalëtërthore

DITURIA ISLAME
REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

Boton:
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë.

Kryeredaktor:
Dr. Ajni Sinani

Redaksia:
Ahmet Sadriu, mr. Ramadan Shkodra, mr. Azmir Jusufi, Mustafë Hajdari, mr. Ejup Haziri, mr. Vaxhide Bunjaku, mr. Vedat Shabani dhe dr. Valon Myrta.

Sekretar në redaksi:
Mr. Rexhep Suma

Lektor & Korrektor:
Ilmi Rexhepi

Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa:
Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84, 10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024
email: dituriaislame@hotmail.com
dituriaislame@yahoo.com
www.dituriaislame.com

Parapagimi:
Evropë 25 €
Amerikë 40 USA $

Shtypi:
Shtypshkronja "Iliri", Prishtinë

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen!

Të përfitojmë nga butësia e Muhamedit a.s.

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët."

(Et Tevbe: 128)

Rreth butësisë dhe mëshirës së Pejgamberit a.s. tij ndaj besimtarëve, Allahu i madhërishëm thotë: "Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do largoheshin prej teje." (Ali Imran: 159).

Muhamedi a.s. ishte ngarkuar me shpalljen më madhështore për të gjithë njerëzit, prandaj ai nuk ishte hakmarrës. Dëshira e tij ishte që t'i largonte nga mendjet dhe zemrat e njerëzve pengesat dhe drynat, që t'i shpëtonte të humburit dhe të hutuarit, prandaj agresorit i përgjigjej me falje, së keqes me të mirë.

Kur ishte kërkuar nga i dashuri i Allahut që të mallkonte, ai kishte thënë: "Unë nuk jam dërguar për të mallkuar. Unë jam pejgamber i mëshirës". Në betejën e Uhudit, sahabët i thanë: O i Dërguar i Allahut, a s'po i mallkon idhujtarët? Ai u qe përgjigjur: "Unë nuk jam dërguar si një mallkues, por si një thirrës dhe mëshirë! O Zoti im! Fale popullin tim se nuk di se ç'bën!"

Kur i Dërguari i Allahut kishte shkuar në Taif, për ta thirrur popullin e tij në fenë islame, ata kishin nxitur fëmijët e tyre që ta gjuanin me gurë. Xhebraili, më pas, i thotë Muhamedit (a.s.): "A ta shkatërroj këtë popull, duke i bashkuar këto dy bjeshkë njëra me tjetrën"? Ai thotë: "Unë nuk jam dërguar për ndëshkim, por për mëshirë". Madje, Pejgamberi (a.s.) lutet duke thënë: "Zoti Im! Sille në rrugë të vërtetë këtë popull. Unë shpresoj që nga ata të dalë një brez besimtarësh." Edhe me rastin e çlirimit të Mekës, ai, me zemërgjerësi, ua fali banorëve të saj të gjitha veprimet armiqësore duke u thënë: "Shkoni, jeni të lirë!" Qëllimi i tij ishte që njerëzit të pasonin të Vërtetën. Zoti na kujton këtë duke thënë: "Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Et Tevbe: 128)

Pejgamberi (a.s.) nuk përdori forcën, pavarësisht nga provokimet e munafikëve. Nuk i urdhëroi myslimanët që t'i luftonin apo t'i vrisnin ata, apo prijësit e tyre. Ai nuk ua konfiskoi pasurinë dhe as nuk u mohoi atyre ndonjë të drejtë. Ata gëzonin të drejta të plota si shtetas, siç i gëzonin të gjithë myslimanët e tjerë. Ata merrnin pjesë në xhami, jepnin opinionet e tyre për çështjet e bashkësisë dhe merrnin pjesën e tyre të presë së luftës nga arka shtetërore. Madje i Dërguari i Zotit sillej ndaj tyre me bamirësi dhe i trajtonte me një sjellje fisnike.

Enes ibn Maliku thotë se nuk kishte parë njeri më të mëshirshëm me të vegjlit se Pejgamberi a.s. Ai tregon se kishte një vëlla të vogël që quhej Umejr, i cili kishte një zog të vogël të sëmurë që quhej Nugejr. Pejgamberi (a.s.), sa herë që e takonte, e pyeste për Nugejrin. Një ditë Umejri po qante dhe Pejgamberi e pyeti: "Çfarë ke, o Umejr, që po qan?" Ai iu përgjigj: "Ka ngordhur Nugejri (zogu), o i Dërguar i Allahut…" Pejgamberi (a.s.) filloi të luante me të. Sahabët u çuditën kur panë se i Dërguari i Zotit po luante me një fëmijë dhe e pyetën: "Si është puna, o i Dërguar i Allahut"? Ai iu përgjigj: "Ka ngordhur Nugejri dhe unë desha që ta bëj Umejrin të luajë".

Me tolerancën, humanitetin, thjeshtësinë dhe çiltërsinë e tij, Pejgamberi a.s. arriti që të bënte për vete edhe armiqtë më të përbetuar.

Dr. Ajni Sinani

Fjala e Myftiu të Kosovës në manifestimin “Pejgamberi a.s. dhe rinia”

I nderuari kryetari i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë (Dijanet-it), Ali Erbash,

E nderuar përfaqësuese e ambasadës turke,

Të nderuar drejtues të institucioneve dhe organeve të BIK-ut,

Ju përfaqësues të pranisë turke në Kosovë,

Të nderuar imamë dhe nëpunës të Bashkësisë Islame,

Të nderuar pedagogë, nxënës e studentë,

Të respektuar bashkëpunëtorë të mi,

Vëllezër dhe motra,

Të nderuar të pranishëm!

Më lejoni që, në emrin e Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të institucioneve dhe organeve të saj dhe në emrin tim personal, nëpërmjet këtij manif-estimi t’ju uroj e t’ju përgëzoj për fillimin e aktiviteteve tona kushtuar lindjes së Pejgamberit tonë Muha-med Mustafasë alejhis selam.

Këto manifestime për këtë vit i hapim pikërisht sot nga ky vend ku jemi tubuar që bashkërisht të rikujtojmë ardhjen e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s..

Prandaj, në këtë natë kaq madhështore e shumë domethënëse, le ta madhërojmë Allahun dhe të kërkojmë bekimet e Tij, kurse përshëndetje, salate e selame, le t’i dërgojmë Pejgamberit të Tij të fundit, Muhamedit a.s., familjes së tij dhe të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Kiametit.

Ky manifestim sivjet bëhet edhe më i begatë, sepse në mesin tonë kemi një mysafir të veçantë, e kemi kryetarin e DIJANET-it, Ali ef. Erbashin, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, të cilët na kanë nderuar me praninë e tyre dhe këtë manifestim e kanë bërë edhe më madhështor dhe janë bërë bashkë me ne për të kujtuar jetën, veprën dhe misionin e të Dërguarit, Muhamedit a.s..

Të nderuar vëllezër e motra!

Besimtarët myslimanë anekënd botës 12 rebiul-evvelin e shënojnë me aktivitete të ndryshme, duke rikujtuar lindjen, jetën dhe misionin e të Dërguarit tonë të fundit, Muhamedit a.s., të cilit iu shpall nga Allahu xh.sh. Kurani e nëpërmjet tij edhe neve, që të na rregullojë jetën në këtë botë dhe të përgatitemi për botën tjetër.

Manifestimi i Ditëlindjes së Pejgamberit, Muhamedit alejhis selam, si tek të gjithë popujt myslimanë, edhe te populli ynë, ka një traditë po aq sa edhe prania e fesë islame në këto troje, dhe si i tillë është i shtresuar thellë në identitetin fetar e kulturor të populli tonë, aq sa ka marrë edhe karakter të një manifestimi thuajse gjithëpopullor, kjo për faktin se populli ynë tërë muajin rebiul-evvel e kalonte në përkujtim të Muhamedit a.s.

Nuk është e largët koha kur populli ynë, por edhe popujt përreth të besimit islam muajin rebiul-evvel e kalonin në kërkim të njohjes së Pejgamberit a.s., dhe këtë e bënin nëpërmjet derseve, ligjëratave, ibadeteve e debateve për dhe rreth jetës së Muhamedit a.s. për dhe rreth fesë e dinit islam.

Por s’ka dyshim se kontribut të madh në këtë drejtim kishte dhënë ulemaja jonë, që kishte emancipuar e vetëdijesuar dhe kishte përgatitur masën e besimtarëve shpirtërisht e emocionalisht për ta njohur, dashur, respektuar e çmuar ashtu siç e meriton Resullullahu a.s..

Kjo shihet më së miri nga veprat që ulemaja jonë i ka kushtuar Pejgam-

berit, Muahmedit a.s., si në prozë e poezi, në himne, gazele e kaside, nëpërmjet të cilave bëhej e mundur njohja më e afërt e personalitetit të Pejgamberit a.s., rritej dashuria për të, shtohej devocioni e përkushtimi ndaj tij. Për më tepër, ky korpus letrar kushtuar Muhamedit a.s. mësohej përmendsh e përsëritej gojë me gojë e brez pas brezi ndër besimtarë. Pa e përmendur këtu Mevludin si kategori e veçantë që u kultivua ndër shqiptarët dhe sot njohim mbi 30 autorë shqiptarë që kanë shkruar mevlude. Për më tepër, organizimi i mevludit qe kthyer në manifestim të përvitshëm tradicional dhe pikërisht për këtë muaji reibiul-evvel te ne është njohur dhe njihet si Muaji i Mevludit. Kështu, tani gjendemi në pjesën e parë të këtij muaji dhe pikërisht për këtë edhe po shënojmë dhe po manifestojmë Mevludin e Pejgamberit a.s..

Vëllezër e motra,

Të nderuar të pranishëm!

Kur kujtomë lindjen e Pejgamberia.s., kemi për synim që të njohim misionin e tij, mësimet e tij, sjelljet e tij, virtytet e cilësitë e tij, edebin e ahlakun e tij, për të cilat njerëzimi ka nevojë që t'i njohë, t'i dijë, t'i trajtojë, t'i studiojë e t'i vërë në përdorim në vazhdimësi, sepse të gjitha këto janë me burim hyjnor, sepse Allahu xh.sh. për të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. ka thënë:

"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij." (En-Nexhmu, 3-4).

﴿وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ﴾

"Vërtet, ti (o Muhamed) je me moral sublim!" [El-Kalem, 4]

Kurse në një ajet tjetër kuranor, duke na mësuar ne se personaliteti i Muhamedit a.s. duhet të jetë përjetësisht shembulli dhe modeli ynë që duhet ndjekur, thotë:

﴿لَّقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُو اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا﴾

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe që e përmend shumë Allahun." [El-Ahzab, 21]

Ndërsa për nevojën tonë për Muhamedin a.s., për dashurinë ndaj tij, për pasimin e rrugës dhe mësimeve të tij, e që janë vetë feja islame në praktikë, në Kuran Allahu xh.sh., na thotë:

﴿قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ﴾

"Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë." [Ali Imran, 31]

Prandaj, njohja, dashuria dhe respekti për Pejgamberin, Muhamedin a.s. dhe misionin e tij, përveçse janë të urdhëruara, ato e fisnikërojnë, e edukojnë dhe e begatojnë individin dhe shoqërinë.

Në kohën që po jetojmë, mbushur me konflikte, mosdurim, smirë e urrejtje në njërën anë, dhe në anën tjetër kur shoqëria e posaçërisht rinia jonë përballen me shumë dukuri negative, mësimet e Pejgambeit a.s. janë rrugëdalja më e mirë për t'i tejkaluar këto sfida që na mundojnë sot.

Prandaj, në këtë muaj, kur kujtojmë lindjen e Pejgamberit tonë, duhen marrë e praktikuar në jetën tonë mësimet e të Dërguarit të Allahut, të angazhohemi për forcimin e paqes, të bëjmë më shumë për ndaljen e luftërave e konflikteve, sepse Zoti dhe i Dërguari i Tij nuk janë razi me këto, Zoti dhe i Dërguari i Tij kërkojnë nga ne që ta ndërtojmë e ta kultivojmë harmoninë e mirëbesimin ndërnjerëzor.

Po ashtu, gjatë këtij Muaji të Mevludit, të shtojmë kujdesin ndaj rinisë që së pari ajo të edukohet në rrugën e Zoti dhe së dyti të mos merret me dukuri devijante, këto dy synime më së miri i arrijmë duke marrë për bazë mësimet dhe veprimet e të Dërguarit tonë a.s..

Një i ri nëse kërkon model për edukim nuk ka ku ta gjejë tjetër, pos te Pejgamberia.s.. Nëse kërkon model për besnikëri, te Pejgamberi a.s. do ta gjejë më të mirin besnik, nëse kërkon model për atdhedashuri te Pejgamberi a.s. do ta gjejë më të mirin atdhedashës, nëse kërkon modelin e urtësisë e modestisë te Pejgamberi a.s. do ta gjejë, si për çdo gjë pozitive, më të mirin yrnek.

Të nderuar besimtarë,

Vëllezër e motra!

Nga ky aktivitet, ju ftoj që gjatë këtij Muaji të Mevludit të lexoni sa më shumë Kuran, të dërgoni sa më shumë salavate e selame për Pejgamberin, Muhamed Musatafanë a.s., t'i praktikoni urdhrat e Kuranit dhe mësimet e Synetit të Pejgamberit a.s., kudo ku jeni dhe kudo ku gjendeni.

Dhe meqë, sikurse e thamë, kemi një traditë të kahershme përpërkujtimin dhe manifestimin e ditëlindjes së Pejgamberit a.s., atëherë lusim që kjo traditë të kultivohet sa më shumë në familjet tona, në shtëpitë tona, në xhematet dhe xhamitë tona, në mejtepet, medresetë dhe kudo tjetër.

Duke ju uruar edhe një herë nga zemra për këtë Muaj të Mevludit dhe duke ju falënderuar që jeni bërë pjesë e këtij manifestimi, nuk gjej me se ta përfundoj më mirë sesa me vargjet e njërit prej autorëve shqiptarë, Tahir ef. Popo-vës, i cili me shumë ashk e dëshirë, në Mevludin e tij për Pejgamberin a.s. lutet:

"Ja Rabbi, për hyrmet të pejgamberit Tënd,

Mos na ndaj ne kurrë prej rahmetit Tënd!"

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnava

Prishtinë, 18 nëntor 2018

Fjala e kryetarit të DIJANET-it, Myftiut të Turqisë

Falënderimet dhe madhërimet qofshin për Krijuesin tonë të Lartë, i Cili na dhuroi vahjin/shpalljen, gjë që do të jetë udhëzues deri në Kiamet dhe i Cili na bashkoi në këto vende të zemrës së Ballkanit.

Përshëndetjet qofshin për Muhamed Mustafanë, i cili Kuranin Fisnik e përktheu në një jetë ideale për veten e tij.

I nderuar Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, hoxha ynë z. Naim TËRNAVA,

Autoritete të larta shtetërore,

Ju hoxhallarë,

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur ju të rinj!

Me fillimin e fjalës sime, të gjithë dua të ju përshëndes me dashuri, nderime dhe respekt. Përshëndetja e Allahut, mëshira dhe begatia e Tij qofshin mbi të gjithë ju. Juve jua kam sjellë selamet dhe përshëndetjet e mëdha nga Turqia, Anadolli, nga Stambolli i Fatihut, nga Bursa e Sulltan Muratit, nga Konja e Mevlanës, pranojini ato!

Të nderuar mysafirë!

Mevludi i cili nënkupton ardhjen e Pejgamberit a.s. në këtë botë, si një dashuri dhe mall ndaj tij, ka një vend të posaçëm, të fortë dhe rrënjësor në botën e mendjes dhe zemrave të myslimanëve. Nga personaliteti i Pejgamberit a.s. nënkuptohet një ndriçim i së ardhmes për rimëkëmbjen e njerëzimit. Kjo tregon që në një periudhë "injorance", kur janë shterur vlerat njerëzore dhe morale, edhe një

herë njerëzimi takohet me vlerat, të drejtat, mëshirën dhe moralin e bukur.

Në kohën kur sipërfaqen e tokës e kanë kapluar luftërat, skamja, pashpresa apo probleme gjigante, përkujtimi i Mevludit hap bisedën, shpjegon mënyrën dhe rrugën e rifillimit të drejtësisë, mëshirës dhe komunikimit.

Të nderuar mysafirë!

Kryesia për Çështje Fetare e Dijanetit, qysh moti, në kohëra të caktuara, ka bërë të mundur dhe është bërë ndërmjetësuese që të shqyrtojë çështjet të cilat janë në dobi të bashkësisë sonë dhe njerëzimit.

Bazuar në këtë, për vitin 2018 në javën e Mevludit kemi caktuar temën "Pejgamberi a.s. dhe rinia".

E dimë që rinia është gjëja më e vlefshme që i është dhuruar njeriut.

Është periudhë kur ëndrrat, emocionet dhe idealet janë më së shumti në kërkim.

Rinia i ka vitet më të mira të jetës dhe nëse ajo shfrytëzohet drejt, atëherë personi e fiton këtë botë dhe botën tjetër, e nëse ajo nuk (mund të) shfrytëzohet mirë, atëherë për fat të keq ajo shndërrohet në vitet të cilat nuk mund të kthehen më.

Rinia, gjithashtu është ardhmëria e një populli, është mundësia dhe pasuria më e madhe.

Shumica e atyre që iu përgjigjën ftesës së Pejgamberit a.s. për pranimin e Islamit në kohën më të vështirë në Mekë, përbëhej nga të rinjtë.

Kështu pra, në zgjedhjen e tij për pejgamber, shumica nga ata që e pranuan dhe iu përgjigjën ishin të rinj. Pejgamberi i Allahut, revolucionin më të madh moral dhe juridik e ka realizuar me një grup nga rinia, të cilët i kanë besuar atij. Kështu që, është realitet i ditur se të rinjtë janë më të përshtatshëm

për pranimin e Islamit dhe më lehtë i dhurojnë zemrën kërkesës për të drejtën.

Atëherë, nëse ne në këtë kohë u afrohemi te rinjve të kësaj kohe sikurse Pejgamberi a.s., padyshim se ata do të kenë konsideratë ndaj neve. Nëse ne do të mund të predikonim dhe përfaqësonim Islamin nëpërmjet metodës së Pejgamberit a.s., sa shumë trima të rinj të kësaj kohe do të dilnin në ndihmë të miqësisë.

Çështja më e rëndësishme është që të drejtohen në mënyrë të drejtë ndjenjat e natyrshme të të riut, që Allahu ia ka falur atij.

Gjëja që nuk duhet të na ikë nga kujdesi ynë, është imunizimi nga ndikimi i mekanizmave keqpërdorues në ndjenjat e të rinjve.

Kështu që, në ditët tona kur na ka kapluar kapitalizmi dhe kur kjo po lansohet si një paraqitje shfrytëzuese, duke mos u hetuar, më së shumti po prek rininë. Grupet terroriste të prodhuara nga projekte ndarëse dhe anarkiste, kurthet e tyre janë duke i ndërtuar mbi ndjenjat e rinisë. Në shumicën e vendete të botës, të rinjtë e pafajshëm janë duke u zgjedhur si kurban për qëllimet, interesat dhe llogaritë e tyre të thella.

Ndryshimet dhe zhvillimet e shpejta që po ndodhin në kohët moderne, si informacioni, komunikimi, transporti etj., janë duke e vështirësuar edhe më tepër punën e të rinjve, dhe në anën tjetër janë duke i lënë ata të dobët përballë rrjedhojave aktuale. Kështu që , ndër përgjegjësitë më të mëdha që kemi është që për veten tonë, të ardhmen dhe ahiretin, t'i prijmë në të drejtë dhe në të mirë rinisë. Që t'i bashkojmë me vlerat e besimit dhe qytetërimeve.

Vëllezër të nderuar!

Rinia, është koha më dinamike, më e guximshme dhe më e bereqetshme e jetës.

Është një mundësi e madhe në transferimin dhe bartjen e popujve për në të ardhmen.

Nisur nga kjo, theksoj se identiteti është ai që një popull e bën aktor dhe pronar të vazhdueshëm në skenën e tij.

Identiteti i tij sjell shumë gjëra siç është gjuha, historia, kultura, gjeografia, atdheu etj. Ndërsa faktori kryesor i cili formon identitetin e tij janë feja dhe besimi. Historia na tregon që, kur popujt i kanë humbur vlerat e përmendura, më në fund kanë humbur edhe identitetin. Për këtë arsye, që është më e rëndësishmja, në Republikën e Kosovës duhet të bëhet çdo angazhim dhe punë që brezat e rinj të fitojnë idealin e identitetit mysliman.

Ndërsa në anën tjetër, i riu që rininë e tij e kalon me nder dhe dinjitet, ka një vlerë të posaçme tek Allahu.

Për këtë i Dërguari i Allahut, kur thekson ato grupe që do të tubohen nën hijen e Allahut në Ditën e Llogarisë, njëri nga ta është i riu: "I riu, i cili rritet duke kërkuar dhe adhuruar Zotin e tij", pra, që rritet duke i bërë ibadet Atij dhe që rritet në një jetë krejtësisht të pastër.

Të nderuar vëllezër!

Duhet të jemi të vetëdijshëm ndaj rinisë dhe të rinjve. Është e qartë se përgjegjësia na takon neve që ata t'i bashkojmë me vlerat e besimit dhe të qytetërimeve. Duhet t'i çmojmë ata.

Të rinjve të kësaj gjeografie, duhet t'u dalim zot dhe t'u kushtojmë rëndësi, pa marrë parasysh se çfarë mendimi, model jete apo veshje kanë.

Jo duke i kritikuar vazhdimisht ata në pika negative, por duhet të zgjedhim një model dhe mënyrë komunikimi udhëzues.

Jo vetëm kështilla, duhet të jemi shembull dhe mostër për ta me virtyte tonat që duam t'i shohim tek ta.

Duhet t'i kuptojmë dhe çmojmë ata duke filluar nga ajo se çdonjëri është një botë e çdo ekzistencë është një shenjë.

Duhet të jemi në gatishmëri në mënyrë që atyre t'u afrohemi me një metodë pejgamberike, miqësore, se si të ndajmë së bashku jetën, përgjegjësitë, dhe, ç'është më e rëndësishmja, se si t'u hapim diapazonin më të mirë atyre që të përgatiten për jetë.

Duhet të jemi të tillë që të merremi me brengat e tyre, t'u prekim zemrat e tyre, t'u japim shpresa dhe bindje e jo t'i gjykojmë, pyesim apo t'i diktojmë ata.

Duhet që vazhdimisht të kontribuojmë që të fusim në botën e mendjeve të tyre se jemi anëtarë të një feje, e cila vazhdimisht urdhëron që të lexojnë, të kuptojnë, si ta përdorin mendjen, si të fitojnë diturinë. Duhet të kujtojmë se dituria si forcë më e madhe mund të përdoret si për të mirë ashtu edhe për të keq. Për këtë arsye, atyre duhet t'u shpjegojmë që duhet kapur dhe përvetësuar një dije rrënjësore, e cila të çojë në qëllimin e drejtë.

Potencojmë se është detyrë jona që rininë ta njohim me Islamin përkëdhelës, me mëshirë, korrektësi, moral të pastër dhe bashkëjetesë.

Me përfundimin e fjalëve të mia, të gjithë ju, ju lë në amanetin e Zotit. Ju përshëndes duke ju paraqitur respektin dhe dashurinë time, duke e lutur Allahun që të jetoni identitetin tuaj në këto vende, besimin tuaj, dhe që paqja dhe harmonia vëllazërore të mbizotërojnë përgjithmonë.

Të nderuar vëllezër!

Bashkësia Islame e Turqisë, bashkë me qeverinë dhe popullin turk, do të vazhdojë të qëndrojë pranë vëllezërve tanë shqiptarë, dhe së bashku me Bashkësinë Islame të Kosovës do të bashkëpunojë për t'i kultivuar vlerat islame sikur deri edhe me tani dhe për ta mbrojtur nga interpretimet e gabuara.

Myftiu i Turqisë
Ali ef. Erbash
Prishtinë, 18 nëntor 2018

Dr. Ajni Sinani

Disa cilësi të Muhamedit a.s. të përmendura në Kuran

Omerit i ishin mbushur sytë me lot, kur kishte parë që i Dërguari i Allahut jetonte mbi një shtrojë të thatë, ndërkaq Kajseri dhe Kisrau notonin në begati. Pejgamberi a.s. për ta qetësuar hz. Omerin i thotë: "O Omer! Kisrau dhe Kajseri le të i marrin begatitë e kësaj bote, le të jetojnë me to. Neve na mjafton begatia e botës tjetër!"

1. Allahu e ka përmendur emrin e tij të nderuar së bashku me emrin e Vet, në pafillimshmërinë e amshuar dhe e ka qëndisur në Levhi Mahfudh duke e shkruar atë mbi Arsh, mbi kopshtet e Parajsës dhe mbi shtatë qiejt: "La ilahe il'lAllah, Muhamedun resulullah."

2. Zoti e lartësoi përmendjen e emrit të tij përkrah emrit të Vet në Fjalën e Dëshmisë, në ezan, në ikamet, në teshehudin e namazit, në shumë lutje, në shumë vepra adhurimi, në hutbe, në varr, në Ditën e Gjykimit, në Parajsë dhe në gjuhët e folura prej të gjithë krijesave : "Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde." (El Inshirah: 4).

3. Zoti shpëtimin e madh e lidhi me nënshtrimin ndaj Tij dhe të Dërguarit (a.s.) të Tij: "Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ka arritur një shpëtim të madh!" (El Ahzab: 71).

4. Zoti betohet se Muhamedi a.s. nuk kishte humbur rrugën dhe as që kishte devijuar: "Shoku juaj (Muhamedi a.s.) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar." (En Nexhm: 2).

5. Zoti ia mbrojti zemrën nga rreziqet dhe blasfemia: "A e ke parë ti atë, që për zot e merr epshin e vet, a mos ti do t'i bëhesh atij dorëzanës?" (El Furkan: 43).

6. Zoti dhe engjëjt i çojnë selame: "Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që

keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavate) dhe përshëndeteni me selam." (El Ahzab: 56).

7. Zoti ia hapi dhe ia pastroi gjoksin: "A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd?" (El Inshirah: 1)

8. Zoti ia hoqi barrën: "Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde, e cila shtypte shpinën tënde." (El Inshirah: 2,3).

9. Zoti nuk e braktisi dhe as nuk e përbuzi: "Zoti yt as nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur." (Ed Duha: 3).

10. Botën e amshueshme ia bëri shumë më të mirë se kjo botë: "Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para." (Ed Duha: 4).

11. Zoti i dha dhe e bëri të kënaqur: "E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh." (Ed Duha:5).

12. Zoti e strehoi dhe e mbrojti: "A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të dha strehë." (Ed Duha: 6).

13. Zoti e udhëzoi atë: "Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi." (Ed Duha: 7).

14. Zoti e pasuroi dhe begatoi: "Dhe të gjeti të varfër e të pasuroi." (Ed Duha: 8).

15. Zoti ia dha kevtherin: "Ne, vërtet të dhamë ty shumë të mira (Kevtherin)." (El Kevther: 1).

16. Zoti ia pastroi gjuhën: "Ai nuk flet nga hamendja." (En Nexhm, 3).

17. Zoti ai pastroi zemrën: "Zemra nuk e përgënjeshtroi atë që pa." (En Nexhm, 11).

18. Zoti ia pastroi memorjen dhe mbamendjen: "Ne do ta lexojmë ty e nuk do ta harrosh (Kuranin)." (El Ala: 6).

19. Zoti ia pastroi të dëgjuarit: "Dhe veni veshin thirrësit kur thërret nga ndonjë vend i afërt." (Kaf: 41).

20. Zoti ia pastroi të parët: "Shikimi (i Muhamedit a.s.) as nuk lakoi as nuk tejkaloi." (En Nexhm, 17).

21. Zoti ia pastroi namazin, qëndrimin në këmbë dhe rënien në sexhde: "I Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë. (E sheh) Edhe

"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm-butë dhe i mëshirshëm për besimtarët." (Et Tevbeh, 128)

lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen." (Esh Shuara: 218, 219).

22. Zoti ai ka pastrue lutjen: "Dhe lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta." (Et Tevbeh: 103).

23. Zoti e barti nga Meka në Kuds (Isra): "Pa të meta është Lartmadhëria ë Tij që e kaloi robin e Vet në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa…" (El Isra: 1).

24. Zoti e ngriti nga Kudsi deri mbi shtatë qiejt (miraxh), tek Sidretul Munteha: "Tek Sidretul Munteha, pranë së cilës është xhennetul Me'va." (En Nexhm: 14, 15).

25. Zoti i tregoi gjëra të jashtëzakonshme gjatë miraxhit: "Ai vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet." (En Nexhm, 18).

26. Zoti ia fali mëkatet: "Ashtu që Allahu të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të më vonshme…" (El Feth: 3).

27. Zoti është betuar në jetën e tij: "Pasha jetën tënde (Muhamed) s'ka dyshim se ata ishin të humbur në dehjen e tyre." (El Hixhr: 72) .

28. Zoti nuk i drejtohet me emër por me thirrjen: "O i dërguar": "O ti i dërguar! Komuniko atë që t'u zbrit prej Zotit tënd…" (El Maideh: 67).

29. Zoti e pastroi moralin e tij: "Vërtet, ti je me moral sublim." (El Kalem: 4).

30. Zoti betohet se ai nuk është i marrë: "Nuk është i marrë shoku juaj (Muhamedi)." (Et Tekvir: 22).

31. Zoti e dërgoi atë që t'ua lexonte njerëzve ajetet e Kuranit dhe t'i pastronte ata nga idhujtaria dhe mosbesimi: "Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'u lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin…" (El Xhumua: 2).

32. Zoti e bëri shembull për njerëzimin: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin ë All-llahut…" (El Ahzab: 21).

33. Zoti e dërgoi për të gjithë njerëzit dhe xhindët (Resulu Thekalejn):

"Thuaj: Mua më është shpallur se një grup nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kuranin) dhe thanë: Ne kemi dëgjuar një Kuran që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më askë." (El Xhinn: 1,2).

34. Zoti e dërgoi dëshmues, lajmëtar, përgëzues, qortues, sihariqdhënës dhe pishtar ndriçues: "O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar, përgëzues e qortues. Dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues. E besimtarëve jepu sihariq se prej Allahut ata kanë dhunti të madhe." (El Ahzab: 45-47).

35. Zoti e dërgoi mëshirë për të gjitha botët dhe të gjitha krijesat: "E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (El Enbija: 107).

36. Zoti e cilëson me cilësitë specifike "Reuf" (i Butë) dhe "Rahim" (i Mëshirshëm): "Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm-butë dhe i mëshirshëm për besimtarët." (Et Tevbeh, 128).

37. Pejgamberit a.s. i vinte keq edhe për jobesimtarët: "A thua ti, do ta shkatërrosh veten nga

hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kuranit)?" (El Kehf, 6).

38. Zoti e dërgoi Muhamedin a.s. që t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë: "… për t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë…" (Et Talak: 11).

39. Dërgimi i tij ishte dhuratë e madhe për besimtarët: "Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta, nga mesi i tyre dërgoi të dërguar…" (Ali Imran: 164).

40. Zoti dëshmon për misionin e tij: "O ju njerëz, juve ju erdhi i dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj…" (En Nisa: 170).

41. Isai a.s. kishte lajmëruar ardhjen e tij, (madje sipas sunnnetit të gjithë pejgamberët e kanë bërë një gjë të tillë): "Dhe, kur Isai, bir i Merjemes tha: …dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed…." (Es Saff: 6).

42. Zoti ia dha Kuranin: "Dhe poashtu Ne ta zbritëm ty librin…" (El Ankebut: 47); "Ne nuk ta shpallëm Kuranin për të të munduar." (TA HA: 2).

43. Zoti e bëri të Dërguarin, pejgamer të fundit: "Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve…" (El Ahzab: 40).

44. Zoti lejoi që Muhamedi a.s., të ketë më shumë gra se myslimanët e tjerë: "O ti Pejgamber, Ne të kemi lejuar gratë, të cilave u ke dhënë shpërblimin e kurorës, … duke qenë kjo vetëm për ty e jo edhe për besimtarët…." (El Ahzab, 50).

45. Gratë e Pejgamberit a.s. janë nënat e besimtarëve: "Ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre." (El Ahzab: 6).

Sipas Sunnetit

"Mos u frikëso vëllai im! Qetësohu! Unë nuk jam as mbret e as perandor. Jam bonjaku i fqinjit tënd të vjetër që ka ngrënë mish të tharë në diell!"

Omerit i ishin mbushur sytë me lot, kur kishte parë që i Dërguari i Allahut jetonte mbi një shtrojë të thatë, ndërkaq Kajseri dhe Kisrau notonin në begati. Pejgamberi a.s. për ta qetësuar hz. Omerin i thotë: "O Omer! Kisrau dhe Kajseri le të i marrin begatitë e kësaj bote, le të jetojnë me to. Neve na mjafton begatia e botës tjetër!" H. Muhamedi a.s. është "i dashuri i Allahut" (habibullah), i parapëlqyeri ndër pejgamberët dhe më i nderuari i gjithë krijesave. Ai është i Dërguari i kohës së fundit, "i fundit i pejgamberëve" (hatemul enbijai vel murselin). Pejgamberit të mëshirës i janë dhuruar, për Ditën i Kiametit, pozitat e "të përzgjedhurit" (mahmud; mekami mahmud) dhe e "ndërmjetësuesit të madh për falje" (shefaatu udhma). Ai netët i kalonte duke u falur, aq sa këmbët i ënjteshin. Kur h. Aisheja i tha se pse lutej aq gjatë natën, ndërkaq që Allahu ia kishte falur mëkatët e mëparshme dhe të mëpasme, ai i ishte përgjigjur duke thënë: "A nuk duhet të jem rob mirënjohës dhe falënderues ndaj Allahut?"

Ai ishte i dashur dhe i besueshëm tek populli i tij. Atë e quanin el Emin (Besnik) dhe es Sadik (i Drejti). Pejgamberi a.s. ka thënë: "Unë jam Muhamed dhe Ahmed. Unë jam Asgjësuesi (Mahi), me pejgamberinë time Allahu do ta asgjësoj mohimin. Unë jam Bashkuesi (Hashir), rreth të cilit do të tubohen dhe mblidhen njerëzit në Ditën e Ringjalljes. Unë jam vula e pejgamberëve (Hatemul Enbija), dhe Përmbyllësi (Akib), pas meje s'do të ketë pejgamber tjetër."

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë: "Allahu i Madhërishëm, ndër bijtë e Ibrahimit, zgjodhi Ismailin. Nga bijtë e Ismailit zgjodhi bijtë kinanë. Nga bijtë kinanë zgjodhi kurejshët. Nga Kurejshët zgjodhi bijtë hashimë. Nga bijtë hashimë zgjodhi bijtë abdulmutalibë. Dhe nga bijtë abdulmutalibë, më zgjodhi mua."Nëna Emine në ditët e para të shtatzënisë, pa një ëndërr. Asaj iu tha: "Ti je shtatzënë në më të mirin e këtij ummeti. Kur ta lindësh atë, lutu duke thënë: Mbështetem te Allahu nga sherri i çdo të keqi." Pejgamberi a.s. ka thënë: "Unë jam lutja e gjyshit tim, Ibrahimit, sihariqi i vëllait tim, Isait dhe ëndrra e nënë sime."

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës “El-Hashr” – (5)

Devotshmëria, rruga drejt shpërblimit në Ahiret

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾ وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنسَاهُمْ أَنفُسَهُمْ ۚ أُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿١٩﴾ لَا يَسْتَوِي أَصْحَابُ النَّارِ وَأَصْحَابُ الْجَنَّةِ ۚ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ هُمُ الْفَائِزُونَ ﴿٢٠﴾

“O ju që besuat, kijani frikën Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Dhe frikësojuni Allahut! S’ka dyshim se Allahu është i njohur me atë që punoni! Mos u bëni si ata që harruan Allahun e Ai i bëri të harronin vetveten! Të tillët janë fasikët (të pabindurit ndaj Allahut). Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit. Banorët e Xhenetit do të jenë fitimtarët.” (El-Hashr, 18-20)

Kur Allahu ia dëshiron të mirën robit të Vet, e urdhëron për takva-devotshmëri dhe frikërespekt ndaj Tij

Lidhja e këtyre ajeteve me ato para-prake

Pasi që Allahu i Madhërishëm sqaroi në detaje gjendjen e munafikëve dhe të hebrenjve, Ai i urdhëron dhe nxit myslimanët në punë të mira në këtë botë, të cilat do të jenë dritë dhe shpërblim për mirësitë e Ahiretit, sepse vetëm nëpërmjet punëve tona në këtë dynja, ne përgatitemi për Xhenet. Por, për ta merituar këtë shpërblim, së pari zemrat tona duhen pajisur me takvallëk-devotshmëri, i cili nënkupton pastrimin e zemrës nga çdo shibël e mosbesimit, kryerjen e detyrimeve fetare si dhe largimin nga ato që ka ndaluar Allahu xh.sh..

Pastaj i Gjithëmëshirshmi na bën me dije që të mos harrojmë Allahun dhe obligimet ndaj Tij, sepse ata që i harrojnë ato, janë të shthururit dhe të humburit, sepse në asnjë mënyrë, nuk mund të jenë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe ata të Xhenetit. Vetëm ata që i shpëtuan intrigave të shejtanit, do të jenë fitimtarë duke shijuar kënaqësitë e Xhenetit.

Koment:

18. O ju që besuat, kijani frikën Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Dhe frikësojuni Allahut! S’ka dyshim se Allahu është i njohur me atë që punoni!

Allahu u Plotfuqishëm, në shumë vende në Kuran, i thërret besimtarët, me këtë thirrje të ngrohtë, e cila përfshin të gjithë ata që, në shpirt e në zemër, e kanë besimin e pastër, që gjithmonë t’ia kenë dronë Allahut. Të gjithë besimtarët, duhet të jenë të vëmendshëm dhe të vetëdijshëm për epitetin të cilin e mbajnë – *besimtar*, dhe secili, vazhdimisht duhet të shikojë se me çfarë veprash do të dalë nesër para Madhërisë së Allahut, në Ditën e Gjykimit.

Jeta jonë në këtë botë është shumë e shkurtë, andaj duhet kujdes maksimal për veprimet tona. Nesër kur do të dalim para Allahut, dhe kur do të peshohen veprat tona, nuk do të pyetemi për pozitat që i kemi pasur në këtë dynja, por për veprat dhe devotshmërinë tonë. Pas vdekjes, me vete nuk do ta marrim as pasurinë e as pozitën, por në vetminë e varrit dhe në peshojën e Allahut-Mizanin, do të na shoqërojnë vetëm veprat-amelet tona.

Në këtë ajet kuranor, fjala *“It-tekullahe”* dhe *“ve-t-tekullahe”* që nënkupton devotshmërinë, përulësinë dhe frikën-dronë nga Zoti, shohim se është përmendur dy herë, dhe jo rastësisht, sepse prapa saj fshihet një urtësi e madhe. Kur Allahu ia dëshiron të mirën robit të Vet, e urdhëron për

takva-devotshmëri dhe frikërespekt ndaj Tij, e kjo nënkupton kujdesin hyjnor, ngrohtësinë dhe dhembshurinë e Tij ndaj atij apo atyre që i urdhëron për takva. Madje, shohim se në fillim të sures *"El-Ahzab"*, Ai të njëjtën thirrje ia drejton edhe të Dërguarit të Tij – Muhamedit a.s. kur i thotë: *"O i Dërguar! Kije frikë Allahun!"* Arsyeja pse këtu Allahu xh.sh. i është drejtuar të Dërguarit a.s. me fjalën *'nebij'* dhe jo *'resul'*, është se me fjalën *"Ja ejjuhe-r-Rresul"* nënkupton kumtimin e mesazhit dhe revelatës, kurse me fjalën *"Ja ejjuhe-n-Nebijj"*, nënkupton thirrjen që shpreh afërsi, kujdes dhe ngrohtësi hyjnore.

Fjala *"Takva"* në Kuran është përmendur mbi 160 herë, gjë që tregon për rëndësinë e saj, sepse njëkohësisht është edhe një porosi nga i Lartmadhërishmi, që të pajisemi me devotshmëri kur thotë: *"Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve:*

"Kijani frikën Allahut!" – *(En-Nisa'ë, 131),*

Pajisja e zemrave me devotshmëri dhe frikë nga Zoti, ishte porosi edhe e Pejgamberit a.s., teksa e këshillonte Ebu Dherrin: *"Të porosis për devotshmëri dhe frikërespekt ndaj Allahut, sepse kjo është ndër gjërat më madhështore!"*[1]

Fjala *"Takva"* në Kuran është përmendur mbi 160 herë, gjë që tregon për rëndësinë e saj, sepse njëkohësisht është edhe një porosi nga i Lartmadhërishmi, që të pajisemi me devotshmëri.

Madje edhe lutja e Pejgamberit a.s. derisa ishte në udhëtim ndërlidhej me takva, kur thoshte: *"O Zoti im. Ne kërkojmë prej Teje në këtë udhëtim tonin, mirësi dhe devotshmëri..."*[2]

Ndërkohë, i Dërguari a.s., na mëson se zemra është burimi i devotshmërisë dhe i respektit ndaj Allahut, prandaj për këtë arsye, ai duke bërë me shenjë nga zemra ka thënë tri herë radhazi: *"Takvaja është mu këtu, takvaja është mu këtu, takvaja është mu këtu!"*[3]

Megjithatë, edhe përkundër këtyre porosive dhe urdhëresave për takvallëk, njerëzit në të shumtën e rasteve janë diametralisht larg këtij koncepti të synuar, sepse nuk janë vetëm fjalët dhe sjellja e jashtme kriter i kësaj devotshmërie. Shumë prej njerëzve, mbase as nuk e kuptojnë se synimi i takvallëkut, është njëkohësisht edhe sprovë nga i Madhi Zot, për ç'gjë Ai na jep shenjë*: "Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur (sprovuar) për besim e përkushtim."– (El-Huxhurat, 3)*

Fatkeqësisht, shumë prej njerëzve-besimtarëve, bien nga ky provim, sepse jo gjithherë zemrat tona janë të përgatitura për këto sakrifica sublime. Sprovat që na godasin, na thyejnë shpirtërisht, bëjnë që të na humbë durimi, rrallë herë arrijmë t'i frenojmë edhe egot e pasionet tona, me butësi. Nganjëherë biem pre e sprovës së pushtetit, nganjëherë e mendjemadhësisë

e në shumë raste edhe pre e sprovës së pasurisë.

Në anën tjetër, ata që arrijnë ta frenojnë veten dhe duke iu mbështetur Allahut me devotshmëri, ata përfitojnë shumë mirësi:

- Allahu ju dhuron dritë në zemër, me anë të së cilës e dallojnë të vërtetën nga e shtrembëta:

«O ju që besuat, nëse i keni frikën Allahut, Ai do të vërë udhëzim (dritë në zemrat tuaja) për ju...» - (El-Enfal, 29)

- I furnizon me risk e bereqet:

"E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur (prej gjynaheve), Ne do t'u hapnim begati nga qielli dhe toka" - (El-A'raf, 96)

- Ua lehtëson çështjet e kësaj bote:

"E kush ia ka frikën Allahut, Ai do t'ia lehtësojë atij çështjen (punën)"

- Devotshmëria të radhit në mesin e grupit të parë që do të hyjnë në Xhenet:

"E ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të tyre, do të sillen në grupe te Xheneti, e kur arrijnë aty, dyert e tij i gjejnë të hapura dhe roja e tij u thotë: "Selamun alejkum" - Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!" - (Ez-Zumer, 73)[4] *etj.*

Fundi i ajetit: *"S'ka dyshim se Allahu është i njohur me atë që punoni!"* na bën me dije se Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Gjithëpushtetshëm, na mbikëqyr në çdo çast, dhe se Atij nuk mund t'i fshihet asnjë veprim yni, madje nuk mund t'i fshihet as mendimi ynë të cilin nuk e artikulojmë me zë. Pikërisht kjo është arsyeja, që ne të kujdesemi për veprimet tona, të bëjmë një vetëllogari, sepse vjen një moment kur duhet dorëzuar shpirti para Allahut, por pas kësaj, më nuk ka mundësi të pendohemi e as të veprojmë punë të mira.

Ajetin e 18-të, të kësaj sureje: *"O ju që besuat, kijani frikën Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Dhe frikësojuni Allahut!"*, e ka përdorur si argument edhe vetë i Dërguari i Allahut, gjatë një hytbeje të tij. Ai pati parë e takuar në Medinë, një grup njerëzish nga Medari, të zbathur, të leckosur e të pangrënë, dhe ishte prekur aq shumë nga kjo pamje trishtuese e tyre, saqë kishte urdhëruar Bilalin ta thërriste ezanin dhe kishte mbajtur një hytbe emocionuese. Pasi e kishte lexuar ajetin e parë të sures En-Nisa: *"O njerëz, kijani frikë Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu"*, menjëherë e kishte lexuar edhe ajetin e 18-të të sures "El-Hashr": *"O ju që besuat, kijani frikën Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Dhe kijani frikën Allahut!"*. Pastaj, ai filloi t'i nxiste besimtarët që të jepnin sadaka sipas mundësive që kishin. Dikush kishte dhënë dërhemë, dikush dinarë, dikush rroba, dikush hurma e dikush grurë. Ky veprim i tyre, e kishte gëzuar aq shumë të Dërguarin a.s., saqë fytyra filloi t'i shkëlqente nga nuri sikur të ishte praruar në ar, e pastaj tha: *"Ai që nis (ligjëson) në Islam një traditë të mirë, do ta ketë shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që veprojnë në përputhje me të deri në Ditën e Kiametit, pa iu pakësuar aspak nga shpërblimi i tij..."*[5]

> **Fjala *"nisjan"* - harresë, në mënyrë alegorike shpreh mjerimin dhe fatkeqësinë e secilit njeri që ka lënë anash detyrimet e tij ndaj Allahut fuqiplotë.**

19. Mos u bëni si ata që e harruan Allahun e Ai i bëri të harronin vetveten! Të tillët janë fasikët (të pabindurit ndaj Allahut).

Këshillat hyjnore janë shenja që na orientojnë drejt mëshirës së Allahut dhe besimtari asnjëherë nuk duhet të jetë i shkujdesur nga to. Edhe porosia e këtij ajeti ka një domethënie të tillë, e cila na sjell ndër mend, se besimtari i devotshëm, gjithnjë duhet të ruajë lidhjen me Zotin e tij. Në të kundërtën, nëse kjo lidhje shkëputet, atëherë edhe jeta jonë e humb arsyen e ekzistimit. Nëse synimi ynë, nuk është arritja e kënaqësisë së Allahut, por e të mirave të kësaj bote, atëherë do të shemben muret e besimit dhe të devotshmërisë, do të humbë edhe busulla e orientimit tonë, dhe ashtu siç është shprehur Allahu xh.sh. figurativisht, nëse njeriu e harron Krijuesin e tij, që në fakt nënkupton shkujdesjen ndaj obligimeve fetare, lënien e tyre dhe largimin nga devotshmëria, atëherë njerëzit do ta harrojnë edhe vetveten,[6] duke u zhytur thellë në vorbullën e intrigave, joshjeve dhe kënaqësive të kësaj bote.

Fjala *"nisjan"* - harresë, në mënyrë alegorike shpreh mjerimin dhe fatkeqësinë e secilit njeri që ka lënë anash detyrimet e tij ndaj Allahut fuqiplotë. Rezultati i kësaj harrese është katandisja e kësaj kategorie njerëzore në llumin e kësaj bote, duke "harruar" se një ditë do t'i zërë vdekja, dhe do të dalin të turpëruar para Madhërisë së Allahut xh.sh. Këta njerëz janë "fasikë"-të shkujdesur e të përhumbur në injorancën e tyre, dhe fundi i tyre do të jetë zjarri i Xhehenemit.

Nga tërë kjo, mund të marrim një këshillë, se nëse ne e vërejmë se koha jonë po na ikën kot, pa e shfrytëzuar atë për ndonjë dobi të kësaj dynjaje apo të Ahiretit, duhet të kemi kujdes që të mos jemi prej

atyre që e kanë harruar Allahun, që pastaj ta harrojmë edhe vetveten, duke rënë pre e intrigave djallëzore.

20. Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit. Banorët e Xhenetit do të jenë fitimtarët.

Ajeti i 20-të i kësaj kaptine fillon me fjalën *"la jestevi"* e që nënkupton dallueshmërinë në mes kategorive njerëzore, në bazë të përfundimit të tyre, e jo pozitave që i kanë pasur në këtë botë. Kjo do të thotë, se absolutisht, në asnjë mënyrë nuk mund të jenë të barabartë në vlerë, banorët e Zjarrit me ata të Xhenetit. Nuk mund të jenë të barabartë ata që nuk besuan, u tallën me fenë e Allahut dhe që ishin të shkujdesur, me ata që gjithmonë ishin në rrugë të Zotit, që ishin të devotshëm dhe u përballën me shumë sprova e vështirësi në këtë botë, për shkak të bindjeve dhe besimit të tyre.

Krahasime të tilla në ajetet kuranore ka shumë, e ne do të sjellim vetëm disa prej tyre, në të cilat Allahu xh.sh. e bën të qartë dallimin në mes njerëzve, në bazë të vlerave dhe bindjeve që ata kanë:

- "A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t'i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre!" – (El-Xhathije, 21), pastaj:

- "Nuk janë njësoj i verbëri dhe ai që sheh, e as ata që besuan dhe bënë vepra të mira, nuk janë të barabartë me atë që bën keq. Sa pak që mendoni!" – (Gafir, 58)

- "A t'i trajtojmë njëlloj ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe turbulluesit në Tokë?! A t'i trajtojmë njëlloj njerëzit e devotshëm dhe njerëzit e mbrapshtë?!" – (Sad, 28), etj.

Të gjitha këto ajete krahasuese, janë nxitje për punë të mira që shpiejnë për në Xhenet dhe largojnë nga Xhehenemi.

Porosia e ajeteve 18-20

- Si myslimanë dhe besimtarë, jemi të urdhëruar për devotshmëri, e cila na nxit dhe na shtyn që të kryejmë me nder dhe përgjegjësi obligimet tona ndaj Allahut të Madhërishëm dhe të largohemi nga çdo gjë që Ai ka ndaluar.

- Ripërsëritja e fjalës për devotshmëri, është për të përforcuar rëndësinë e këtij veprimi nga ana jonë, sepse kjo përveç pastrimit të zemrës, nënkupton pendimin e sinqertë dhe përulësinë ndaj Krijuesit, duke qenë i ndërgjegjshëm se çdo vepër Jona mbikëqyret nga Ai.

- Urtësia e radhitjes hyjnore të këtyre ajeteve dëshmon edhe një herë se ky Kuran është vërtet fjalë e Allahut, sepse ky grup ajetesh së pari filloi me urdhrin për takvallëk-devotshmëri dhe frikërespekt ndaj Zotit, që më pastaj t'ua tërheqë vërejtjen njerëzve që të mos jenë të shkujdesur nga detyrimet fetare e ta "harrojnë" Allahun, e si pasojë ka harresën e vetvetes, duke mos pasur mundësi të dalin nga rrethi vicioz i humbëtirës së tyre. Në fund, bëhet krahasimi në mes mëkatarëve dhe të devotshmëve, duke e përfunduar se vetëm të devotshmit do të jenë fitimtarë, duke shijuar kënaqësitë e Xhenetit. Të gjitha këto krahasime janë bërë qëllimisht, që të vërtetohet se e vetmja rrugë e drejtë është devotshmëria, e cila e mbron njeriun nga zjarri i Xhehenemit nesër në Ahiret.

- vijon -

1. Shih Et-Tergib ve-t-Terhib nga Mundhiriu (2/298). (Hadithiështë i kategorisë'sahih'). 2. Sahihu Muslim, (1342). 3. Transmeton Imam Muslimi(4652); Tirmidhiu (1927). 4. Nexhla'ëSejjid, Vakfatterbevijefisureti-l Hashr, ff. 19-21. 5. Transmetojnë Imam Ahmedi (4.357);Muslimi(1017); Tirmidhiu (2675) dheDarimiu (512). Shih: Et-Tefsiru-l Munir, vëll. XXVIII, f. 479. 6. Imam Shevkani, Fet'hulKadir, vëll. V, f. 273.

Nexhat Ibrahimi

MUHAMED RESHID RIDA-JA (1865-1935)

Nëse Afgani është ideatori i reformave në shoqëri, e Muhamed Abduhu-ja është sendërtuesi praktik i këtyre reformave.

1. Jeta

Nëse Afgani është ideatori i reformave në shoqëri,[1] Muhamed Abduhu-ja është sendërtuesi praktik i këtyre reformave, Reshid Rida-ja[2] është aktivisti i kësaj lëvizjeje dhe prezantuesi i tyre nëpërmjet revistës "*El-Menar*" dhe veprave të tjera, por edhe ai që lëvizjes i dha fizionominë dhe strukturën e fundit. Ky tresh i përbërë nga Afgani, Abduhu-ja dhe Rida-ja konsiderohet shtylla e lëvizjes reformiste, e cila në forma dhe mënyra të ndryshme do të vijë deri në ditët tona.[3] R. Rida-ja mendon se edhe nga babai edhe nga nëna ka prejardhje nga familja e Muhamedit a.s., nëpërmjet Aliut r.a. e me radhë.[4]

Reshid Rida-ja lindi më 1282 h./1865 në fshatin Kalamon, në jug të Tripolit në Liban, me prejardhje nga Bagdadi.[5] Kishte një familje fisnike, modeste dhe të devotshme. Mësimet fillestare i mori në vendlindje dhe në Bejrut. Mësoi edhe te Husein El-Xhisri, alimi i famshëm por edhe te dijetarë të tjerë. E kishte lexuar shumë "*Ihjau ulum'id-dinin*" e Gazaliut dhe ishte bërë pasues i tarikatit nakshibendij. Jetonte thjesht. Edhe pse kishte simpati për sufizmin, ai në disa raste kishte kritikuar publikisht ritualet e disa tarikateve. Edhe nëpër vende publike praktikonte thirrjen për të mirë dhe ndalim-

Në revisten "El Menar" prezantohen synimet e revistës, qëllimi i reformës politike, ekonomike, fetare, kulturore dhe afirmimi i Islamit si sistem i jetës që nuk është në kundërshtim me rrethanat e botës bashkëkohore.

in nga e keqja.[6] Pra, edhe në fillim kishte simpati dhe prirje për letërsi dhe sufizëm, ndikimi që i kishte bërë tek ai revista "El-Urvet'ul-Vuthka" do ta çojë në rrugë të re.[7] Për këtë revistë thotë se *"me ëmbëlsi dhe kënaqësi i kam lexuar; ata tek unë kanë ndikuar sikurse sihri."*[8] Afgani dhe Abduhu-ja në të kishin lënë gjurmë të thella dhe këtë Rida-ja nuk e mohonte.

2. Vizita në Egjipt

Afganiu vdiq më 1314 h./1897, kurse Reshid Rida-ja shkoi në Egjipt ta takojë zëvendësuesin e tij, Muhamed Abduhunë.[9] Ai mendonte se Egjipti ka një liri më të madhe veprimi për t'i shërbyer fesë islame dhe popullit të shtypur myslimanë. Takimi i parë real në Kajro mes tyre shkoi në frymën e reformave organizative dhe arsimore në Ezher. Ridaja i propozoi Abduhusë që ta fillojë komentimin e Kuranit në frymën që e ka prezantuar në revistën "*El-Urvet'ul-Vuthka*", në mënyrë që ajo frymë të shpërndahet ndër intelektualë e studentë.[10] Abduhu-ja e pranoi vetëm pjesërisht këtë propozim, për shpjegimin vetëm të një numri ajetesh për ta arritur synimin e propozuar. Rida-ja i propozoi që të bënte shpjegimin e Kuranit në ligjëratën javore, të cilën gjë Abduhu e pranoi, duke filluar më 1317 h. dhe për ta përfunduar më 1323 h.[11]

3. Revista "El-Menar"

Reshid Rida-ja kaloi nga Shami në Egjipt, pos të tjerash, edhe për shkak se synonte të fillonte revistën "*El-Menar*". Numri i parë doli më 1898, ku prezantohen synimet e revistës, qëllimi i reformës politike, ekonomike, fetare, kulturore dhe afirmimi i Islamit si sistem i jetës që nuk është në kundërshtim me rrethanat e botës bashkëkohore. Thekson se kjo revistë është vazhdim i revistës së mëhershme "*El-Urvet'ul-Vuthka*". Revista e drejtuar nga R. Rida-ja botoi të fundit numrin e tridhjetepestë më 1935.[12] Në përgjithësi revista shkruante gjërat në parime, pa hyrë në detaje, edhe për arsye se dinamika e problemeve ishte e jashtëzakonshme. Për këtë arsye, shpesh ndodh që disa autorë "*El-Menarin*" ta quajnë të djathtë, disa të tjerë të majtë, disa të qendrës e disa fundamentaliste.[13]

4. Reformizmi

Reshid Rida-ja reformizmin e çoi më tutje, sidomos nëpërmjet revistës "*El-Menar*". Ajo u bë dritare për idetë reformiste të tij dhe bashkëmendimtarëve të tij, si Afganiu dhe Abduhuja. Revista i kaloi kufijt arabë, duke u shtrirë në të gjitha vendet myslimane. Madje, kjo tendencë u bë e njohur edhe në Evropë, nga teologë apo orientalistë.

Reshid Rida-ja mendonte se janë pjekur kushtet për reformizëm brenda botës myslimane, duke goditur supersticionin, imitimin e verbër, refuzimin e shkencave të avancuara nga jomyslimanët, si nga qarqet sufiste ashtu edhe nga konservatorët tradicionalistë.[14] Ai mendon se Islami është i pastër kurse përgjegjësinë ua lë dijetarëve të kohës që nuk punojnë sa duhet dhe si duhet për ta ndërprerë këtë devijim.[15] Për ta bërë këtë Rida-ja përkrah mësuesin e tij Abduhunë, duke thënë se duhet të ketë reforma në sistemin edukativ e arsimor. Ky sistem, sipas tij, duhet të përfshijë akaidin (besimin), ahlakun (etikën), fikhun (jurisprudencën), sociologjinë, gjeografinë, historinë, ekonominë, amvisërinë, matematikën, mjekësinë, gjuhën amtare dhe drejtshkrimin.[16]Kjo reformë kërkon bartësit e kësaj reforme, dhe këtë proces e sheh në reformën e "Ezherit", që pas vdekjes së Abduhusë përgjegjësia i mbeti atij.[17]

Por Reshid Rida-ja rrezikun më të madh e shihte nga idetë shekullariste që shtriheshin tek intelektualët arabë. Ai besonte se shekullarizmi jo vetëm që do të dobësojë ummetin por do ta bëjë pre edhe më të lehtë për kolonializmin perëndimor. Sipas K. Armstrongut, Reshid Rida-ja është prej intelektualëve të parë që rekoman-

don themelimin e një shteti tërësisht modern, por edhe tërësisht islam, të bazuar në sheriat, në Kuran dhe Sunet.[18] Ridaja ishte antinacionalist, përkatësisht përkrahës i zjarrtë i panislamizmit, ku nacionalja nuk është përcaktues i jetës, ekonomisë, politikës, por element plotësues. Modernizmi konservativ i Reshid Ridasë ishte përballë modernizmit shekullarist të proveniencës perëndimore.

5. Veprat

Reshid Ridaja ishte mjaft aktiv në fjalën e shkruar. Ka shkruar nga shumë fusha. Princi dhe dijetari Shekib Arsllani, me një rast, shkroi: *"Në kohën tonë nuk kam*



parë njeri më këmbëngulës në lexim, më të vendosur në punë, më të rrjedhshëm në penë dhe më të shpejtë në përgjigje sesa Shejh Ridaja. Sikur ta shpërndanim atë që ai e ka shkruar në pesëdhjetë shkrimtarë, secili do të kishte shkrime të mjaftueshme me të cilën meriton të futet në mesin e shkrimtarëve."[19]

Rida-ja ka shkruar shumë artikuj dhe trajtesa, mbase rreth 200, duke diskutuar me dijetarë të kohës.[20] Ai vdiq më 23. 5. 1354 h. /22. 7. 1935. U varros pranë profesorit të tij Muhamed Abduhusë.[21]

6. Selefizmi

Reshid Ridaja apostrofohet si selefist, edhe pse është pak problematike të kuptohet kjo çështje, nëse me selefizëm kuptojmë atë që "vehabistët" bashkëkohorë e interpretojnë. Është problematike edhe nga këndi se modernizmi është më afër mu'tezilizmit sesa selefizmit!

Nëse e vështrojmë jetën e Reshid Ridasë, do të shohim se ai sidomos pas vdekjes së Abduhusë shkon në drejtim të pikëpamjeve selefiste.[22] Kjo vërehet sidomos:

- Reshid Ridaja më shumë i përfill hadithet sahih krahasuar me Abduhunë dhe Kuranin më shumë e sqaron me Kuran.[23]

- Reshid Ridaja tregon më shumë interes për brezin e selefëve dhe veprat e tyre. Për këtë shkak ai nga shokët e tij u quajt edhe "vehabij".[24] Madje shkruan edhe dy vepra në mbrojtje të Abdulvehabit: Es-Sunnetu vesh-shi'ah ve el-vehhabijjetu ve'r-rafida", dhe El-Vehhabijjune ve'l-Hixhaz.[25]

- Reshid Rida-ja qëndronte larg kolonizatorëve anglezë, francezë, italianë, pos në ndonjë rast të veçantë.[26]

- Reshid Rida-ja ndoqi idealin klasik të selefëve, duke e menduar historinë e hershme islame si model për kombin-shtet modern dhe urban.[27]

- Nuk ishte anëtar i ndonjë organizate masoniste. Madje atë e konsideronte të dëmshme për myslimanët.[28]

- Pas zbulimit të synimeve të shoqërisë Bashkësia për Unitet dhe Përparim (Xhem›ijjet'ul-ittihadi ve't-terekki) për heqjen e halifatit, grup ky që e rrëzoi sulltan Abdulhamidin II, ishte kundër tyre, kurse Ataturkun e përshkroi si ateist dhe renegat.[29]

Reshid Rida-ja kishte dallime të caktuara nga Afgani dhe Abduhu-ja, si rezultat i meditimeve por edhe rrethanave të reja në shoqërinë myslimane të kohës. Disa ide të tyre i kishte braktisur me kalimin e kohës, por disa ide i kishte promovuar deri në vdekje.[30] Në përgjithësi, këto tri personalitete konsiderohen tre përfaqësuesit më të mëdhenj të botës myslimane të frymës reformiste moderniste, me ndikim të fuqishëm deri në ditët tona.

1 Muhammad Fadil bin 'Ashur, Et-Tefsiru ve rixhaluhu, fq. 245, sipas: Zuhdija Adilović, fq. 255. 2. Shkurtimisht për të shih: Nexhat Ibrahimi, Fjalori Enciklopedik Islam, Logos-A, Shkup, 2017 (dorëshkrim). 3. Fahd ibn Abdurrahman Er-Rumi, Menhexh'ul-medrese, po aty, fq. 170. 4. Mexhel-let'ul-menar, XIII, fq. 78 dhe 132; Tefsir'ul-menar, I, fq. 51 dhe XI, fq. 49; Mexhel-let'ul-menar, XXXII, fq. 73, sipas: Zuhdija Adilović, po aty, fq. 59. Studimet historike nuk e provojnë një gjë të tillë, ndërsa personalisht mua kjo gjë nuk më bën përshtypje, sepse përkatësia fisnike vetvetiu nuk do të thotë asgjë, nëse ajo nuk përcillet me ato që njeriun e bëjnë të madh e të vyeshëm. 5. Abdulkadir Muhammed Salih, po aty, fq. 430. 6. Mu'xhem'ul-muel-lifin, III, fq. 293. Fahd ibn Abdurrahman Er-Rumi, po aty, fq. 173. 7. M. M. Sharif, po aty, fq. 473. 8. Muhammed Reshid Rida, I, poaty, fq. 84. 9. Muhammed Reshid Rida, I, po aty, fq.998. 10. Muhammed Reshid Rida, I, po aty, fq. 87. 11.Zuhdija Adilović, po aty, fq. 58-59. 12. Ibrahim Rida Ahmed El-Adevi, Reshid Rida, fq. 135. 13. Enes Karić, Tumačenje Kur'ana, po aty, fq. 22 apo 7-32. 14.Tarik Kulenoviq, po aty, fq. 155. 15. Fahd ibn Abdurrahman Er-Rumi, po aty, fq. 177-178. 16. Ibrahim Rida Ahmed El-Adevi, Reshid Rida, fq. 177-178. 17. Ibrahim Rida Ahmed El-Adevi, Reshid Rida, fq. 207. 18. Tarik Kulenoviq, po aty, fq. 155. M. M. Sharif, po aty, fq. 473. 19. Shekib Arslan: Reshid Rida, fq. 162-163. 20. Ibrahim El-Adevi, Reshid Rida, fq. 268. 21. Ibid., fq. 267. 22. Fahd ibn Abdurrahman Er-Rumi, po aty, fq. 182. 23. Tefsirul-Menar, I, fq. 16. 24. Reshid Rida, El-Vehhabijjune ve'l-Hixhaz, fq. 10, sipas: Zuhdija Adilović, po aty. 25. Ibid.,fq. 10-11. 26. Tefsir-ul-Menar, 10/422. 27. Tarik Kulenoviq, po aty, fq. 156. 28. El-Islamuve'l-hadaretu el-garbijjeh, fq. 96. 29. Mexhel-let'ul-Menar, 16/145 i 19/159. 30. Fahd ibn Abdurrahman Er-Rumi, Menhexh'ul-medrese, po aty, fq. 187.

Prof.ass.dr. Musa Vila

CILËSITË E INJORANCËS, FANATIZMI DHE DISKRIMINIMI, NUK I PËRKASIN ISLAMIT

عَنْ أَبِي ذَرٍّ قَالَ: إِنَّهُ كَانَ بَيْنِي وَبَيْنَ رَجُلٍ مِنْ إِخْوَانِي كَلَامٌ وَكَانَتْ أُمُّهُ أَعْجَمِيَّةً فَعَيَّرْتُهُ بِأُمِّهِ فَشَكَانِي إِلَى النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَلَقِيتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ: يَا أَبَا ذَرٍّ إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ. قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ مَنْ سَبَّ الرِّجَالَ سَبُّوا أَبَاهُ وَأُمَّهُ. قَالَ يَا أَبَا ذَرٍّ إِنَّكَ امْرُؤٌ فِيكَ جَاهِلِيَّةٌ هُمْ إِخْوَانُكُمْ جَعَلَهُمْ اللَّهُ تَحْتَ أَيْدِيكُمْ فَأَطْعِمُوهُمْ مِمَّا تَأْكُلُونَ وَأَلْبِسُوهُمْ مِمَّا تَلْبَسُونَ وَلَا تُكَلِّفُوهُمْ مَا يَغْلِبُهُمْ فَإِنْ كَلَّفْتُمُوهُمْ فَأَعِينُوهُمْ.

Ebu Dherri r.a. tregon: "Vërtet në mes meje dhe një personi nga vëllezërit e mi pati fjalosje. Nëna e tij ishte joarabe dhe unë e turpërova me nënën e tij. Pastaj ai ishte ankuar te Pejgamberi s.a.v.s., e kur e takova Pejgamberin s.a.v.s. ai më tha: "O Eba Dherr, ti je një njeri me cilësi të injorancës." Unë i thashë: "O i Dërguar i Allahut, kush i ofendon njerëzit, ata ia ofendojnë babanë dhe nënën e tij." Ai i tha: "O Eba Dherr, vërtet ti je njeri me cilësi të injorancës. Ata (robërit) janë vëllezërit tuaj në duart tuaja. Ushqejini ata nga ajo që ju hani, vishni nga ajo që ju vishni e mos i rëndoni me çka nuk mund ta përballojnë, e nëse i ngarkoni, atëherë ndihmojini."[1]

Fjalët e panjohura në hadith

Fjala *ajjertuhu* ka kuptimin e *turpit, me i dhënë përkatësi turpi*. Thuhet se i ka thënë *"O djali i zezakes"*.[2] Në një version tjetër thuhet "*e kam ofenduar një person, apo në mes meje dhe atij janë shkëmbyer ofendime, të shara"*.

Fjala *raxhulun – burrë, person,* thuhet ky person ka qenë muezini Bilali r.a., që ishte liruar nga robëria nga Ebu Bekri r.a..

Fjala *e'axhemije (e huaja)* d.m.th. secili person që nuk e flet pastër gjuhën arabe konsiderohet *i huaj – e'axhemije*, pavarësisht a është arab apo joarab[3]. Nëna e Bilalit ishte e huaj, me prejardhje nga Etiopia.

Thënia *"fike xhahilijjetun" – "Ti ke cilësi të injorancës"* apo ofendimi është moral dhe veti e injorancës.

Fjala *havele* është emër që i dedikohet robit dhe robëreshës. Njëjësi është *hailun – rob*. Ky emër përdoret edhe për *çobanin, rojtarin*. Thuhet se përdoret ky emër për *pronësi - ettehvil* , d.m.th. me qenë pronar apo *të posedosh - ettemlik*.

Fjala *dhe mos i rëndoni*, d.m.th. robërit mos i rëndoni fizikisht me barra dhe punë të rënda apo me ndonjë *urdhër që është i vështirë për t'u kryer*.

Shpjegimi i hadithit

Hadithi bazë tregon dhe udhëzon se nuk lejohet assesi që myslimani ta ofendojë vëllanë e tij, as t'i japë përkatësi turpi, as të krenohet me përkatësinë e prindërve e as të ndihet me i ngritur se të tjerët edhe nëse tjetri është shërbëtor, çoban apo rob.

Sahabët po qëndronin së bashku kur papritmas Ebu Dherri e kishte turpëruar Bilalin r.a. duke i thënë "O djalë i zezakes". Atëherë Bilali iu ankua Pejgamberit s.a.v.s. për këtë ofendim dhe Pejgamberi u hidhërua shumë dhe e qortoi Ebu Dherrin duke i thënë se ofendimi është cilësi dhe veti paraislame, ndërsa në Islam njerëzit janë të barabartë në të gjitha dispozitat e fesë dhe nuk ka vend për diskriminim për shkak të etnitetit, gjuhës apo ngjyrës.

Në kushtetutën islame ekziston vetëm një emër, ai është musliman. Nuk ka njerëz të zinj, ezmerë, të kuq apo të bardhë. Ne nuk njihemi përmes ngjyrave, as përmes përkatësive, as etniteteve, as gjuhëve dhe as vendeve. Ne njihemi vetëm me fjalën "*La ilahe il-lall-llah"* dhe në bazë të adhurimit[4].

Përparësia matet me devotshmëri

Përparësia e vërtetë qëndron në devotshmëri. Ai që nuk ka devocion nuk ka pse të mbështetet në përkatësinë apo gjenealogjinë, ndërsa ai që është i shtresës së ulët, gjenezën e përfiton me devotshmëri. Allahu xh.sh. thotë:

"Vërtet se më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që është më i devotshmi." (El-Huxhuratë, 13)

Ebu Dherri r.a. tregon se Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: *"Shiko,*

"O ju njerëz, vërtet Zoti juaj është një dhe babai juaj është një (Ademi). Kini kujdes! Nuk ka përparësi arabi nga i huaji, as i huaji nga arabi, as i kuqi nga i ziu, as i ziu nga i kuqi, përveçse me devocion (devotshmëri)."

ti nuk je më i mirë se njeriu i kuq e as i zi, përveçse përparësia është me devotshmëri."[5]

Pejgamberi a.s. që në fillim të thirrjes islame e kishte vendosur këtë parim, se nuk ka pasuri, as pozitë, as etni, as ngjyrë, por ka devotshmëri dhe adhurim. E kur në skenë u shfaq Ebu Dherri me këtë ofendim dhe e shkatërroi atë parim, atëherë ai s.a.v.s. iu përgjigj: *"Vërtet ti je njeri me cilësi të injorancës paraislame"*, d.m.th. kërkoi nga ai që të distancohet menjëherë nga veset e së kaluarës dhe të ndihet i njëjtë me të ziun, me ezmerin dhe me të kuqin. Thuhet se kjo ngjarje kishte ndodhur ende pa e ditur ndalesën e saj dhe kjo cilësi kishte mbetur tek Ebu Dherri për shkak se për një kohë të gjatë ai kishte qenë larg nga Pejgamberi s.a.v.s..

Barazinë ndërmjet njerëzve Resulullahu s.a.v.s. e kishte proklamuar edhe në hytben gjatë ditëve të haxhit në Mine:

"O ju njerëz, vërtet Zoti juaj është një dhe babai juaj është një (Ademi). Kini kujdes! Nuk ka përparësi arabi nga i huaji, as i huaji nga arabi, as i kuqi nga i ziu, as i ziu nga i kuqi, përveçse me devocion (devotshmëri)."[6]

Në rastin kur i Dërguari s.a.v.s. tuboi tre muslimanë nga tre vende të ndryshme, respektivisht Selmanin nga Persia (Irani), Suhejbin nga romakët e bardhë dhe Bilalin nga Etiopia, një arab i quajtur Kajs hyri brenda dhe i quajti këta të huaj *el-e'axhemij.* I zemëruar shumë, i Dërguari s.a.v.s. tha: "Edhe yt atë është i njëjtë, edhe feja e juaj është e njëjta, ndërkaq të qenët arab për të cilën, me sa po shihet, po krenohesh aq shumë, nuk i takon as babait tënd e as nënës sate (duke menduar se Ademi dhe Havaja janë prindërit e të gjithë njerëzve)." Pastaj deklaroi:

"Nuk është prej nesh (prej umetit islam) kush propagandon fanatizmin fisnor (etninë), kush lufton për të dhe kush e jep jetën për të."[7]

Eliminimi i robërisë përmes vëllazërisë

Thënia në hadith: *"Ata (robërit) janë vëllezërit tuaj në duart tuaja."* Në këtë pjesë të hadithit Pejgamberi s.a.v.s. robërve u jep epitetin e vëllazërisë. Me këtë barazi që shpreh eviton çdo diskriminim racor dhe strukturor në mes njerëzve në shoqëri. Ky deklarim i Pejgamberit a.s. ishte një hap i madh drejt eliminimit të robërisë në mënyrë graduale. Në këtë kohë i tërë sistemi shoqëror ishte i ndërtuar në kurriz të robërisë, ndërsa deklarata të tilla ishin të çuditshme për shoqërinë e asaj kohe. Sa për ilustrim, thuhet se qyteti i Romës në perandorinë romake kishte dyqind e katërmbëdhjetë mijë qytetarë të lirë, por më tepër se njëzet milionë robër apo skllevër. Ligji parashihte dënime të ndryshme sa u përket këtyre shtresave edhe pse vepra e bërë ishte e njëjtë. Robi që vidhte, vritej, kurse i liri mjaftonte ta kthente sendin e vjedhur. Me një fjalë robërit as që trajtoheshin si njerëz, e lëre më si vëllezër.

Në këto momente kur po i shkruaj këto rreshta marr informacion nga lajmet e ditës se vetëm në Londër të Britanisë së Madhe në këtë kohë ekzistojnë afro trembëdhjetë mijë njerëz si skllevër modernë, nga trafikimi i qenieve të gjalla, nga prostitucioni dhe ushtrimi i punëve të dhunshme. Kjo është një shenjë e qartë se aty ku nuk ka Islam, njerëzit prapë do t'i kthehen të kaluarës së errët, shfrytëzimit të njëri-tjetrit me dhunë.

Në mënyrë të qartë Pejgamberi a.s. kërkoi që ushqimi dhe veshja të jetë e barabartë në mes qytetarëve të lirë dhe robërve apo edhe shërbëtorëve.

Thënia në hadith *"mos i rëndoni"* është urdhër i prerë që ngarkesa të mos jetë jashtë suazave njerëzore dhe se robi apo shërbëtori duhet të ngarkohet me atë që mund të bartë zotëria. Mos i ngarkoni fizikisht jashtë energjisë së tyre, edhe psiqikisht mos i ngarkoni me urdhra që janë të vështirë dhe mos u bëni presion që ata të ndihen të kategorisë së dytë apo edhe më të ulët. Mund t'i ngarkoni ata aq sa ju mund të përballoni, por nëse i ngarkoni më shumë, jini të kujdesshëm dhe ndihmojini në punët e tyre fizike dhe mendore.

Kush është Ebu Dherri

Emri i tij është Xhundeb, d.m.th. lloj zogu, djali i Sufjan el-Gafarij. Ai konsiderohet prej sahabëve të vjetër, ishte i pesti që përqafoi Islamin. Vinte nga fisi Gaffar, i cili ishte fis problematik dhe i njohur për plaçkitjen e udhëtarëve. Kur e pa Pejgamberi s.a.v.s. duke ardhur për të hyrë në Islam, buzëqeshi duke thënë: *"Vërtet kë do, e udhëzon Allahu."* Kjo ngjarje kishte ndodhur në Mekë. Pejgamberi a.s. e urdhëroi të kthehej te fisi i vet për t'i udhëzuar në rrugën e vërtetë. Ai ishte guximtar pasi e pranoi Islamin dhe në prezencë të politeistëve e ngriti zërin duke cituar dëshminë – shehadetin, edhe pse kjo i kushtoi me rrahje. Kishte qëndruar disa vite tek fisi i tij dhe kur Pejgamberi a.s. ishte shpërngulur në Medinë, ky kishte arritur që të merrte me vete edhe fisin e tij – Gaffar dhe të shkonte në Medinë. Kur i pa Pejgamberi a.s., u mahnit dhe përpiqej që të kujtonte emrin e tij dhe i tha Ebu Nemle[8]. Ai ia kujtoi se e kishte Ebu Dherr. Pejgamberi a.s. i tha: "Po, Ebu Dherr". Pastaj filloi duke u lutur:

"Ky është fisi Gaffar, Allahu e pastë falur, erdhën në Islam, Allahu i shpëtoftë!"[9]

Mandej u drejtua nga ky trim i madh me fjalët:

"Toka nuk ka bartur e as qielli nuk ka strehuar njeri më të sinqertë të fjalës sesa Ebu Dherri."[10]

Ai nuk kishte marrë pjesë në luftën e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut për shkak se ishte te fisi i tij larg nga Pejgamberi a.s., por ishte shembull në luftën e Tebukut. Atë e kishte vonuar deveja e tij, e cila i kishte ngordhur rrugës, prandaj ky vazhdoi rrugën në këmbë në shkretëtirë dhe të nxehtë derisa arriti Pejgamberin a.s. me shokët e luftës. Pejgamberi a.s. kur e pa i tha: *"Për sa hapa që ke bërë, Allahu për aq t'i shleftë mëkatet!"*

Pejgamberi a.s. fliste fjalë të mira për të. Ebu Dherri shpesh e pyeste për këshilla. Njëherë i tha Pejgamberit a.s. që ta këshillojë për diçka dhe Pejgamberi a.s. e këshilloi duke i thënë: "Të këshilloj me lexim të Kur'anit, sepse ai në tokë është dritë për ty, e në qiell përkujtim për ty." Ebu Dherri i tha: "Më shto edhe diçka." Ai i tha: *"Gjithnjë shiko atë që është më i varfër se ti, e mos shiko atë që është më i pasur se ti, se vërtet vetëm kjo është më e drejtë për të mos e përbuzur begatinë e Allahut për ty."*[11]

Nganjëherë Pejgamberi s.a.v.s. i drejtonte pyetje Ebu Dherrit:

"Cili është qëndrimi yt, nëse has në udhëheqës (të korruptuar) që përvetësojnë pasuri?" Ai u përgjigj: *"Me shpatë do t'i luftoj ata."* Atëherë Pejgamberi a.s. buzëqeshi dhe i tha: *"A do të të tregoj se cila është më mirë (të veprosh)? Përmbaju derisa të më takosh mua."*

Pasi kaloi koha e Ebu Bekrit dhe Omerit r.a., pasuan njerëz të cilët përvetësuan paranë dhe pronën publike, kurse në anën tjetër kishte të atillë që nuk u jepnin të varfërve. Ebu Dherri duke ecur rrugës së tregut ngrinte zërin duke thënë: *"Përgëzoj ata që depozitojnë pasurinë, arin dhe argjendin me ndëshkim në zjarr."*

Kur Ebu Dherri pati rastin të shohë pallatin që kishte ndërtuar Muaviu, i tha:

"Nëse e ke bërë me paranë e muslimanëve, kjo është tradhti, e nëse e ke bërë me paranë tënde, kjo është e tepërt (israfë). O Muavi, vërtet ti të pasurin e ke pasuruar edhe më tepër, e të varfrin e ke varfëruar."

Ishte i njohur për asketizëm dhe thuhet se i përngjante Isait a.s. në tërheqjen prej kësaj bote. Ai e konsideronte haram depozitimin e pasurisë tek individi më tepër sesa ka nevojë. Ai thoshte: *"Mua më mjafton kafshata ditore."*

Ebu Dherri kishte refuzuar të jetë emir në Irak. Ai kishte thënë: *"Për Allahun jo, ... assesi nuk mund të më anoni në dynjanë tuaj."*

Kështu ai kishte zgjedhur të jetonte në shkretëtirë në Rrebdhe, i izoluar prej njerëzve, vetëm me gruan dhe djalin e tij të vogël. Pejgamberi a.s. në luftën e Tebukut, kur e pa të vetmuar duke ardhur në këmbë tha: *"Allahu e mëshiroftë Ebu Dherrin, i vetëm po ecën, i vetëm do të vdesë dhe i vetëm do të ringjallet."*[12]

Vërtet ai ishte i vetëm duke ecur për në luftën e Tebukut, ishte i vetëm kur vdiq në shkretëtirën Rrebdhe dhe i vetëm do të ringjallet inshaAllah, ngase mirësitë e tij ishin të shumta, kështu që afër tij nuk ka vend për të tjerët.

Ishte njeri me tipare të veçanta, zhvilloi një jetë ndryshe nga të tjerët, ishte shumë guximtar, tërë jetën ia kushtoi Islamit, askujt nuk iu nënshtrua për çështje të kësaj bote, askënd nuk e imitoi në pasuri, veshje, dukje dhe qëndrime. Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

"Askush të mos imitojë e të thotë nëse njerëzit bëjnë mirë, bëj edhe unë, e nëse bëjnë keq, bëj edhe unë. Edukoni veten të bëjë mirë kur ata bëjnë mirë, e kur bëjnë keq, atëherë ju të mos bëni padrejtësi."[13]

Ebu Dherri ka transmetuar nga Pejgamberi a.s. 281 hadithe. Ai vdiq në shkretëtirën Rrebdhe afër Medinës në vitin 32 h. Përgatitjet e varrimit dhe faljen e xhenazes ia kishte bërë Abdullah bin Mes'udi. Ky ishte një paralajmërim i Pejgamberit a.s.:

"Për Allahun, një njeri nga ju do të vdesë në shkretëtirë e në të do të prezantojnë një grup prej besimtarëve."

Dhe vërtet kështu ndodhi, në xhenazen e tij ishin prezentë grupi i besimtarëve me në krye Ibn Mes'udin.

1. "Sahihul Buhari", Kitabul Iman, vëll. I, fq. 13, nr. 30; "Sahihu Muslim", vëll. III, fq. 1882, nr. 1661. 2. Ibn Haxher, "Fet'hul Barij", vëll. I, fq. 86. 3. El-Ajni, "Umdetul Karij", vëll. I, fq. 208. 4. Aid El-Karnij, "El-misku vel ainberu fi hutabil minber", fq. 70. 5. "Fet'hul Barij", vëll. X, fq. 468; "Musned Ahmed", vëll. V, fq. 158. 6. "Musned Ahmed", vëll. 47, fq. 478, nr. 22391. 7. "Sunen Ebi Davud", vëll. XIII, fq. 325, nr. 4456. 8. En-Nemël është buburrec, kurse më të voglit të buburrecit i thuhet Dherr. 9. "Sahihul Buhari", vëll. IV, fq. 95, nr. 951; "Sahihu Muslim", vëll. III, fq. 446, nr. 1095. 10. "Sunen Ibn Maxhe", vëll. I, fq. 181, nr. 152. 11. "El-Mu'xhemul Kebir lit-Taberanij", vëll. II, fq. 214, nr. 1628. 12."El-Mustedrek ala -s-sahihajni lil Hakim", vëll. III, fq. 52, nr. 4373. Ibn Haxher, "El-Isabe fi temjiz Es-Sahabe". 13. "Sunen Et-Tirmidhij", vëll. VII, fq. 290, nr. 1930.

Carolyn Anne Brunelle

Veprat e Imam Tahaviut

Katalogu më komplet i veprave të Tahaviut në traditën biografike është në El-Xhewahir 'ul-Mudije të Ibn Ebi 'l-Wefa (vd. 775 h./1373), që është dhe burimi për titujt e listuar më poshtë përveç ku është përmendur ndryshe.

Në faqet në vijim, do të jap një përmbledhje të veprave të atribuuar Tahaviut, të humburat dhe të gjeturat, për të sugjeruar një fushë të gjerë të aktivitetit të tij intelektual në fushën e teologjisë, tefsirit, historisë/biografisë, hadithit dhe fikhut. Mirëpo, tri veprat që janë subjekt i këtij studimi, tejkalojnë kategoritë individuale të fikhut, hadithit ose tefsirit. *Sherh me'ani 'l-Athar* dhe *Sherh mushkil 'il-Athar* mund të konsiderohen vepra edhe të hadithit edhe të fikhut, ndërsa *Ahkamul-Kuran* është përshkruar si formë e specializuar e tefsirit. Ajo që bashkon të tri veprat dhe i dallon ato prej shkrimeve të tjera të Tahaviut është lloji i aktivitetit intelektual që ato paraqesin - një aktivitet që unë e kam quajtur 'hermeneutikë praktike'.

A) Në teologji

Vepra e mirënjohur e Tahaviut *Akida*[3], së bashku me atë të bashkëkohësit të tij Esh'ariut (vd. 324H/935-6), përfaqëson një prej deklaratave më të hershme të besimit sunit të vërtetësisë së padyshimtë.[4]*Akida* vazhdon të mbetet fokusi i një tradite aktive të komentimeve në ditët e sotme.[5]

Dy trajtesa të shkurtra teologjike (ose mbase dy versione të të njëjtës trajtesë) të lidhura bashkë, i janë atribuuar Tahaviut dhe mbahen nga Princeton University Libraries, ndonëse mbesin të pavërtetuara dhe nuk janë transmetuar në traditën bibliografike.[6]

Tahaviu po ashtu mund të ketë shkruar një hereziografi të titulluar *Kitab 'un-nihal we ahkamiha we sifatiha we exhnasiha* (Sektet fetare: Ligjet e tyre, tiparet dhe llojet).[7]

B) Biografi/Histori

Vepra kryesore historike dhe biografike e Tahaviut, *Et-Tarih 'ul-kebir*, nuk ekziston më, por ishte një burim (mbase indirekt) për *El-Xhewahir 'ul-Mudija* të Ibn Ebi El-Wefa-së.[8]

Po ashtu, të humbura janë veprat e tij *Menakib Ebi Hanifa* dhe *Radd ala Ebi Ubejd fima Ahta'a fiha)*, e cila është në lidhje me *Kitab 'un-Neseb* të Ebu Ubejd el-Kasim ibn Selam (vd. rreth. 224 h./838).[9]

C) Tefsir

Është Transmetuar që Tahaviu ka shkruar një mijë faqe rreth Kuranit. Ajo vepër mund të jetë identike me dorëshkrimin e pavërtetuar të titulluar *Tefsirul-Kuran,*e zbuluar në *Xhami esh-Shejh* në Aleksandri që mban emrin e Tahaviut dhe fillon me suren 8 (El-Enfal).[10]

Vepra pjesërisht e gjetur *Ahkamul-Kuran* është përshkruar në studimet tjera si një formë e specializuar e komentimit të Kur'anit, për shkak se ajo në mënyrë sistematike parashtron rregullat juridike që mund të nxirren prej secilit ajet juridik së bashku me burime të tjera të ligjit.[11] Mirëpo, siç kam pohuar më sipër, emërtimi i *Ahkamul-Kuran* të Tahaviut si vepër e Tefsirit nuk u jep hakun ambicieve hermeneutike të saj, dhe unë në këtë studim atë e trajtoj si vepër të hermeneutikës praktike.

D) Hadith

Tre prej veprave kryesore të Tahaviut, *Sherh me'anil-Athar*, *SherhMushkilil-Athar* dhe *Ahkamul-Kuran*, të gjitha përmbajnë diskutime substanciale rreth autoritetit të hadithit profetik dhe shkallë të ndryshme të diskutimit të besueshmërisë së hadithëve të caktuara dhe transmetuesve. Dy të parat janë në tërësi dhe janë botuar në disa edicione;[12] e fundit është përshkruar sipër, nën 'Tefsir'. *Sherh me'anil-Athar* dhe *Sherh Mushkil-il-Athar* ishin influenciale brenda traditës hanefite për justifikimin e fikhut hanefi, në bazë të hadithëve pejgamberike.

SherhMe'anil-Athar në veçanti tërhoqi një numër komentimesh dhe shkurtimesh. Sulltani Memluk El-Mu'ejjed (sundoi 815-824 h. / 1412-1421) krijoi një vend të posaçëm dedikuar ligjërimit të *Sherh Me'anil-Athar* në xhaminë mu'ejjidite në Kajro.[13] Kjo pozitë iu dha hanefiut Bedruddin El-Ajniut (vd. 855 h. / 1451), i cili shkroi dy komentime për këtë libër.[14]

Dijetarë tjerë të cilët kanë shkruar komentime ose shkurtime mbi

Sherh me'anil-Athar përfshijnë Ibn Rushd El-Xhedi (vd. 520 h./1126) dhe biografinë e Tahaviut, hanefiun Ibn 'ul-Wefa.[15]Gjersa *Sherh Mushkilil-Athar* nuk tërhoqi komentime të ngjashme, ajo është shkurtuar (përmbledhur) nga juristi andaluzian maliki Ebu 'l-Welid El-Baxhi (vd. 474 h./1081) dhe pastaj u shkurtua edhe më tutje nga Jusuf ibn Musa ibn Muhamed El-Melati (vd. 803 h./1400),[16] një jurist hanefi aktiv në Kajro dhe një prej mësuesve të Bedruddin El-Ajniut. Një tjetër shkurtim i është atribuuar Ibn Rushd El-Xhedit.[17]

Një trajtesë shumë e shkurtër në terminologjinë e hadithit, *Et-Teswijetu bejne haddethena we ahbarena*, po ashtu ka mbijetuar.[18] Në të, Tahaviu argumenton kundër muhadithëve, të cilët mbanin qëndrim që *haddethena* ekskluzivisht tregon se hadithi është i recituar nga transmetuesi, ndërsa *ahbarena* duhet të përdoret për rastet në të cilat pranuesi i hadithit ia reciton atë transmetuesit origjinal, i cili pastaj konfirmon që recitimi i tij është korrekt. Kundër kësaj, ai argumenton që Kur'ani dhe Suneti përdorin foljet *ahbare* dhe *haddethe* në mënyrë të ndërsjellë, prandaj kështu munden edhe transmetuesit e hadithit.

Në *Sherh Mushkil el-Athar*, Tahaviu po ashtu i referohet një vepre tjetër në kritikim të hadithit, tani e humbur, e titulluar *Nakdul-Mudal-lisin alel-Kerabisi*.[19] Ne kemi pasur rastin të përmendin sipër që Tahaviu është transmetuesi i Sunenit të Shafiut përmes El-Muzanit. Së fundi, biblioteka Huda Bahsh në Patna, Indi, mban një vepër të titulluar *Sahihul-Athar*,[20]mirëpo, asnjë biograf nuk ia ka atribuuar një vepër të tillë Tahaviut. Me sa di unë, askush ende nuk e ka vërtetuar autenticitetin e dorëshkrimit ose përshkruar përmbajtjen e tij.

E) Fikh

Një numër i veprave kryesore juridike të Tahaviut janë edhe ekzistuese edhe të botuara. Tri veprat që formojnë subjektin e këtij studimi, Sherh Me'anil-Athar, Sherh Mushkilil-Athar dhe Ahkamul-Kuran, trajtojnë sikurse fikhun ashtu edhe hadithin. Vepra *Muhtesar fi 'l-fikh* e Tahaviut paraqet *muhtesarin* e parë hanefi, dhe ajo ka tërhequr komentime të shumta prej hanefijve të mëvonshëm, përfshirë El-Xhessasin (vd. 370 h. / 980-981) dhe Serahsiun (vd. rreth. 483 h./1090).[21] Në *Muhtesar*, Tahaviu vendos rregullat e fikhut aplikativ (*furu'*) gati tërësisht pa justifikuar ose sqaruar, ndonëse ai thotë qëndrimin e vet në shumë çështje juridike ku ka divergjencë në mesin e hanefijve të mëhershëm.[22]Vepra e tij e gjatë *Ihtilaful-ulema*, ekzistuese vetëm në formë të shkurtuar nga *El-Xhesasi*, shënon mospajtimet në mes juristëve sunitë të të gjitha shkollave juridike dhe ruan qëndrime të rëndësishme të juristëve të hershëm.[23] Ndonëse shkurtimi i El-Xhessasit përmban ndonjëherë justifikime të qëndrimeve juridike të Tahaviut, edhe ajo, kryesisht paraqet qëndrimet e ligjit aplikativ të parashtruar nga juristë dhe shkolla të ndryshme. Për shkak se *Muhtesar* dhe *Ihtilaf 'ul-ulema* merren me qëndrimet juridike e jo me atë se si këto rregulla janë nxjerrë, ato përmenden rrallë në këtë studim.

Tahaviu është po ashtu i rëndësishëm si autor i një vepre me titullin *Shurut* të hershëm hanefij. Jeanette Wakin e ka edituar, analizuar dhe përkthyer kapitujt e shitjet të veprës pjesërisht ekzistuese *Esh-Shurut 'ul-Kebir*, në veprën e saj *Function of Documents in Islamic*



Law;[24] dy fragmente shtesë të veprës janë edituar nga Schachti.[25]Për dallim prej kësaj, *Esh-Shurutus-Sagir* është ekzistuese në tërësi dhe është botuar me fusnota për të përfshirë fragmentet ekzituese të *Esh-Shurutul-Kebir*.[26]*Shurutul-Ewsat,*që e përmend Ibn Ebi 'l-Wefa dhe të tjerë, tani është e humbur.

Tradita biografike po ashtu i atribuon vepra tjera Tahaviut që nuk ekzistojnë më. Veprat e tij *Sherh el-Xhami el-Kebir* dhe *Sherh el-Xhami es-Sagir* i referohet dy veprave të mëdha të Muhamed ibn el-Hasan el-Shejbaniut (vd. 189H/805). Ibn el-Nedim liston veprat e titulluara *El-Mehadir wel-Sixhilat*, *El-Wesaja* dhe *El-Fera'id* në pjesën e tij mbi Tahaviun. Mirëpo, këto me gjasë janë identike me kapitujt e titujve që gjenden brenda përmbledhjeve të mëdha të Tahaviut.[27] Ibn 'l-Wefa po ashtu transmeton që Tahaviu shkroi "një libër bazuar në Kitab 'ul-Azl." Tjera vepra juridike të humbura përfshijnë *El-Nawadirul-fikhije*, *Hukm eradi Mekke*, *Kasm el-fej wel-gana'im*, *Ihtilaf el-Riwajat ala madhhabil-Kufijin*, *El-Ashriba*[28] dhe *Er-Reddu ala Isa ibn Aban*.[29]

F) Vepra të humbura të papërcaktuara

Ibn Ebil-Wefa transmeton që Tahaviu shkroi një libër të titulluar *El-Newadir wel-Hikajat.* Në veprën *El-Hawi fi siratil-Imam et-Tahawi,* El-Kewtheriu përmend një vepër nga Tahaviu mbi fatkeqësitë (*rizzija*) për të cilën ai nuk ofron burim.[30] Ismail Pasha po ashtu i atribuon Tahaviut vepra të titulluar *Hitabat* dhe *el-Mishkat*, po ashtu pa dhënë shenjë për burimet e citimeve të tij.[31]

Përktheu: Fatih Ibrahimi

1. Burimi i përkthimit: From Text to Law: Islamic Legal Theory and the Practical Hermeneutics of Abu Jafar Ahmed al-Tahawi, fq. 37-45. (Përkthyesi). 2. Ibn 'l-Wefa, El-Xhewahir 'ul-Mudijja, 1.165-7. Lista më e hershme e veprave të Tahaviut gjendet në Fihrist të Ibn En-Nedimit, vëll. 2, fq. 1.31-2; Ajo përmban të gjitha veprat e vërtetuara të Tahaviut që janë ekzistuese sot, si dhe disa të humbura. Lista e Ibn Ebi 'l-Wefa përmban gati të gjitha veprat e gjetura tek Ibn En-Nedimi dhe përfshin afërsisht dhjetë tituj shtesë. Këto duket se janë vepra të vogla, përveç Et-Tarih 'ul-Kebir dhe Et-Tefsir, për të dyja prej tyre tradita biografike sugjeron që kanë qenë përmbledhje të mëdha. Unë nuk e kam identifikuar burimin e Ibn Ebi 'l-Wefasë për këta tituj shtesë. Lista tjera tërësore për veprat e Tahaviut mund të gjenden në El-Fawaid 'ul-Bahijja 60 të el-Leknewiut, dhe Kinalizadeh, Tabakat 'ul-Hanefije, 2.26, por këto duket se janë të nxjerra nga Ibn Ebi 'l-Wefai. 3. Kjo vepër është publikuar në gjuhën shqipe, me miratimin e përkthyesit: Shejh Vehbi Sulejman Gavoçi, Nyja e besimit sipas Imam Tahaviut, Logos-A, Shkup, 2015. (Përkthyesi). 4. Për të dy këto, shih W. Montgomery Watt, Islamic Creeds: A selection (Edinburgh: Edinburgh University Press, 1994), 41-56. Interesant, Ibn Ebi 'l-Wefa nuk përfshin Akiden në listën e tij të veprave të Tahaviut, mirëpo, ajo është përmendur nga Ibn En-Nedimi, Fihrist, vëll. 2, fq. 1.32. 5. Komentimet e Tahaviut ndaj Akides janë të shumtë për t'u listuar këtu. Më të rëndësishmet prej tyre janë ato të Ibn Ebi El-Izz (vd. 792h./1390), Sherh 'ul-Akida et-Tahavije, ed. Abd Allah ibn Abd El-Muhsin Et-Turki dhe Shuajb El-Arnaut (Bejrut: Mu'assesat er-Risala, 1987). Një numër i komentimeve mesjetare dhe moderne janë mbledhur në tre vëllime Xhami esh-Shuruh we't-Ta'likat el-ilmija ala 'l-Akida et-Tahavija (Kajro: Dar Bidaja lil-I'lam we'l-Nashr, 2010). 6. Et-Tahawi, "Hadha kitab 'ut-Tahawi fi usul 'id-din", ms., Princeton, Arabic, Third Series, no. 288. Fol. 108a-125b., 1714. 7. Kewtheriu përmend veprën në El-Hawi fi Sirat 'il-Imam et-Tahawi, 38, mirëpo pa cituar burimin; unë nuk kam hasur në përmendje të saj në traditën e hershme biografike. 8. Rreth huazimeve nga Et-Tarih 'ul-Kebir nga Ibn Ebi el-Wefa, shih Nurit Tsafrir, "Semi-Hanafis and Hanafis Biographical Sources," 74. 9. Mirëpo, Tahaviu prapë citon Kitab en-Neseb të Ebu Ubejdit në Sherh Mushkil el-Athar, shih më poshtë, fq. 49, fusnota 161. (Shënim shtesë, fusnota 161 shkruan: "Et-Ṭaḥawi, Mushkil, 5.429, 12.199"; Përfundon fusnota). 10. Institute of Arabic Manuscripts, Fihris el-Mekhtutat el-Musawwere, ed. Fu'ad Sejjid (Kajro: Dar er-Rijad, 1954-1963), 1.29-30. 11. Dy vëllimet e para të katër vëllimeve janë ekzistuese në një kopje. Sa'd 'ud-din Unal, editori modern i tekstit, shënon që dy vëllimet e para duket se janë humbur ose janë vjedhur prej bibliotekës në provincën Amasja në Turqinë verilindore ku doreshkrimi është gjetur, bazuar në faktin që numrat e katalogut tregojnë katër vëllime (Unal, "Mukaddimet et-Tahkik", 11). Mirëpo, për dallim prej tefsirit tradicional, kjo vepër është e organizuar sipas kapitujve të fikhut, jo kapitujve të Kur'anit. Dy vëllimet e para përmbajnë kapitujt mbi namazin (salat) deri tek izolimi në xhami (i'tikaf), ndërsa vëllimi i dytë fillon me Haxhin (pelegrinazhi) dhe mbaron me lirimin e robërve (mukatebe). Unë nuk kam gjetur përmendje në traditën e komentimit për Ahkamul-Kuran, ndonëse vepra përmendet gjerësisht në traditën biografike. 12. Sherh Me'ani 'l-Athar së pari është botuar në dy vëllime në Indi në fund të shekullit 19-të (Lucknow: Al-Mektebea el-Mustafai, 1882-1883). Ky studim përdor botimin me indeks, Et-Tahawi, Sherh me'ani 'l-Athar, ed. Muhammed Sejjin Xhed el-Hakk, Muhammed Zuhri el-Nexhar dhe Jusuf Abdurrahman el-Merashli, 5 vëll. në 4 (Bejrut: Alam el-Kutub, 1994). Botimi i shtypur më i hershëm i Sherh Mushkil el-Athar (Hyderabad: Metba'Mexhlis Da'iret el-Mearif en-Nidhamije el-Kaine fi 'l-Hind, 1914-1915) përmban rreth gjysmën e veprës.Teksti i plotë mund të gjendet në: Et-Tahavi, Sherh Mushkil el-Athar, ed. Shuajb el-Arnaut, 16 vëllime (Bejrut: Muassesat er-Risala, 1994), i cili është botimi i përdorur në këtë studim. 13. Kevtheriu, El-Hawi, 33-34. 14. Bedruddin El-Ajni, Megani el-Ahjar fi sherh esami rixhal me'ani el-Athar, ed. Muhammed Hasan Muhammed Hasan Ismail (Bejrut: Dar el-Kutub el-Ilmije, 20060); El-Ajni, Nuhab el-efkar fi tenkih mebani el-Ahbar fi Sherh Me'ani 'l-Athar, ed. Ebu Temim Jasir ibn Ibrahim (Bejrut: Dar en-Newadir, 2008). 15. Për një listë komentimesh dhe shkurtesash të Sherh me'ani el-Athar, shih Unal, "Mukaddimet et-Tahkik," 43-44. 16. Sezgin, Geschichte, 1.440. Shkurtimi i Jusuf ibn Musa El-Hanefi është botuar si El-Mu'teas min el-Muhtesar min Sherh Mushkil el-Athar (Bejrut: Alam el-Kutub, 1976). 17. Unal, "Mukaddimet et-Tahkik," 43. 18. Et-Tahawi, Et-Teswijjetu bejne Haddethena we Ahharena, në Hams Resa'il fi Ulum 'il-Hadith, ed. Abd el-Fettah Ebu Guda (Bejrut: Dar el-Besha'ir el-Islamije, 2002). Kjo trajtesë nuk figuron te katalogu i Ibn Ebi 'l-Wefasë, por është përmendur nga Ibn En-Nedimi (Fihrist,vëll. 2,pt. 1.32). 19. Et-Tahawi, Mushkil, 6.382. Në Sherh Mushkil el-Athar, Et-Tahawi vetëm jep shenjë që ai ka shkruar një libër mbi El-Kerabisin; titulli më i gjatë i dhënë sipër është marrë prej traditës biografike. El-Kerabisi (vd. 245 h./859 ose 248 h/862) ishte një dijetar hadithi dhe jurist në fillim i asociuar me shkollën hanefite e më vonë u asociua me shkollën shafi'ite. Libri i tij El-Mudal-lisin është transmetuar të ketë kritikuar dijetarin e hadithit dhe recituesin e Kur'anit El-A'meshin (vd. 148 H/765). 20. Carl Brockelmann, Geschichte der arabischen Lietteratur (Leiden: Brill, 1943), G I, 173; Khuda Bakhsh H.L. Nr. 548, Nr. Katalogit: 308. Law. 21. Një listë me komentime gjendet në Katip Çelebi, Keshf edh-Dhunun, 2.1627. Komentimi i El-Xhesasit është botuar si Sherh Muhtesar Et-Tahawi fi 'l-fikh 'il-hanefi, ed. Ismet Allah Inajat Allah Muhammed et al. (Bejrut: Dar el-Beshair el-Islamije, 2010). Katip Çelebi transmeton që Tahaviu shkroi edhe version të gjatë edhe të përmbledhur (konciz) të kësaj vepre (Keshf edh-Dhunun, 2.1627); vepra e gjetur një vëllim është Muhtesari i përmbledhur. 22. Mosinteresimi i Tahaviut për të zgjidhur mospajtimet në opinione ose për të vendosur një hierarki autoritetesh në mesin e figurave të hershme hanefite mund të vihet në kontrast me zhanrin e mëvonshëm të Muhtesar të shek. 7h./13-të, të cilin Mohammed Fadel e përshkruan si vepër për të klasifikuar sistematikisht opinionet autoritative të shkollës. (The Social Logic of Taqlid and the Rise of the Mukhtaṣar," Islamic Law and Society 3, no. 2 (1996): 215-219). 23. El-Xhesas, Muhtesar Ihtilaf el-Ulema, ed. Abdallah Nadhir Ahmed (Bejrut: Dar el-Beshair el-Islamije, 1995). 24. The Function of Documents in Islamic Law, ed. Jeanette Wakin (Albany: State University of New York Press, 1972). 25. Al-Tahawi, Das Kitab adkar al-Huquq warruhūn aus dem al-Ganu al-Kabīr fi Surūṭ des Abū Jafar Ahmad ibn Muhamad aṭ-Ṭahawī, ed. Joseph Schacht (Heidelberg: C. Winter, 1927) and al-Ṭaḥāwī, Das Kitāb al-Suf'a aus dem al-Gami al-Kabir fi Surut des Abu Jafar Ahmad ibn Muhammad at-Ṭa āwī, ed. Joseph Schacht (Heidelberg: C. Winter, 1930). 26. Et-Tahavi, Esh-Shurut 'ul-Sagir, mudhejjelen bi ma uthire alejha min 'esh-shurut 'il-kebir, ed. Joseph Schacht (Hidelberg: C. Winter, 1930). 27. Tre të parët janë kapituj në Shurut 'us-Sagir, dy të fundit gjenden në Muhtesar. 28. El-Kevtheriu përmend Kitab el-Ashriba në El-Hawi, 38, dhe thotë që është një prej librave të Tahaviut që është sjellë në Magrib nga Ebu 'l-Kasim Hisham El-Ruejni. Mesa duket Kevtheriu ka rënë në përfundim që Er-Ruejni i ka sjellë veprat e Tahaviut në Afrikën Veriore duke u bazuar në statusin e Ruejnit si transmetues i të tre veprave të Tahaviut të paraqitura në Fihris të Ibn Hajr El-Ishbilit (vd. 575 h./1179-1180), një katalog i rëndësishëm i teksteve të shkruara ose transmetuara në Endelus deri në fund të shek. 6 h./12 (Fihrisat Ibn Hajr el-Ishbili, ed. Muhammed Fuad Mensur (Bejrut: Dar el-Kutub el-Ilmije, 1998), 168, 229). Mirëpo, Arnauti shënon që transmetuesi tjetër në zinxhirin (isnad) e Sherh Mushkil Athar, Muhammed ibn Jahja ibn Ahmed Et-Temimi El-Kurtubi (vd. 416 h./1025), udhëtoi në Egjipt, ku ai e takoi Ruejnin, kështu që mund të jetë që Ruejni nuk i ka transmetuar personalisht këto vepra në Afrikën Veriore (Shuajb Arnaut, Mukaddimet 'ut-Tahkik, Hyrje në Sherh Mushkil el-Athar (Bejrut: Mu'assesat el-Risale, 2010), 18). 29. Isa ibn Aban (vd. 189 h./804) ishte një proto-hanefi. Përveç Kitab el-Ashriba, veprat e përmendura në këtë paragraf të gjitha gjenden tek Ibn Ebi 'l-Wefa. 30. El-Kevtheri, El-Havi, 38. 31. Ismail Pasha, Hadijet 'ul-Arifin esma el-muel-lifin we athar el-musennifin (Bejrut: Dar Ihja el-Turath el-Arabi, 1951), 1.58.

Azmir Jusufi (PhDc)

Rrethanat kohore në interpretimin e Kuranit nga Sherif Ahmeti

"Burrë i mençur kush don' me kan', punës keqe hyzmet s'i ban, se vjen ni dit' e i bjen pishman." (Azem Galica)

Shoqëria shqiptare në shekullin e kaluar, me ideologjinë komuniste, mund të themi se i ngjante një ndërtese që e kishte goditur një tërmet i fortë, që pothuaj asgjë nuk kishte lënë në vendin e vet. Shumë nga vëllezërit e motrat tona kishin rënë aty ku nuk duhej.

Shekulli që shkoi, ishte përplot dhimbje e lot, sepse shumë nga vëllezërit tanë u detyruan të linin vendin për të ikur jashtë, nga barbaritë dhe mizoritë serbe.

Në këtë shoqëri të nëpërkëmbur u ngrit Myderriz Sherif Ahmeti si fryma që i jep gjallëri organizimit për të shpëtuar atë që është e mundur të shpëtohet, në kohën kur të gjitha forcat ishin vërsulur për ta fshirë nga mendja e shpirti ndjenjën e besimit.[1]

Komunizmi kishte vënë diktatin e vet mbi një pjesë të botës, fatkeqësisht edhe mbi vendin tonë. Ky diktat nuk mëshironte askënd, kështu që dhe dobësimi i ndjenjës fetare vazhdonte të shtrihej në përmasa të mëdha.

Më 1967 Enver Hoxha ndaloi me ligj predikimin e feve në Shqipëri, një vendim ky i paparë ndonjëherë në shoqërinë njerëzore, vendim i cili reflektoi në një masë të madhe edhe në Kosovë.[2]

Dhe pikërisht për të luftuar këtë çmenduri njerëzore në raport me besimin, u ngrit me një energji të paparë deri atëherë duke qëndruar stoikisht, Sherif Ahmeti, duke i bërë me dije besimtarët se çfarë ndodhte me popullin shqiptar.[3]

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe me konsolidimin e pushtetit monist komunist edhe Jugosllavia e re, filloi dëbimin e popullatës shqiptare për Turqi. Mulla Sherif Ahmeti e vërejti këtë dukuri, menjëherë pas vitit 1950, ndërsa pas vitit 1953 shpërnguljet shqiptare për Turqi u intensifikuan. Në kohën kur Myderriz Sherif Ahmeti, ishte mësues në fshatin Sllovijë, i bie në sy propagandimi i disa personave për shpërngulje të shqiptarëve në Turqi. Ai vërejti se nëpër oda bisedohej shumë për shpërngulje, bëheshin disa regjistrime, përpiloheshin lista e regjistra, e pastaj dërgoheshin në Shkup.

Në publik, regjimi komunist, u paraqiste sikur është kundër emigrimit të tillë të shqiptarëve në Turqi, megjithatë, ajo ishte vetëm në të folur, pasi që praktika ka treguar anën e kundërt, madje edhe ishin të abuzuar të gjithë ata që ishin kundër emigrimit në Turqi. Sherif Ahmeti me gjithë qenien e tij ishte kundër emigrimit të popullatës në Turqi, vazhdimisht duke u thënë popullit të tij që të jenë të durueshëm në këto vështirësi dhe të mos lënë atdheun e tyre.[4] Mulla Sherif Ahmeti e ndiente shpirtërisht këtë plagë kombëtare dyfish më rëndë, sepse edhe vetë ishte muhaxhir i dëbuar nga fshati Prekopucë i Toplicës, nga njëra anë, por edhe si intelektual me mision fetar e kombëtar, nga ana tjetër.[5]

Në këto rrethana të vështira, kishte fjalët e mëposhtme në mendje: *"Burr i mençur kush don' me kan', Punës keqe hyzmet s'i ban, Se vjen ni dit' e i bjen pishman"*[6] (AzemGalica)

Sherif Ahmeti rreth largimit të popullsisë shqiptare për në Turqi thotë:

> **"Familjet që shpërnguleshin nga Prishtina për në Turqi i takoja në Fushë Kosovë, duke e pritur trenin... e kur paraqitej treni fillonin përqafimet e atyre që i përcillnin dhe atyre që shkonin, ndaheshin prindërit nga evlatët dhe evlatët nga prindërit, vëllai etj. Dhe duke qëndruar bukur larg prej tyre kam qarë baraz me ta, duke u dëshpëruar thellë në shpirt, por duhet të qëndronim të fortë e me shpresë për një ditë më të mirë."**[7]

Kushdo që lexonte me vëmendje shkrimet e H. Sherif Ahmetit nëpër revista e libra, apo dëgjonte këshillat e tij, ballafaqohej me një mendimtar shumë të sinqertë

e pa kompleks, i cili tha të vërtetën për Islamin edhe në kohën kur ishte vështirë të thuhej. Kjo cilësi e të thënit të mendimeve deri në fund, dhe ballafaqimi me realitetin, janë dëshmia më e madhe e një edukate të lartë intelektuale që bazohej në parimin: *"E vërteta duhet të thuhet"*.[8]

Shkrimet e tij ishin mishërimi i tërë përkushtimit të tij jetësor. Të ngriturit me guxim në mbrojtje të parimeve islame në kohën kur në Kosovë me dhunë ishte instaluar sistemi komunisto-ateist, dëshmon për guximin, gatishmërinë për t'u ballafaquar me pasoja të ndryshme, dhe për kryerjen e një amaneti nga ana e Allahut dhe, në të njëjtën kohë, edhe për mosshitjen e shpirtit për të mirat e kësaj bote.[9]

Sherif Ahmeti në institucione islame kishte punuar, kur asetet e Bashkësisë Islame ishin të privuara nën presion komunist, në një kohë kur xhamia u shemb, medrese dhe shkolla fetare të mbyllura, dhe kur një numër i xhamive u shndërrua në depo dhe parkingje për kamionë zjarri. Në këto rrethana, H. Sherif Ahmeti ka dhënë kontributin më të madh në shkolla si mësues, si një predikues në xhami, në medrese dhe fakultet si profesor, dhe si Myftiu i Bashkësisë Islame në Prishtinë dhe sidomos në botimet islame si themeluesit të saj.[10]

Myftiu Naim Tërnava thotë: "Shpeshherë na thoshte: "Nxënës, mësoni, ngase ky sistem shumë shpejt do të bjerë e përgjegjësia do të bjerë mbi ju".[11]

Fjalët e tij për shumë njerëz sigurisht që shiheshin si ëndërr utopike dhe të parealizueshme, megjithatë, deshi Allahu xh.sh., ky sistem komunisto-ateist ra, kështu që ëndrra e Sherif Ahmetit dhe e



shumë myslimanëve tjerë është realizuar.

Fitim Flugaj thotë: "Haxhi Sherif Ahmeti vinte shumë i freskët dhe me vete sillte mendime e ide shumë të thella për lëndën e Akaidit, saqë na bënte shumë kureshtarë duke na treguar për ndjekjen me kujdes të bashkëkohanikut të tij nga Egjipti, dijetarit me famë në mbarë Botën Islame, Muhamed Muteveli Sharaviut nëpërmjet Radio Kajros në mëngjesin e hershëm, apo siç thoshte ai vetë: "He more djem, është një alim i madh në Egjipt, çka kam dëgjuar sot nga ai, po e lamë krejt se nuk jeni në gjendje me më kuptua as mu se le më atë, po nejse...", dhe vazhdonte pas insistimit tonë duke u përpjekur të na e thjeshtësonte deri në maksimum, derisa shumica e nxënësve arrinin ta kuptonin..."[12]

Sherif Ahmeti thotë: "Veshi që nuk dëgjon atë që është e dobishme dhe gjuha që nuk flet të vërtetën, fatkeqësisht janë të humbur dhe me defekte."[13]

Sherif Ahmeti në bibliotekën e tij personale kishte gazeta të shumta dhe revista islame në tri gjuhë që ai dinte: arabisht, boshnjakisht dhe turqisht. Revistat nga gjuha arabe i rezervonte nga ana e nxënësve të tij në medrese, të cilët ishin duke studiuar në Botën Arabe, ndërsa librat dhe revistat në gjuhën boshnjake i merrte nga Bashkësia Islame, të cilat vinin rregullisht: *Glasnik*, *Preporod*, *Takvim*, *Islamska misao*, etj. Është e njohur se ai kishte marrëdhënie të mira dhe miqësore me ulemanë boshnjake, të cilët e kanë vlerësuar dhe respektuar shumë, sidomos me alimin Husein ef. Xhozo.

Sherif Ahmeti kishte shprehi që nxënësve të tij t'u fliste për dijetarin e madh islam - *alim* të Ballkanit në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, të cilin e respektonte shumë, e bëhet fjalë për *alimin* tashmë të përmendur, Husein ef. Xhozo. Me këtë *alim* boshnjak Sherif Ahmeti kishte marrëdhënie shumë të ngushta, shumë herë ata janë takuar, kanë bashkëbiseduar dhe këmbyer mendime. Në atë kohë, literatura islame boshnjake ishte si një studim bazë i Islamit ndër myslimanët shqiptarë në Kosovë.[14]

1. Naim Tërnava, "Haxhi Sherif Ahmeti: Jeta dhe vepra (Kryereferat)", Haxhi Sherif ef. Ahmeti – Jeta dhe vepra (1920-1998), Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2010,f. 12. 2. Ibid., f. 12. 3. Ibid., f. 13. 4. Dr. Mehmet Halimi, "Shpalime kujtimesh për Myderriz Sherif Ahmetin", Haxhi Sherif ef. Ahmeti – Jeta dhe vepra (1920-1998), op. cit.,f. 84. 5. Ibid., f. 85. 6. Ibid., f. 85. 7. Behram Hoti, "Mulla Sherif Ahmeti – vizionar dhe edukues i breznive", Dituria Islame, nr. 113-114, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1999, f. 50. 8. NaimTërnava, "Haxhi Sherif Ahmeti: Jeta dhe vepra (Kryereferat)", op. cit.,f. 13. 9. Ibid., f. 13. 10. Ibid., f. 14. 11. Ibid., f. 14. 12. Fitim Flugaj, "Myderriz Sherif Ahmeti, figurë shumëdimensionale", Haxhi Sherif ef. Ahmeti – Jeta dhe vepra (1920-1998), op. cit.,f. 99. 13. Kur'an-i, përkthim me koment (përkthim me koment) përkth. dhe kom.: H. Sherif Ahmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Serbisë RS - Prishtinë, Prishtinë, f. 190. 14. Fitim Flugaj, "Myderriz Sherif Ahmeti, figurë shumëdimensionale", Haxhi Sherif ef. Ahmeti – Jeta dhe vepra (1920-1998), op. cit.,f. 100.

Vedat Shabani

Dituria dhe vlera e saj nën prizmin e ajeteve kuranore dhe haditheve profetike

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar!" (Alek: 1-3).

Për vlerën dhe rëndësinë e diturisë në fenë Islame flasin shumë ajete kuranore, prej tyre mund të përmendim ajetet në vazhdim: *"Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë"* (Ali-Imran: 18). Në këtë ajet kuranor vërejmë se Allahu xh.sh. fillimisht ka filluar me dëshminë e Tij, më pastaj ka vazhduar me dëshminë e engjëjve dhe në radhë të tretë ka përmendur dijetarët. Kjo mjafton për të treguar se çfarë respekti dhe vlere kanë njerëzit e dijes te Allahu xh.sh. Në një ajet tjetër Allahu xh.sh. thotë: *"Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri"* (El-Muxhadele: 11), në ajetin tjetër thotë: *"Thuaj a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë"* (Ez-Zumer: 9), pastaj thotë *"Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët"* (Fatir: 28), pastaj thotë *"e sikur t'ia linin atë (përhapjen e lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do të dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur)"* (En-Nisa: 83). Përmes këtij ajeti Allahu xh.sh. nxjerrjen e dispozitave e ka legjitimuar nga ana e dijetarëve dhe gradën e tyre e ka barazuar me gradën e pejgamberëve në çështjen e nxjerrjes së dispozitave.

Feja Islame nuk i ka kushtuar askujt më tepër rëndësi sesa ilmit (dijes) dhe alimit (dijetarit). Dija në Islam konsiderohet rruga e vetme e ngritjes, përparimit dhe vetëdijesimit të umetit. Ilmi (dija) është cilësi e veçantë. Ajo është cilësia më e vlefshme sepse rreth saj sillet çdo gjë. Ajo është vetë vlera. Ilmi është cilësi prej cilësive të Allahut xh.sh..

Për vlerën e ilmit dhe ulemasë tregon edhe ky varg i Kuranit: *"Dhe këto shembuj Ne i paraqesim për njerëzimin, por askush nuk do t'i kuptojë përveç ulemasë-të diturve"* (El-Ankebut: 43). Ky ajet ulemanë e veçon nga kategoritë e tjera të njerëzimit për nga aftësitë dhe kapacitetet e të kuptuarit, madje në këtë drejtim ata janë të veçuar tek Allahu dhe tek njerëzit në këtë botë[1].

Edhe Pejgamberi a.s. përmes fjalëve të tij i ka dhënë rëndësi të madhe dijes dhe shkencës. Ai në disa thënie të tij ka thënë: (*Atë që Allahu xh.sh ia do të mirën e bën njohës të çështjeve fetare*)[2], (*Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve*)[3], është e ditur se nuk ka gradë më të lartë dhe më me vlerë sesa grada e pejgamberisë, prandaj edhe të qenët trashëgimtar i asaj grade s'do mend se është një nder, respekt dhe privilegj i madh. Në një tjetër hadith Pejgamberi a.s. ka thënë: (*Nëse një ditë më kalon dhe unë nuk mësoj diçka të re, e cila më bën që të jem më afër Zotit, atëherë mos qoftë me bereqet ajo ditë për mua*)[4].

Pejgamberi a.s. i ka dhënë rëndësi më të madhe dijetarit dhe angazhimit të tij sesa çdo angazhimi tjetër, ai në një hadith ka thënë: (*Diferenca (vlera) e dijetarit ndaj personit i cili e adhuron Zotin në vazhdimësi, është sikurse diferenca ime me sahabiun më të ri nga mesi juaj*)[5], përmes këtij hadithi Pejgamberi a.s. e ka krahasuar pozitën e dijes me atë të pejgamberisë. Ndërsa në një hadith tjetër ka thënë: (*Diferenca (vlera) e dijetarit ndaj personit i cili adhuron Zotin në vazhdimësi, është sikurse diferenca e hënës së plotë ndaj planetëve të tjerë*)[6]. Lidhur me vlerën e dijetarit Pejgamberi a.s. ka thënë edhe këtë: (*Vërtet për alimin luten çka ka në qiej (prej krijesave) dhe çka ka në tokë, edhe peshqit (balenat) në thellësi të oqeanit*).[7] Prej porosive të Llukman Hakimit ndaj birit të tij ishte edhe kjo (*O biri im! Ulu me dijetarët dhe rri afër tyre sepse Allahu xh.sh. i ngjall zemrat përmes dijes ashtu siç e ngjall tokën përmes shiut nga qielli*).

Vlera e mësimit

Feja Islame i ka dhënë rëndësi shumë të madhe dijes, mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shumë ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s. flasin për rëndësinë e të mësuarit dhe vlerën e mësuesit dhe nxënësit/studentit. Allahu xh.sh. në njërin prej ajeteve kuranore thotë: *"E përse nga çdo grumbull i tyre të mos*



shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehen te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë" (Et-Tevbe: 122), *"Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini"* (En-Nahl: 43), e ajete të tjera të shumta kuranore.

Ndërsa hadithe të Pejgamberit a.s. të cilat flasin për vlerën e mësimnxënies janë edhe këto: (*Atij personi i cili ndjek rrugën e dijes, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhenet*)[8], (*Të shkosh me qëllim të mësimit të një ajeti të Kuranit është më e vlefshme sesa falja e njëqind reqateve namaz, gjithashtu të shkosh me qëllim të mësimit të një fushe të dijes është më e vlefshme sesa falja e një mijë reqateve namaz*)[9], (*Kërkimi i diturisë është obligim primar për çdo mysliman*)[10].

Njëri nga shokët e Pejgamberit a.s., Ebu Derda, ka thënë: (Që të mësoj një çështje të dijes është më e rëndësishme për mua sesa të fal namaz tërë natën). Imam Shafiu ka thënë: (Kërkimi i diturisë është më i rëndësishëm sesa namazet vullnetare). Ndërsa një dijetar, Fet'h El-Mevsiliu, ka thënë: (Nëse të sëmurit i ndalet ushqimi, pija dhe barërat a do të vdesë ai? Të pranishmit i thanë: gjithsesi, ai tha: ashtu është edhe zemra, nëse i ndalohet urtësia dhe dituria për tri ditë, vdes). Abdullah ibn Mesudi ka thënë: (Përkushtojuni diturisë dhe kini kujdes përderisa nuk është hequr, heqja e diturisë bëhet me vdekjen e dijetarëve, asnjëri nuk ka lindur i ditur, por dituria përfitohet përmes mësimit).

Vlera e të mësuarit

Ajetet të cilat flasin për vlerën e të mësuarit janë të shumta, prej tyre janë edhe këto: *"dhe kur të kthehen tek ata të këshillojë popullin e vet që t'i druajnë Perëndisë"* (Et-Tevbe: 122) domethënia e këtij ajeti është që t'i mësojnë e t'i udhëzojnë në rrugën e drejtë. Ajeti tjetër kuranor thotë: *"Kujtoje (o Muhamed) kohën kur Perëndia mori premtimin nga ata, që u është dhënë libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe me siguri nuk do të fshehin asgjë nga ai"* (Ali Imran: 187) ky ajet e bënë të obligueshëm mësimin e të tjerëve. Ajeti tjetër kuranor thotë: *"por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë"* (El-Bekare: 147) përmes këtij ajeti Allahu xh.sh. e bën të ndaluar-haram fshehjen e diturisë. Ajeti tjetër kuranor thotë: *"Thirri në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur. Dhe diskuto me ta si është më bukur!"* (En-Nahl: 125).

Ndërsa hadithet e Pejgamberit a.s. të cilat flasin për vlerën e të mësuarit të tjetrit janë të shumta gjithashtu, prej tyre: kur Pejgamberi a.s. e dërgoi Muadhin në Jemen ai e porositi duke i thënë: (*Të bëhesh ti shkaktar në udhëzimin e një personi është më mirë për ty sesa e gjithë kjo botë*)[11]. Në një thënie tjetër Pejgamberi a.s. ka thënë: (*Atë person i cili e mëson një shkencë dhe e fsheh atë, Zoti Ditën e Kiametit do ta prangosë me pranga prej zjarrit*)[12]. Thënia tjetër e Pejgamberit a.s. thotë: (*Me të vërtetë, Zoti xh.sh., pastaj melaqet e Tij, banorët e tokës dhe qiellit, po edhe milingona dhe peshku i detit luten për mësuesin e njerëzimit*)[13]. Në një thënie tjetër Pejgamberi a.s. ka thënë: (*Kur të vdesë i biri i Ademit pushon vlerësimi i veprave të tij, përveç tri veprave: lëmoshës, dijes dhe fëmijës së mirë*)[14].

Është pyetur Abdullah ibn Mubareku se cilët janë njerëzit më të mirë. Ai ishte përgjigjur duke thënë: Ulemaja. E prej udhëheqësve kush janë? Asketët (ata që nuk jepen shumë pas dynjasë) u përgjigj. E prej njerëzve të rëndomtë? Ata që dynjanë e japin për fe, – u përgjigj ai.

Imam Gazaliu duke komentuar thënien e Abdullah ibn Mubarekut ka thënë: (Prej njerëzve zgjodhi dijetarët, ngase njerëzit mbeten njerëz dhe janë të veçuar prej krijesave të tjera vetëm me dituri e jo për nga format, se deveja është më e fortë se njeriu, e as për nga madhësia, sepse elefanti është më i madh se njeriu, e as për nga trimëria, sepse ka egërsira që janë më trime se njeriu, e as për nga ngrënia, sepse ka kafshë që e mbushin barkun e tyre shumë më tepër se njeriu. Pra, njeriu vetëm për Ilm-dije është veçuat dhe krijuar në këtë formë të bukur)[15].

1. Musa Vila, "Nën hijen e hadithëve të Resulullahut", Prishtinë 2017, fq: 17. 2. Transmeton Imam Buhariu, Libri i dijes, nr. i hadithit: 71. 3. Transmeton Imam Ebu Davudi, Libri i dijes, nr; hadithit: 3641, gjithashtu e transmeton edhe Imam Tirmidhiu me nr; 2682. 4. Transmeton Imam Taberaniu në El-Evsat dhe Ebu Nuajmi në El-Hilje. 5. Transmeton Imam Tirmidhiu, nr; hadithit: 2686. 6. Transmeton Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr; hadithit: 3641-3642. 7. Transmeton Ebu Davusi në Sunenin e tij, nr; 3641. 8. Transmeton Ebu Davudi, Libri i diturisë, nr; hadithit: 3641. 9. Transmeton Ibn Maxhe, Kapitulli mbi vlerën e të mësuarit të Kuranit, nr; hadithit: 219. 10. Transmeton Ibn Maxhe, Kapitulli mbi vlerën e dijetarëve dhe mësimnxënien, nr; hadithit: 224. 11. Transmeton Imamm Buhariu dhe Muslimi. 12. Transmeton Imam Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. 13. Transmeton Imam Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe. 14. Transmeton Imam Muslimi dhe Tirmidhiu. 15. Musa Vila, "Nën hijen e hadithëve të Resulullahut", fq; 19.

Nashit Ferati

Paqja në praktikën e Muhamedit a.s. (2)

Me Sahifen Pejgamberi a.s dëshiroi të rregullonte sistemin e jetës në shoqëri e i cili do të jetë bosht i bashkimit të banorëve të Medinës, kushtetuta e parë e qytetërimit të Medinës.

Kjo kushtetutë është bërë ndërmjet ensarëve (banorëve myslimanë të Medinës) dhe muhaxhirëve (atyre që emigruan në Medinë), e më pastaj nenet e kësaj kushtetute u zgjeruan edhe ndër fiset çifute dhe te disa të tjerë që banonin në Medinë, sipas saj u janë siguruar pasuria, nderi, feja dhe u janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet. Tani le t'i përmendim fjalët e Profetit Muhamed a.s dhe të shohim se cilës fushë i përkiste fjalimi i tij, " O ju njerëz, përhapni paqen" i ndalni luftërat me njëri – tjetrin.[1]

Me ndërmarrjen e hapave që përmendëm më sipër, shoqëria filloi të merrte veten dhe filluan shenjat e solidaritetit mes shoqërisë, të qenit pozitiv në shoqëri dhe dashurisë për njëri tjetrin. Ai e ndërroi mënyrën e të menduarit të tyre, shprehitë dhe moralin e tyre, i arsimoi barbarët në njerëz të civilizuar, i arsimoi mizorët në njerëz të drejtë dhe të përulur në Zotin, natyra e tyre jo e nënshtruar dhe krenare u kthye në nënshtrim dhe përulje ndaj ligjit dhe rendit.[2]

Nëse konflikti mes së drejtës dhe së shtrembrës në Mekë përfundoi me daljen e së drejtës nga Meka, beteja akoma nuk kishte përfunduar, pas këtyre që ndodhin në Medinë, do të fillojë një etapë e re për myslimanët, ajo e konfrontimit fizik me kurejshët.

Xhihadi domethënë përpjekje në rrugë të Allahut brenda mundësive pa kohë dhe vend të caktuar, Xhihadi nuk ka asgjë të përbashkët me veprimet kriminele terroriste, me minimin e vendeve publike e me mbytjet e njerëzve të pafajshëm.

Pejgamberi a.s është detyruar t'i mbrojë besimtarët në fenë e Allahut xh.sh. nga idhujtarët shumë më të mëdhenj në numër, për këtë qëllim të lartë vetë Muhamedi a.s. ka marrë pjesë në 27 luftëra.
Nën urdhrin e Allahut ai kërkonte marrëveshje paqësore, vetëm në rastet kur nuk arriheshin marrëveshjet fillohej lufta gjithmonë me porosi: të mos vritet robi i luftës dhe askush që nuk gjendet në fushëbetejë.

Zbriti verseti kuranor me të cilin Muhamedit a.s iu dha leja për t'u mbrojtur : " *U lejohet (lufta) atyre që janë sulmuar, ngase u është bërë padrejtësi dhe Allahu me të vërtetë, është i Fuqishëm që t'i ndihmojë*".[3] Ky kuptim i lartë human e bëri të lejuar luftën mbrojtëse duke e kushtëzuar në sa më pak viktima. Qëllimi i luftës në Islam nuk është vrasja e fëmijëve, grave e pleqve, mbytja e begative, djegia e bereqeteve etj. Xhihadi domethënë përpjekje në rrugë të Allahut brenda mundësive pa kohë dhe vend të caktuar, Xhihadi nuk ka asgjë të përbashkët me veprimet kriminele terroriste, me minimin e vendeve publike e me mbytjet e njerëzve të pafajshëm.

Këtu shihet qartë qëllimi i lartë i Islamit në vlerësimin e njeriut, për humanizmin e lartë dhe prioritetin edukativ që Islami i ka dhënë shoqërisë njerëzore. Njohja e jetës së Muhamedit a.s dhe veprimeve të tij që i bëri gjatë 63 vjetëve, e veçanërisht gjatë 23 viteve të pejgamberisë, janë të domosdoshme për arritjen e njësimit të myslimanëve dhe garantimin e paqes botërore.

Një segment i rëndësishëm i jetës së Muhamedit a.s. dëshmon se ka qenë vazhdimisht në favor të paqes dhe respektit ndërnjerëzor, dhe kjo e ka përshkuar tërë jetën e tij dhe veprimet e veçanta që i ka bërë gjatë gjithë jetës së tij. Një ndër këto veprime është edhe marrëveshja-Traktati i Hudejbijes.[4]

Në këtë traktat përfaqësues i Mekës ishte Suhejl B. Amri. Prandaj kjo marrëveshje në çdo përkthim në gjuhën shqip duhet të quhet Traktati i Paqes i Hudejbijes. Përfundi-

misht në lidhje me këtë mund të themi se marrëveshja e Hudejbijes është "Traktat ndërkombëtar" i lidhur mes dy shteteve, njëri ndër këto dy shtete-Medina përfaqësohej nga Muhamedi a.s. dhe tjetri që ishte Meka përfaqësohej nga i autorizuari i mekasëve, Suhejl b. Amri, me qëllim të arritjes së paqes mes këtyre dy vendeve në afat prej 10 vjetësh.[5]

Pas një diskutimi të gjatë mes Muhamedit s.a.v.s dhe Suhejl b. Amrit arritën deri te marrëveshja për nënshkrimin e një traktati të paqes. Pejgamberi s.a.v.s e urdhëroi Aliun r.a të shkruante atë që i diktonte. Pejgamberi s.a.v.s tha: "Bismil-lahir-rrahmanir-rrahim", kurse Suhejli ndërhyri e tha: kush është ky Err-rrahman, ne nuk e njohim këtë Zot, prandaj shkruaje Bismik-Allahumme. Pejgamberi s.a.v.s e pranoi këtë kusht dhe atëherë urdhëroi Aliun r.a të vepronte ashtu.[6]

Vazhdoi Pejgamberi s.a.v.s: "Ky është traktat mes Muhamedit, të Dërguarit të Allahut dhe Suhejl B. Amrit...", kurse Suhejli ndërhyri prapë dhe tha: "Ndalu, sikur të kishim pranuar për të dërguar të Allahut ne nuk do ta ndalonim hyrjen tuaj në Qabe dhe as që do të luftonim kundër teje, por shkruaj kështu: Ky është Traktat mes Muhamedit, të birit të Abdullahut dhe....", Pejgamberi s.a.v.s tha: "Megjithatë unë jam pejgamber e i Dërguar i Allahut edhe pse ju nuk më besoni". Pejgamberi s.a.v.s urdhëroi Aliun r.a. që të veprojë ashtu siç kërkoi Suhejli. Sigurisht që ata që luftuan me Pejgamberin s.a.v.s. e të cilët e donin dhe e besonin si të Dërguar të Allahut nuk dëshironin të vepronin asgjë që do ta cenonte nderin dhe imazhin e Muhamedit s.a.v.s. I këtillë ishte edhe Aliu r.a i cili hezitonte dhe nuk mundi ta fshinte fjalën "i Dërguar i Allahut". Kur e pa Pejgamberi a.s. vendosmërinë e tij, atëherë e fshiu vetë.

Ky Traktat në formën e tij përfundimtare do të dukej kështu: Në emrin Tënd o Allah. Ky Traktat i paqes (es-sulhu) është marrëveshje mes Muhamedit, të birit të Abdullahut dhe Suhejl b. Amrit (të cilët pajtohen):

Neni 1

Muhamedi të kthehet në Medinë dhe në këtë vit mos të hyjë në Mekë, ndërsa në vitin e ardhshëm ta vizitojë Qabenë në afat prej tri ditësh duke mos pasur me vete armë, përveç shpatave në këllëf. Gjatë kësaj kohe kurejshitët nuk guxojnë t'u bëjnë kurrfarë pengesash.

Neni 2

Ndërprerja e armiqësive mes tyre në afat prej 10 vjetëve. Gjatë kësaj periudhe sa zgjat ky armëpushim njerëzit do të qarkullojnë lirisht dhe do të mbrojnë njëri-tjetrin.

Neni 3

Kush dëshiron t'i bashkohet Muhamedit, këtë mund ta bëjë me kusht që ta respektojë këtë traktat, e kush dëshiron t'u bashkëngjitet kurejshitëve le të veprojë ashtu. Çdo fis i tillë konsiderohet pjesë e atij populli. Çdo armiqësi ndaj aleatëve do të konsiderohet si armiqësi ndaj palës që i takon.

Neni 4

Ata që ikin te Muhamedi nga fisi kurejsh pa lejen e zotërisë së tij, ata do t'i kthejnë në Mekë. Kurse ata që vijnë nga myslimanët te kurejshët përkatësisht nëse dikush prej tyre ikën te këta, të mos u kthehen myslimanëve.[7]

Gjatë kësaj kohë Pejgamberit a.s, ai u dërgoi letra për thirrje në Islam qeveritarëve të shumtë, mbretërve të shteteve si dhe guvernatorëve të qyteteve.

1. Amër Halid, Gjurmëve të të Dashurit Tonë, Shkup 2006, f. 226. 2. Mewdudi, Të Kuptuarit e Drejtë të Islamit, f. 49, Shkup 1994. 3. Kurani , 22 : 39. 4.http://www.alb-drejtesia.com. 5. Amër Halid, Gjurmëve të të Dashurit tonë, Shkup 2006, f. 340 . 6..http://www.alb-drejtesia.com. 7.. http://www.alb-drejtesia.com

Rexhep Suma (PHDc)

Universalizmi i thirrjes islame

Duke lexuar dhe medituar Kuranin, ajete të shumta na orientojnë drejt asaj që për çdo problem dhe sfidë që ballafaqohet njeriu në këtë botë, ka ofruar edhe zgjidhje, qofshin ato të thjeshta apo edhe të komplikuara.

Kurani nuk lë hapësirë për hamendje dhe drejton saktë dhe drejt njeriun, sepse është i vërtetë dhe është prej Zotit, duke i bërë ftesë njeriut që ta njoh Zotin dhe t'i përulet e nënshtrohet vetëm Atij. Në këtë vazhdë edhe adhurimin që bënë duhet ta bëjnë në emër të Tij. Për këtë Zoti xh.sh në Kuran thotë: *"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë." (El Bejjine,5).*

Nga ky ajet kuranor vërtetohet se thirrja islame është për tërë botën, meshkuj dhe femra, deri në fund të kësaj bote. Kjo metodë e thirrjes gjen aplikim te mendjet e ndryshme, nisur nga hyrjet të cilat iu intereson të gjithëve, ku secili në të gjen përgjigjen e dëshiruar dhe shëruese, qoftë ai që dëshiron ta ndriçoj rrugën e tij apo edhe ai që dyshon në të, islami ia qartëson dhe heq çdo dyshim.

Në lidhje me këtë, dijetari Muhamed Izet Druzu në tefsirin e tij thotë se Kurani ofron zgjidhje për problemet më të komplikuara, si pasojë e së cilave njerëzit janë ndarë dhe përçarë e janë bërë kundërshtarë të njëri-tjetrit. Kurani largon njeriun nga mendimet radikale, duke udhëzuar ata që janë të iluzionuar dhe të hezituar për t'i deziluzionuar me anë të metodës së ligjërimit që iu drejtohet mendjeve dhe zemrave së bashku. Në të është fuqia dhe ndikimi, bindje për secilin që nuk iu ka ndyrë ndërgjegjja që të marrë për zot egon e tij dhe të mbajë inat dhe mendjemadhësi karshi fakteve dhe të vërtetave. Kurani po ashtu ofron organizim proporcional mes shtresave të ndryshme të njerëzve sidomos mes atyre që i janë përgjigjur thirrjes islame, myslimanëve dhe të tjerëve mbi bazën e paqes dhe lirisë, drejtësisë dhe të vërtetës, duke iu përmbajtur apo ruajtur kufijtë e secilit, mos ushtrim të dhunës, mos pengim, mbyllje e kurth. Së këtejmi obligohemi me shtrimin e thirrjes për në islam, rrugën e Zotit me urtësi e këshillë të mirë, duke polemizuar me të tjerët me kulturë përveç atyre që ushtrojnë agresion dhe ata që penguan nga rruga (imani) e Allahut dhe që kërkuan shtrembërimin e saj, derisa të mos mbetet idhujtari (besim i kotë), e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun.

> **Ajo që Kurani vazhdimisht e potencon është fakti se thirrja në Islam duhet të jetë në formën bindëse, duke ofruar argumente që bindin mendjen duke i lënë hapësirë për mendim dhe dëshirë.**

Ajo që Kurani vazhdimisht e potencon është fakti se thirrja në Islam duhet të jetë në formën bindëse, duke ofruar argumente që bindin mendjen duke i lënë hapësirë për mendim dhe dëshirë. Për mos imponim, janë një sërë argumentesh fetare të cilat ndalojnë imponimin dhe dhunën në pranimin e fesë.

Thotë i Lartësuari: "*Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson tagutët, e i beson Allahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. Allahu është dëgjues i dijshëm."(El Bekare, 256).*

Po ashtu sikurse daveti nuk është obligativ për çdo kënd që e dëgjon që t'i përgjigjet. Sepse udhëzimi është dhuratë nga Allahu xh.sh., ia dhuron atij që do prej robërve të Tij, ashtu siç e shpjegon edhe ajeti kuranor në vazhdim: *Thuaj: "O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni!As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)! (El Kafirunë,1-6).*

Zbutja e zemrave për t'iu përgjigjur thirrjes

Pra, mësimet islame përmban dhe drejton frymën që të zbusë zemrat për t'iu përgjigjur thirrjes në islam, të ofrojë dhe bashkoj shpirtrat në dobi të ndërsjellë, dhe hap mundësitë për zemrat që dëshirojnë të njohin fuqinë e Allahut xh.sh. Rëndësi të veçantë ka edhe forma dhe mënyra se si e prezantojmë dhe paraqesim Islamin te të tjerët. Kjo është një art në vete që jo gjithkush mund ta bëjë në formën më të mirë, duke mundësuar që të hapet gjoksi i atij që dëshiron të hyj në Islam si dhe atij që shpreh interesim të bëjë hulumtim dhe kërkim për historinë dhe kulturën islame.

"*Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit." (En-Nahl,125).*

Është interesant të shikohet edhe mendimi i orientalistëve si Thomas Arnold, i cili në librin e tij "Thirrja në Islam" shprehet se që nga shfaqja Islami është fe e thirrjes qoftë nga aspekti teorik apo praktik. Edhe vetë jeta e Muhamedit a.s., përfaqësonte këtë frymë dhe mësime, dhe se Muhamedi a.s., në fazat e para të thirrjes, gjatë tërë shpalljes mekase dhe disa vite të periudhës medinase, nuk pati menduar për të qenët e thirrjes mbarëbotërore, por thjesht mendonte si të drejtonte vetëm arabët, pra për Meken dhe zonat përreth në gadishullin e arabëve e pa përfshirë popujt tjetër, të cilët hynë në rrethin e thirrjes vetëm pasi u siguruа pushteti dhe qëndrueshmëria në Medine e Kurejshitët pranuan marrëveshjen e Hudejbijes.[1]

Një shkencëtar i Gjeologjisë që punonte në Universitetin e Oksfordit, gjatë studimit të tij në laborator kishte marrë mostra nga shkëmbinj me ngjyra të ndryshme, por nga i njëjti vend. Ishte habitur me këtë fakt dhe me këtë ngjyrim, andaj vazhdoi hulumtimin e tij disa ditë me radhë duke eksperimentuar me shpresën se do të arrij ta zbërthej sekretin e ngjyrave të shumta të tij. Aty kishte një asistent i përkatësisë myslimane nga India, i cili kishte vërejtur habinë e profesorit, filloi t'i lexojë disa herë ajetet 27 dhe 28 të sures Fatir.

"A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilave është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës."(-Fatir, 27-28).

I gjendur i mahnitur nga dëgjimi i këtyre dy ajeteve, profesori kërkon që t'i përkthehej dhe pas dëgjimit të tyre disa herësh, u shpreh: "E gjeta, zgjidhja është në urtësinë e Zotit, e cila shfaqet para nesh në botanikë e tek njeriu edhe tek shtazët tjera me shumëllojshmëri të ngjyrave."

Përmbajtja e këtyre dy ajeteve që përshkruan shkëmbinjtë me shumëllojllojshmëri ishin shkaku kryesor që ky shkencëtar të kaloj në Islam.

Kurse rasti tjetër është më specifik, i cili ka protagonist një lundrues si dhe asistenti i tij i cili ishte nga Gjiri Persik. Një ditë ata ishin duke lundruar në det dhe papritmas u përkeqësua moti dhe filloi një shtrëngatë dhe valët e detit filluan të godasin anijen pa mëshirë. Piloti u lodh për së tepërmi duke mbajtur timonin e anijes dhe kërkoi nga asistenti i tij që ta ndihmojë dhe ta drejtoj anijen në mënyrë që t'i shpëtojnë katastrofës që ishin në prag të saj. Asistenti arab filloi që t'i lexojë këto ajete kuranore: "*Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.*" (En-Nurë,40).

Dhe vazhdoi që t'i lexonte këto ajete dhe lutje tjera deri sa u qetësua deti, pushoi era dhe shiu,

atëherë piloti çuditërisht e pyeti se çfarë po thoshte, kurse ai iu përgjigj që lexonte ajetin nga Kurani famëlartë. Më pas edhe ia përktheu kuptimin e ajetit. – "A ishte Muhamedi, pilot anije dhe a ka lundruar në det?[2] -pyeti ai.

-"Sigurisht që jo"-iu përgjigje asistent i tij.

Atëherë ai tha se ajo çfarë na është thënë neve se Muhamedi ishte përpilues i Kuranit është i pavërtetë dhe është jashtë forcës së njeriut. Unë pjesën më të madhe të jetës e kaloj në lundrim, por sikur kjo natë nuk më ka ndodhur asnjëherë. Ishte një natë e çuditshme dhe kjo më shtynë që të lexoj dhe njoh edhe më shumë Kuranin të cilin as specialistët nuk mund ta njohin në fushat e tyre. Më pas kaloi në Islam nga bindja dhe dituria.

Bindja nga argumentet shkencore

Një nga arsyet kryesore që në perëndim shumë njerëz përqafojnë Islamin është ngase ata binden nga argumentet shkencore që burojnë nga metodologjia e Kuranit në mësimin e njerëzve si dhe depërtimi i thellë i tij në zemrat e njerëzve me argumente të qarta dhe bindëse.

> "Ne dimë shumë mirë se ata thonë: "Atë (Muhamedin) është kah e mëson një njeri!" Mirëpo, gjuha e atij nga i cili anojnë (supozojnë) ata është jo arabe (e paqartë), e kjo (e Kuranit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë."
> (En-Nahl,103)

Thotë i lartësuari në Kuran: "*Ne nuk e krijuam qiellin e as tokën dhe çka ka në mes tyre, pa qëllim (shkel e shko), ai është mendim i atyre që nuk besuan, pra dënimi me zjarr është mjerim për ata që nuk besuan. A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë vepra të mira me ata që bënë shkatërrime në tokë, apo do t'i konsiderojnë njësoj si të ruajturit prej të këqijave, si ata që janë mëkatarë?(Ky është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend." (Sad,27-29).*

Pra, baza e metodologjisë së thirrjes në Islam dhe universaliteti për çdo ndjeshmëri që i sillet në kokë njeriut. Në të ka udhëzim dhe dritë, përsosmëri dhe qetësi.

"Është e vërtet se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh." (El Isra,9).

Nga mirësia e tij janë të mbuluar dy botët (njerëzore dhe e xhinëve). Na ka paralajmëruar që të ruhemi nga të këqijat. Qoftë nga çështjet e kësaj bote, apo ajo që është gëzim në botën tjetër, qoftë me fjalë të qarta apo me ofrimin e shembujve të cilët na thërrasin në mendim dhe meditim në këtë kozmos që të arrihet urtësia e Allahut xh.sh.

"Këta janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve. Allahu krijoi qiejt dhe tokën me një seriozitet të caktuar. Në to më të vërtetë ka fakte për besimtarët." (El Ankebutë, 43-44).

Apo ajeti tjetër ku Allahu thotë: "*E në tokë, copa sipërfaqesh, te ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojllojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha*

ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërën prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon për argumente për njerëzit e mençur." (Er-Rad,4).

Gjuha arabe si gjuhë në të cilën është zbritur Kurani mbetet gjuha me elokuente e njerëzimit. Kuptimet e saj, nuk përmbajnë semantika kundërthënëse. Këtë gjuhë, Allahu e veçoi me shumë karakteristika: është gjuhë e banorëve të xhenetit, në të është zbritur Kurani, kuptimi dhe semantika e tij depërton thellë në shpirtin e njeriut dhe për shkak të kësaj shumë njerëz kanë kaluar në Islam.

Shembull më konkret kemi mjekun francez Maurice Bucaille, i cili është autor i librit "Bibla, Kurani dhe Shkenca" i cili para se të bëhej mysliman shfrytëzoi postin dhe autoritetin e tij si misionar i krishterë pasi që çdo pacienti që kërkonte ilaç tek ai, ai shfrytëzonte gjendjen e rëndë shëndetësore të tyre e edhe injorancën dhe ofronte disa argumente dhe dyshime që ngriheshin kundër Islamit, duke u munduar që atyre të ua konfirmonte se Kurani nuk është fjalë e Zotit. Ai më vonë pranoi Islamin me mirësinë e Zotit dhe pastaj me urtësinë dhe vizionin e mbretit Fejsal, i cili zhvilloi një bisedë të gjatë me tëdhe arriti që të mbjell dyshim në atë që thotë. Në një rast mbreti Fejsal iu drejtua atij, A e ke lexuar Kuranin në gjuhën arabe? Ku Zoti thotë: *"Ne e zbritëm atë Kuran arabisht, ashtu që ta kuptoni." (Jusuf,2),* si dhe ajeti tjetër kuranor:

"*Ne dimë shumë mirë se ata thonë: "Atë (Muhamedin) është kah e mëson një njeri!" Mirëpo, gjuha e atij nga i cili anojnë (supozojnë) ata është jo arabe (e paqartë), e kjo (e Kuranit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë.*" (En-Nahl,103)

Ai u përgjigj se i ka lexuar vetëm në gjuhët evropiane. Mbreti Fejsal iu drejtua: "Nuk e paske lexuar dhe nuk e ke kuptuar, andaj lexoje në gjuhën në të cilën është zbritur e pastaj mund të zhvillojmë debat sepse ti nuk e ke lexuar Fjalën e Zotit por ke lexuar fjalën e përkthyesit."

Maurice Bucaille, pas këtyre fjalëve, për çdo ditë një orë ia kushtoi gjuhës arabe për dy vite të plota dhe ndryshoi tërësisht mendimin e tij mbi Kuranin dhe Islamin dhe si rezultat shkroi librin që e cekëm më lartë që është një ndihmesë e madhe për të kuptuar drejt islamin dhe interpretuar nga aspekti shkencor, duke përfunduar se Kurani është libër i Zotit dhe i vetmi në të cilin shkencëtari dhe i dituri bashkëkohor të deduktoj se ai është libër i fundit dhe i vërtetë i zbritur nga Zoti, në të cilin nuk asnjë shkronjë tepër dhe as mangu.

"Për këtë arsye Kurani nuk është libër qëllimi, i të cilit do të ishte paraqitja e disa ligjeve që rregullojnë Gjithësinë, ai ka qëllim në thelb religjioz. Kryesisht me rastin e përshkrimit të gjithëfuqisë hyjnore, njerëzve u janë drejtuar thirrje që të mendojnë mbi veprat e krijimit"[2].

Mesazhi i Kuranit është njëherësh dituror e praktik, ligjor e moral, i preokupuar me problemet e përditshme si dhe jetën e përshpirtshme e intelektuale. Teksti sakral merret me çdo aspekt të lidhur me njeriun, nga pyetjet intelektuale më të thella dhe çështjen shpirtërore më të lartësuara deri te punët mondane të jetës së zakonshme. Ai është njëherësh terapeutik e didaktik, mesazh sihariqesh (*bishareh*), e paralajmërim (nadhr).[3]

Konfirmimi i monoteizmit

Pra, çdo ajet kuranor në vetvete përmban thirrje në Islam, urtësi dhe këshillë. Metodologjia e thirrjes islame në çdo ajet ndërtohet mbi bazën e konfirmimit monoteizmit, sinqeritetin në punë dhe besimin se Kurani është i vërtetë i shpallur prej Zoti. Shiko se çfarë thotë i Lartësuari në Kuran: *"Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. Allahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij." (Esh-Shura,13).*

Kurani, siç thotë Aliu r.a., në të ka lajme nga popujt para jush, lajme për gjeneratat pas jush. Ai është mrekulli e përjetshme deri në kiamet.

Kështu na mëson Kurani në lidhje me dialogun dhe debatin që duhet zhvilluar me ata që dëshirojnë të arrijnë tek e vërteta dhe që nuk e përzien të vërtetën me të shtrembëtën ashtu siç ishte rasti me delegacionin e Nexhranit, të cilët treguan kryeneçësi dhe thirrja për mallkim ishte fjala ndarëse, ashtu siç e përshkruan edhe Zoti në këtë ajet.

"E kush të kundërshton ty në çështjen e tij (Isait) pasi të është bërë e ditur e vërteta, ti thuaj: "Ejani i thërrasim bijtë e tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vet ju, mandej sinqerisht të lutemi për mallkim, dhe mallkimi nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve." (Ali Imran,61).

Komentuesi i njohur i Kuranit thekson se shkaku u zbritjes së këtij mallkimi dhe para saj nga fillimi i sures e deri në këtë ajet është delegacioni nga Nexhrani, të cilët ishin të krishterë dhe filluan ta kundërshtojnë çështjen e krijimit të Isës a.s., sipas mësimeve kuranore, duke qenë kokëfortë në qëndrimet e tyre.[4]

1. Thomas Arnold, The preaching of Islam a history of the propagation of the muslim faith,2-nd edition, London Constable & Company ltd. 1913.p.28-30. 2. Maurice Bucaillem, Bibla, Kurani dhe Shkenca, Komiteti i Bashkuar Saudit, Prishtinë, pa vit botimi, përkthyer nga Nazim Juniku,f.140. 3. Sejjid Husein Nasr, Hyrje e përgjithshme në përkthimin dhe komentimin e Kuranit, Logos-a, Shkup,2018,f.24. 4. Imam Hafidh ebil Fida Ismail ibn Kethir el Kureshi Ed-dimeshki, Tefsirul Kur'anil adhim, Darul marife, Bejrut, v.2,1993.f.376

Muhamet Fazliu

NUK ËSHTË LEHTË TË SHKRUAJ PËR TY, O DRITË E ALLAHUT MËSHIRËPLOTË

**Përsiatje eseistike për profetin arketip të Ummetit islam, Muhamedin a.s.

Të shkruhet për ty ia vlen çdoherë e në çdo kohë të shkruhet, por nga kush se? Nga unë që jam një rob i dobët i Allahut, një mysliman modest i fesë së Tij të pastër e një ndjekës modest i jetës dhe praktikës profetike - synetit të të Dërguarit të Tij më të dashur, Muhamedit a.s. (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin me të!)!

Nga ai i cili nuk është në pozitën të ultë apo nga ai i cili mund të shkruajë për ty por, në të vërtetë, është larg teje. Nga ai i cili është gjynahqar! Nga ai i cili është i pambrojtur prej gabimeve e të marrë guximin që të shkruajë për dikë që është i pastër si loti, i pagabueshëm. Të shkruhet për ty nga një i dobët i pakompletuar për një të fortë të kompletuar. Të shkruhet për ty nga një i mangët për një që është më i zgjuari, më i lavdëruari e më i përzgjedhuri nga krijesat e Zotit fuqiplotë. Të shkruhet për ty, që fjalët nuk kanë të përfunduar e që do të shkruhet e do të thuhet sa të jetë jeta e të ekzistojë universi, nga një njeri që nuk dihet, nuk njihet e nuk flitet për të.

Të shkruaj për ty është nga dashuria, të shkruaj për ty është nga pasioni, të shkruaj për ty, madje, është që ta vërtetoj dobësinë time karshi madhështisë tënde. Të shkruaj për ty është nga mallëngjimi, përkushtimi dhe dashuria kulminante. Të shkruaj

Me ëndje të thellë dua ta dëgjoj zërin tënd melankolik e të butë. Ti je ai që na mësove, na këshillove dhe na udhëzove në rrugë e drejtë.

për ty është që ta bind vetveten që je një dhe i vetmi shembull për ne. Të shkruaj për ty për arsye se ti je shpëtimtari ynë. Të shkruaj për ty që do të jesh ndërmjetësuesi (shefat për ne) në botën e amshimit. Të shkruaj për ty që ishe komandant suprem i shtetit, udhëheqës suprem i ummetit tonë dhe një bashkëshort i mirë e njeri i moralit më të përkryer. Të shkruaj për ty që ishe udhëheqës i mirë, kryetar i denjë, i përkushtuar dhe i përgjegjshëm. Të shkruaj për ty që ishe ilaç për ata të cilët ishin të sëmurë. Të shkruaj për ty që ishe, je e do të jesh e do të mbetesh çelës i dyerve të mbyllura e zgjidhës i problemeve e melhem për plagët e Ummetit. Të shkruaj për ty që na mësove se si duhet të adhurohet Zoti, se si duhet jetuar në këtë botë dhe si duhet përgatitur për botën tjetër. Të shkruaj për ty që nuk të pashë, nuk të shikova, nuk të përkëdhela dhe nuk të përqafova në jetën time reale edhe pse shumë të doja. Nuk e pashë nurin tënd,

fytyrën, shtatin, qëndrimin. Zërin nuk ta dëgjova. Me ëndje të thellë e pres një ditë të të shikoj. Me ëndje të thellë e pres që të të përqafoj. Me ëndje të thellë e pres që të të përkëdhel. Me ëndje të fortë e pres të ta shtrëngoj dorën fort e mos ta lëshoj. Me ëndje të thellë dua ta dëgjoj zërin tënd melankolik e të butë. Ti je ai që na mësove, na këshillove dhe na udhëzove në rrugë e drejtë. Ti je ai që na mësove që ta duam Krijuesin e gjithësisë, prindërit, të afërmit, farefisin, fqinjët, madje edhe të largëtit. Ti je ai që na mësove mirësinë, butësinë, mëshirën, solidaritetin. Ti je ai që na mësove si ta duam jetimin dhe të përkujdesemi për të. Ti na mësove t'i duam të vjetrit dhe të rinjtë. Ti na mësove t'i respektojmë mësuesit, profesorët dhe intelektualët në përgjithësi. Ti vetëm dhe vetëm ti, o Muhamed, o i dashuri ynë, o mëshira e botëve...

Ti u mësove përsosmërinë njerëzve në përgjithësi, të eksplorojnë në tokë, në gjithësi, në planet, me qëllim të gjetjeve që nuk kanë qenë të zbuluara deri më tani.

Njohuritë vetëm sa rriten e shtohen ndërsa fatlum është ai i cili hulumton dhe kërkon me qëllim të zgjerimit të njohurive dhe ngritjes së vetëdijes drejt formimit të personalitetit të vet. Njohuritë janë të shumta dhe ato marrin formë varësisht prej vetë përzgjedhjes së kërkuesit apo hulumtuesit.

Hulumtoni te një gjigant, njeri i jashtëzakonshëm e ai ishte Muhamedi a.s. do të mahniteni se çka do të gjeni te ky njeri dhe nuk do jeni pishman edhe as për një moment më të vogël që keni kërkuar nga dhe tek ky njeri. I përmasave të papara, që ende asnjë njeri nuk është zhgënjyer nëse e ka pasuar me gjithë shpirt e me gjithë zemër. Shembull i përsosmërisë, i pagabueshëm, dy miliardë të duan e të pasojnë, emër i madh, i lavdëruar Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin me ty dhe për ty.

Rënkoi me vaj dhe druri

Atë e përshëndeste guri,
Kur prej vetes atë e largoi
Rënkoi me vaj dhe druri
pas ledhatimit t'Tij pushoi.

Njerëzit e panë me habi
U ngritën plot kureshtje
U afruan pranë atij druri
Që ua theu atë heshtje.

Sikur dora e tij bujare
Të mos kish' ledhatuar
Deri ditën ma t'mbramë
Do t'ishte duke rënkuar.

Ai ishte vetëm një dru
Ku mbi të ulej Ai Resul
E ndjeu mungesën e Tij
Pse mbi të, Ai më s'u ul.

Po këto zemra prej mishi
A s'duhej t'i ngjanin drurit
Me vaj të ishin mbytur
Pse janë larg prej Resulit.

Ende nuk është vonë
Të zgjohesh prej gjumi
Nëse do të jesh pranë
Mexhlisit të Atij Resuli.

Kthjellohu sa s'është vonë
Dëgjoi mirë ato porosi
Në çdo moment kujto
Se Resuli është me ty.

Atëherë rri larg mëkatit
Ik nga shoqëria e gabuar
Ndihmo jetimët e t'varfrit
Nëse do të jesh i shpëtuar

Besim Nuzi

Ma.Vehbi SHATRI

Shtypi shqip në Kosovë për sulmet e policisë serbe ndaj Medresesë "Alauddin" në Prishtinë

Medreseja "Alauddin" në Prishtinë vazhdimisht ishte e lidhur ngushtë me çështjen dhe fatin e popullit të Kosovës. Këtë lidhje e kishte në çdo kohë dhe rrethanë, sidomos në ato më të vështirat që kaloi populli, ky popull gjatë sundimit serb pothuajse gjithnjë ishte në kohë të vështira.

Qëndrueshmëria dhe mbijetesa e Medresesë ishte rrjedhojë e trimërisë dhe e forcës që ajo kishte ekspozuar në gjithë rrugëkalimin e historisë së saj. Medreseja "Alauddin" ishte simbol i rezistencës shqiptare, sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit para luftës së fundit në Kosovë.

Në këto kohëra të vështira, Medreseja "Alauddin" hapi dyert e saj për çështjen e popullit shqiptar, duke mos kursyer asgjë për institucionet e Republikës së Kosovës. Në Medrese, kalitej ndjenja dhe gatishmëria për t'u përballur me të gjitha sfidat dhe vështirësitë që përjetonte populli shqiptar.

Edhe ky institucion, ngjashëm me institucionet e tjera, nuk u shpëtoi dot sulmeve të policisë serbe. Dhe për ketë, jam munduar të hulumtojë në shtypin ditor në gjuhën shqipe dhe jam orientuar te "Shtypi shqip në Kosovë për sulmet e policisë serbe ndaj Medresesë".

Fillimi i verës së vitit 1992, sinjalizoi se me "shtetin juridik" do të jetë më vështirë, e konkretisht më datën 23 qershor 1992, që ishte paralajmëruar se në Medresenë "Alauddin" do të mbahej një mbledhje e rëndësishme për popullin shqiptar dhe ajo ishte "mbledhja themeluese e Kuvendit të Republikës së Kosovës" si vazhdimësi e zgjedhjeve të lira shumëpartiake të 24 majit 1992. Si rrjedhojë, po në këtë datë, në orën 03, mbi 150 policë, me autoblinda dhe me automjete të tjera e sulmojnë Medresenë duke e mbajtur drejtorin e Medresesë, profesorin Qazim Qazimi, njëkohësisht si peng dhe mburojë.

Por, a nuk janë këto fakte e të ngjashmet me to që bëjnë apel në ditët tona për bashkim, për shqiptarizëm, për ndjenjë kombëtare, për investim të vlerave intelektuale në interes të çështjes kombëtare, dhe që ky institucion të zërë meritueshëm vendin që i takon në Kosove?!!

Medreseja Alauddin - Qëndresë ndaj veprave vandale të policëve serbe

-Dje rreth orës 10 ekipi i reporterëve te "BUJKUT" tentoi të afrohet pranë Medresesë "Alauddin" e cila që parmbrëmë në orët e mesnatës ishte pushtuar nga forca të mëdha serbe. Mirëpo kjo ishte e pamundur, ngaqë përveçqë shkolla ishte e rrethuar me policë, të shumtë dhe autoblinda e snajperistë në kulm të ndërtesës, të gjitha rrugët që çonin nga Medreseja ishin të bllokuara nga policët dhe kontrollonin e legjitimonin çdo person në afërsi. Rreth objektit një pjesë e policëve ishin shtrirë dhe flinin në shkallët e objektit dhe mbështetur për rrethoja të oborrit disa shkruanin edhe letra, pjesa e madhe e tyre ishin brenda objektit të pushtuar, disa sish ishin të dehur nga alkooli.

Po në gazetën "Bujku", të datës 24 qershor 1992, thuhet: "Bëhet e ditur se në asnjë xhami të Prishtinës dje nuk i është lejuar xhematit që të hyjnë brenda për të kryer ritualin fetar. Gjithashtu me forca të mëdha policore ishin rrethuar edhe Meshihati i Fesë Islame të Kosovës në Prishtinë, dhe askush nuk lejohej që të hynte brenda."

Këshilli për mbrojtjen e lirive dhe te drejtave të njeriut në Prishtinë bën të ditur se që nga orët e mëngjesit, mes pallatit "Boro Ramizi" dhe lokaleve të SHSHK-ut, në gjendje gatishmërie për intervenim ka qëndruar një njësi speciale e armatosur e ashtuquajtur Jugosllavi. Dëshmia më e mirë se Serbia nuk është e rrezikuar nga shqiptarët, siç pohohet nga zyrtarët serbë, është fotografia jonë.[1]

-Prej Medresesë Alauddin në Prishtinë, e cila qysh në orën 3 të 23 qershorit 1992 u pushtua nga forcat policore serbe, edhe dje u kthyen profesorët dhe personeli tjetër, me pretekst se nuk kanë urdhër nga eprorët të tërhiqen, se ky objekt qenka shumë i përshtatshëm për ta.

Punëtorët e Medresesë që gjatë ditës së djeshme bënë përpjekje të

hynin në objekt e nuk u lejuan, tregojnë se edhe me tej këtu kumbon kënga serbe, e para objektit në mobiliet e shkollës vazhdon ahengu me raki, kurse në katin e tretë të internatit vërehen snajperistë.

Dy punëtorë të Medresesë, Ismail Gashi dhe Emrush Maxharri, dhe dy qytetarë, Fatbardh Makolli dhe Avni Zejnullahu, që në momentin e arrestimit të punëtorëve të tjerë në mëngjes të 23 qershorit nuk u vërejtën nga policia serbe e pardje pasdite, pas alarmimit të meshintit, u nxorën nga objekti i internatit e u dërguan e u maltretuan në polici, tregojnë se në objekt ndodhen diku prej 60 deri 70 policë, një pjesë e mirë e inventarit është shkatërruar. Gjatë ditës se djeshme siç na tha zëvendës kryetari i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Kosovës Naim Ternava: bëmë përpjekje të kontaktojmë me eprorët e policisë, por më kot, na premtuan se do të na pranojnë tek sot në orën 10 (dhjetë). Jemi posaçërisht të brengosur për fatin e këtij objekti më të mirë që kemi e që u ndërtua me mjete të besimtarëve tanë.[2]

-Dëmet që u shkaktuan më ketë rast janë të mëdha, kishte deklaruar drejtori i kësaj Medreseje Qazim Qazimi.

Në Medresenë e Mesme të Prishtinës "Alauddin" janë të vendosura grupe të mëdha diversantësh, të cilët dëshirojnë hapjen e konfliktit të armatosur në Kosovë, ishin fjalët me të cilat iu drejtua policia serbe drejtorit të këtij institucioni fetar, Qazim Qazimit. Me rastin e rrëmbimit në shtëpinë e tij në Gjilan me datën 22.06.1992, në mbrëmje, në orën 23, kjo gjoja i shërbeu si peng policisë serbe, për ta pushtuar shkollën në orët e para të ditës, më 23 qershor. Dhe vërtet me mua policia u soll në mënyrë të vrazhdë, duke më maltretuar fizikisht e psiqikisht, plotësisht 13-14 orë, derisa definitivisht u pushtua Medreseja, duke aktruar se janë të rrezikuar,- thotë Qazimi, dje me rastin e bisedës qe zhvilluam, pasiqë sërish i mori çelësat e Medresesë dhe kryen funksionin e drejtorit të saj.

Ndërkaq në numrin e datës 25 qer-

shor, në gazetën "Bujku" thuhet: "Pas plot 3 ditësh, dje paradite delegacionit të Meshihatit Islamik të Kosovës, komandanti i policisë serbe në Kosovë, ia dorëzoi çelësat e Medresesë "Alauddin", dhe urdhëroi milicinë të tërhiqeshin nga objekti, ku është dashur të mbahet mbledhja e parë konstituive e parlamentit të parë shumëpartiak të Republikës së Kosovës, pas zgjedhjeve të 24 majit të këtij viti.

Këto zgjedhje ishin një nga aktet burimore kushtetuese dhe politike me të cilat lindi Republika e Kosovës, pra zgjedhjet e lira dhe shumëpartiake për Kuvendin dhe Kryetarin e Republikës së Kosovës me 24 maj 1992.[3]

Dëmet materiale nuk mund të vlerësohen menjëherë tha drejtori, por në bazë të përshtypjeve të para, ato janë të mëdha, ngase policia me rastin e pushtimit të objektit asnjë derë nuk e ka hapur si duhet, por me shqelma duke i thyer ato dhe duke dëmtuar edhe murin përreth. Kështu që, afro 50 dyer vetëm të konviktit të nxënësve janë të dëmtuara dhe shumë sosh të klasave dhe të kabineteve mësimore. Sipas vërejtjes sonë, tha drejtori, janë bërë dëme të jashtëzakonshme materiale, në objekt një nga milicët, me rastin e pranimit sot, më tha që janë marrë vetëm shkronjat që shënonin datën e mbajtjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe shqiponja, kurse sa për dëme, *"unë paguhem 300 miliardë në muaj për të thyer e demoluar".*

Gjatë ditëve të qëndrimit të policisë në objekt janë plaçkitur sasi të mëdha të ushqimit të gatshëm për nxënës dhe rezerva për kohë më të gjatë, siç janë mishi, buka, konserva të ndryshme, sasi të mëdha barërash etj. Me rastin e pushtimit të objektit, pos zyrës së drejtorit, të sekretarit dhe të arkëtarit, pa prezencën e kompetentëve të Medresesë, është thyer edhe arka dhe atë rast është marrë një shumë e madhe e mjeteve revizore, të cilat kanë qenë mjete të qytetarëve tanë nga bota që Medresesë i kanë arritur në emër të 328 kurbanëve. Këto mjete më janë kthyer po atë ditë që u pushtua Medreseja, por nuk më kanë ftuar të jem prezent në rastin e thyrjes së arkës, por vetëm në rastin e kthimit të parave, kështu që nuk di gjendjen financiare të arkës para thyrjes,- tha Qazimi.

Me rastin e rrëmbimit, Qazimit policia serbe nuk i kanë lëshuar kurrfarë vendimi apo autorizimi për ta bastisur Medresenë, kështu që hyrja me dhunë në objektin fetar mund të konsiderohet okupim klasik i tij, kurse dje me rastin e dorëzimit të çelësave të saj, drejtorit në SPB i lëshohet një vërtetim, ku okupimi arsyetohet gjoja me dyshimin e bazuar se në Medrese po mbahet një tubim ilegal pa lejen e organit kompetent.[4]

1. Z.G, foto I.B,Bujku, më 24 qershor1992. 2. Bujku, më 25 qershor1992. 3. Nga lënda Historiku i institucioneve, tema:SISTEMI POLITIK I KOSOVËS, gjatë mësimeve në master Histori-Arkivistikë. 4. Z.Gecaj, Bujku, më 26 qershor1992

Ismail el Faruki & Lois Lamja el Faruki

Përmbajtja, efekti dhe forma sulblime e Kuranit (2)

Sublimiteti i mesazhit të Kuranit shprehet në shumë aspekte: Kurani e pohon mendimin e shëndoshë dhe arsyeshmërinë si qëndrimin ideal të mendjes njerëzore. Ai mëson çlirimin nga kontradikta, inkoherenca, ambiguiteti; nga paradoksi, miti, dhe çdo lloj obskurantizmi.

Kurani nuk i paracakton prioritet as revelimit, as arsyes, por deklaron barasvlerën e tyre, duke i shpjeguar të gjitha mospërputhjet midis tyre ose si një mungesë në të kuptuarit e revelimit, ose si një gabim në proceset e arsyes.

Qëndrimi kuranor është, si rrjedhim, optimist në lidhje me aftësinë e njeriut për dije. E vërteta, mendon ai, është e njohshme; e pavërteta nuk është kurrë përfundimtare, dhe mund të kapërcehet gjithmonë me njohje më të mirë. Islami, aftësinë për të njohur të vërtetën, e pohon për të gjithë njerëzit dhe e afirmon atë si bazë të universalizmit islamik.

Ai mohon çdo kategorizim të njerëzve, që bën diskriminim midis tyre në lindje për sa i përket aftësisë së tyre, apo për sa i përket lidhjes së tyre me Zotin, Krijuesin e tyre.

Islami e identifikoi veten me dijen. Ai e bëri dijen kushtin e tij si edhe qëllimin e tij. Ai e barazoi kërkimin e dijes me adhurimin dhe derdhi lavdërimet e tij më të pakursyera mbi ata që angazhohen për kultivimin e saj, duke i bërë ata të shenjtë dhe miq të Zotit dhe duke e ngritur bojën e tyre mbi gjakun e martirëve. Megjithatë, dija islame nuk është një njohuri upanishadike, të cilën njeriu e fiton nga një mësues guru. Ajo nuk është as një shkreptimë e pavullnetshme në ndërgjegjen e një pasuesi që i nënshtrohet një eksperience mistike. Dija islame është perceptim racional – empirik dhe intuitiv – i çdo sfere të realitetit. Ajo është dije kritike e njeriut dhe e historisë, e tokës dhe e qiellit. Dija është e pafundme për shkak se e vërteta është e pafundme.

Mesazhi kuranor nuk e ndan realitetin material në të shenjtë dhe profan, jetën njerëzore në religjioze dhe shekullare. Relevanca e mesazhit të Kuranit, si edhe ajo e sheriatit, nuk është një libër i mbyllur.

Islami nuk ka përkrahur një status të një "të parapëlqyeri", "të zgjedhuri", as për muslimanët, as për ndokënd tjetër. Ai e urren çdo lloj të partikularizmit, tribalizmit, nacionalizmit, racizmit apo etnocentrizmit; dhe mëson se asnjë karakteristikë e lindur nuk fiton ndonjë prioritet për askënd. Çdo njeri duhet dhe do të marrë ekzaktësisht atë që ai e meriton.

Kurani e fton njerëzimin që ta pranojë mesazhin e tij në mënyrë racionale, në mënyrë kritike dhe në liri. Ai i urdhëron muslimanët që në misionin e tyre të theksojnë vendet e pajtimit dhe t'i forcojnë ato, "*për të thirrur në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshillë të mirë*" (Kurani 16:125), dhe për të mos e detyruar kurrë, askënd, në çështjen e fesë (Kurani 2:256).

Kurani e deklaron umetin një vëllazëri universale, brenda së cilës mund të veprojnë në të njëjtën kohë një pluralitet sistemesh ligjore dhe kulturore.

Mesazhi kuranor nuk e ndan realitetin material në të shenjtë dhe profan, jetën njerëzore në religjioze dhe shekullare. Relevanca e mesazhit të Kuranit, si edhe ajo e sheriatit, nuk është një libër i mbyllur. Ai është gjithnjë i hapur ndaj realiteteve të reja.

Sublimiteti i formës

Muslimanët iu kushtuan studimit të Kuranit nga aspekti letrar dhe u përpoqën që të zbulonin sekretet e bukurisë dhe mrekullisë së tij, aspektet apo shkaqet që e bënin Kuranin të papërballueshëm dhe të pakrahasueshëm.

Së pari, Kurani nuk është as poezi, as prozë e rimuar. E para përbëhet nga vargje identike në skemën e tyre metrike (numër, zgjatje, dhe pozicion të rrokjes) dhe rimë (bashkëtingëllore dhe vokalizim të rrokjes së fundit). E dyta është proza, fjalitë dhe frazat e së cilës theksohen prej një rime e cila mbahet gjatë gjithë veprës. Kurani nuk është asnjëra, ndonëse ai përmban diçka prej karakteristikave të të dyjave. Kurani bën përdorimin e lirë të tyre me qëllim që të nxjerrë në pah synimet e tij. Përdorimi nga



ana e Kuranit i elementeve të poezisë dhe prozës së rimuar është gjithmonë më i miri dhe më elokuenti, por ai nuk është kurrë i tillë sa për të bërë të mundshëm ngjashmërinë apo pështjellimin me to. Kjo është arsyeja se përse duhej shpikur një kategori e re për ta klasifikuar Kuranin përtej poezisë dhe prozës, dhe pikërisht 'prozë absolutisht e lirë'.

Së dyti, ajeti kuranor përbëhet prej fjalëve dhe frazave që i përshtaten domethënieve në mënyrë perfekte. Diksioni i tij është gjithmonë i saktë dhe perfekt në mënyrë absolute. Çdo ndryshim, sado i vogël, është një ndryshim për keq. Asnjë fjalë nuk mund të kapërcehet pa prishjen e rrjedhjes dhe domethënies së vargut.

Së treti, fjalët dhe frazat kuranore të një verseti, apo të një pjese të versetit, krahasohen apo vihen në kontrast në mënyrë perfekte me ato të frazës apo vargut paraprijës apo pasues, qoftë në ndërtim, qoftë në domethënie. Rrjedhja e fjalëve të tij shkakton kështu tensionin dhe shpresën më të madhe, qetësinë dhe kënaqësinë më të madhe të mundshme. Kjo cilësi e kompozicionit kuranor u quajt tevazun apo balancë dhe ajo vepron si te forma, ashtu edhe te përmbajtja e tekstit.

Së katërti, fjalët dhe frazat kuranore shprehin domethëniet më të pasura dhe më të fuqishme në format më të shkurtra. Ai nuk është kurrë fjalëshumë dhe asnjë fjalë nuk është kurrë e tepërt. Çdo parafrazim i një fraze, fjalie apo verseti, kërkon më tepër fjalë dhe gjithmonë shfaqet i zgjatur, artificial, fjalëshumë dhe rrjedhimisht, më pak i fuqishëm, më pak elokuent dhe më pak prekës sesa origjinali kuranor. Megjithatë, shkurtësia nuk është parim absolut për t'u respektuar në çdo rast. Ekzistojnë shembuj në Kur'an në të cilët përsëritja dhe shtrirja janë të domosdoshme. Në këto raste ato kanë justifikimin e tyre të veçantë.

Së pesti, krahasimet dhe metaforat, konjuksionet dhe disjunksionet [bashkimet dhe veçimet] e koncepteve dhe urdhrave, përçojnë apelimin më të madh të mundshëm. Ato përplasen me imagjinatën me një forcë të tillë të fuqishme, saqë ato e lënë atë "pa frymë" në tronditjen dhe magjepsjen e saj. Për këtë cilësi unike të Kuranit, estetët letrare arabë shpikën termin 'sublimisht kreative'.

Së gjashti, kompozimi kuranor është gjithmonë i përpiktë, si një vepër arti me perfeksionim absolut. Rrjedha dhe struktura e tij është krejtësisht e lirë prej zbrazëtirave apo pikave të dobëta. Ekzistojnë shembuj të shumtë ku një fjalë apo një frazë e tërë mungon, por domethënia është gjithmonë e qartë. Fjala apo fraza munguese është hequr në mënyrë të qëllimshme, me qëllim që ta bëjë atë që i paraqitet vetëdijes akoma më të tendosur.

Së shtati, stili kuranor është po aq i fuqishëm, emfatik dhe ngulmues, sa edhe i butë dhe delikat. Lexuesi mund ta ndiejë atë të bjerë si shkëmb mbi të, apo të bjerë me finesë dhe butësi të pafundme. Kjo është arsyeja se përse ai u quajt 'bukuria e rënies mbi vetëdije'. Qoftë kur ai murmurit si një krua i kulluar, qoftë kur godet furishëm si një përrua, qoftë kur kërcen dhe hidhet vetë me rrëmbim si një sulm kalorësie, ika-ja e tij është gjithmonë perfekte.

Së teti, kompozimi kuranor nuk ka strukturë në kuptimin e zakonshëm të termit. Ai kombinon kohën e tashme, të shkuar, të ardhme dhe mënyrën urdhërore në të njëjtin fragment. Ai zhvendoset nga fjalimi raportues i personit të tretë tek personi i dytë adresues; nga deskriptivja [përshkrimorja] tek normativja, nga pyetësja tek thirrmorja dhe nxitësja. Ai është përsëritës, ndonëse në çdo përsëritje përçohet një mesazh i ndryshëm.

Së nënti, teksti kuranor nuk është i renditur as topikalisht [sipas aktualitetit], as kronologjikisht, mbasi qëllimi i tij nuk është as analiza sistematike, as raportimi, as historiografia. Ai është përmbi gjithçka, fillim e fund, trup i letërsisë në të cilin çdo frazë, varg, grup vargjesh, apo sure përbën një njësi autonome, të plotë në vetvete, dhe njësitë janë të lidhura së bashku. Ndryshimi i papritur i kohës dhe tonit ushtron një fuqi më emocionale mbi imagjinatën. Përsëritja nuk është kurrë e tepërt meqë mësohet dhe theksohet një mësim i ri që bazohet në një aspekt të ri të një ngjarje tashmë të njohur. Asnjë rrëfim i Kuranit nuk jepet për informacion. Më saktë, familjaritetin e pranuar të dëgjuesit me vijën e përgjithshme të ngjarjes apo ndodhisë, Kurani e përdor si mbartës për mësimin e ri që ai synon ta ngulitë në mendjen e dëgjuesit.

Së fundi, rrjedha e vazhdueshme e njoftimeve, përshkrimeve, dhënieve të llogarisë dhe leksioneve të Kuranit synon që të të bindë dhe të të mbushë mendjen me anën e bukurisë dhe forcës së frazave, vargjeve, apo grumbullit të vargjeve të tij. Një person me kompetencën e nevojshme në gjuhën arabe ndoshta mund t'i rezistojë kërkesës së një vargu, apo një grumbulli vargjesh, vetvetiu; por asnjë nuk është i aftë që t'i rezistojë kërkesës që shfaqet nga rrjedha në dukje e pafundme. Rrjedha kuranore gjeneron një energji që e dëbon mosbindjen e dëgjuesit dhe kokëfortësinë e tij me anën e goditjes së larmishme dhe e bart më në fund atë dëgjues në destinacionin e saj.

Përktheu nga anglishtja
Mimoza Sinani

*"**The Cultural Atlas of Islam**", Isma'il al Faruki and Lois Lamya al Faruki, Publisher: MacMillan Publishing, 1995.*

Dr. Argëtim Saliu

Organizimi administrativ i Perandorisë Osmane

model shembullor i organizimit juridiko-politik

Sami Frashëri ishte ai i cili i vetëm hartoi projektin e riorganizimit administrativ të Perandorisë Otomane duke iu përshtatur kushteve të reja të kohës që ishin krijuar. Ky projekt i panjohur nga historiografia shqiptare dhe turke, është bërë i njohur për herë të parë nga studiuesja turke, prof. dr. Selda Kaja Kilic dhe është transmetuar nga studiuesi shqiptar Kujtim Nuro.

Ajo e ka gjetur projektin e përgatitur nga Sami Frashëri në arkivat e Stambollit dhe në publikimin e bërë prej saj thekson se: " ky dokument nuk ka tërhequr dhe aq vëmendjen"...

Historia e civilizimeve është e mbushur me personalitete të njohura dhe bashkësi të ndryshme organizative. Në saje të rregullimit dhe organizimit të brendshëm, si dhe falë kontributit të tyre në afirmimin e vlerave në sfera të ndryshme (politike, ushtarake, kulturore, shkencore etj.), u la gjurmë të pashlyeshme në historinë e njerëzimit.

Në këto bashkësi organizative pa dyshim bën pjesë edhe Perandoria Osmane, fillet e së cilës ishin nga një fis endacak në sistem të provincës stabile, e më pastaj në një shtet të madh e të fuqishëm, i zgjeruar në Azi, Afrikë dhe Evropë. Me këtë shtrirje gjeografike Perandoria Osmane ishte bërë një ndër shtetet islame më të mëdha që njeh historia.

Feja islame ka qenë faktor i rëndësishëm dhe është konsideruar si fe zyrtare që prej kohës së Emir Othmanit, i cili e konsideronte fenë islame si ndriçues në vendime, kërkonte mendime dhe këshilla prej juristëve myslimanë dhe e mbronte të drejtën në mesin e popullit. Pikërisht me potencialin e tij Emir Othmani vuri fillet e rregullimit të sistemit administrativ dhe ushtarak, ngase në kohën e tij osmanët u transformuan prej fisit endacak në provincë stabile, e më pastaj edhe në zhvillimin e shpejtë të qendrës, në superfuqi botërore, me kapacitete të larta ushtarake dhe administrative.

Kryesia islame në kryeqendër gëzonte autoritet të lartë, udhëheqësi quhej Myfti, e më vonë Shejhul-Islam, i cili i përfaqësonte të gjitha institucionet fetare dhe gjyqësore. Politika zyrtare e shtetit në aspektin fetar i afronte dijetarët dhe të devotshmit, ata respektoheshin thellë nga paria dhe popullata.

"Njeriu i penës", shtyllë e administratës

Perandoria Osmane bëri ndarjen e shoqërisë në dy klasa: në "sundues turq" dhe "populli i sunduar". Në grupin e parë bënin pjesë ushtria, kryesia islame dhe administrata. Ushtria Osmane i ngjante medaljes me dy anë: njëra është lufta, kurse tjetra sundimi dhe, me të drejtë thuhej se shteti osman ishte shtet ushtarak. Kryesia islame në kryeqendër gëzonte autoritet të lartë, udhëheqësi quhej Myfti, e më vonë Shejhul-Islam, i cili i përfaqësonte të gjitha institucionet fetare dhe gjyqësore. Politika zyrtare e shtetit në aspektin fetar i afronte dijetarët dhe të devotshmit, ata respektoheshin thellë nga paria dhe popullata. Sulltanët ishin të kujdesshëm në dëshirat e tyre sulltanore, si dhe në nxjerrjen e ligjeve pozitive, të cilat duhej të ishin në përputhje dhe në harmoni me parimet e sheriatit islam.

Administrata kishte për obligim tubimin dhe shpërndarjen e tatimeve, pajtimin e njerëzve të grindur, edukimin dhe arsimimin e popullatës, marrëdhëniet diplomatike, mirëmbajtjen e arkivit dhe

regjistrit qendror etj. Teoria politike e Perandorisë Osmane, krahas "njeriut të shpatës" dhe "njeriut të fesë", ka dalluar "njeriun e penës", duke e konsideruar atë shtyllë të administratës, ndërsa në shtetet islame paraosmane kreu i Portës, me titull vezir, zakonisht ka qenë autoritet i cili më parë është shquar në zyrën ose arkën shtetërore. Aparati shtetëror ka qenë i ndarë në administratën qendrore, të cilën e përbënte këshilli sulltanor dhe administrata provinciale, të cilën e përbënte Sistemi timar.

Këshilli sulltanor ose Porta e Lartë obligim parësor e ka pasur dëgjimin e ankesave të popullit, duke i zgjidhur padrejtësitë. Ky institucion është mbledhur dy herë në javë, ku prezent ka qenë edhe vetë Sulltani, që drejtpërsëdrejti t'i dëgjojë ankesat e popullit. Problemet mund të zgjidheshin në bazë të parimeve të Sheriatit, ku përgjegjës ishte Kadiu, ndërsa në rastet apo konfliktet ndërmjet vet popullatës që ishin me pretekst jo-fetar i takonin pjesëtarëve të Divanit- këshillit sulltanor. Porta e Lartë në fillim ka nënkuptuar vendin prej të cilit Sulltani i ka ndjekur paditë dhe i ka kryer punët shtetërore, ndërsa më në fund me këtë term është nënkuptuar Qeveria Osmane. Ky këshill i ka ruajtur tiparet e para të Gjyqit të lartë dhe se vetë pjesëmarrja e Sulltanit në këshill ka qenë tregues i mirë se Sulltani kujdeset për problemet e popullit dhe drejtpërsëdrejti merr pjesë në zgjidhjen e tyre. Porta e Lartë ose Këshilli perandorak është prezantuar në formën e gjykatës së lartë, duke ndarë drejtësi, por njëkohësisht ka luajtur rolin e kabinetit, ku është debatuar për problematika të ndryshme dhe janë marrë vendime në lidhje me emërimet, shkarkimet dhe punë të tjera nga sfera shtetërore. Në kuadër të këtij këshilli bënin pjesë tre njësi apo komisione të veçanta: njësia për çështje politike, për jurisprudencë dhe njësia për çështje financiare. Mbrojtja e pushtetit shtetëror, mbrojtja e territorit nga armiku i jashtëm dhe kujdesi për sigurinë e brendshme kanë qenë problemet politike për të cilat përgjegjësi kanë bartur vezirët, ndërsa dy kazaaskerë kanë përfaqësuar jurisprudencën, ndërsa defterdarët kanë qenë përgjegjës për financat. Po ashtu, një rol të rëndësishëm në administratën osmane luante edhe nishanxhiu, i cili ishte udhëheqës i zyrës që vërtetonte urdhrat dhe letrat që i dërgonte Këshilli perandorak, duke iu vënë tugër- monogrami zyrtar i Sulltanit, që ta bëjë të vlefshëm dhe zyrtar vendimin apo kërkesën.

Roli dhe pozita e administratës osmane

Udhëheqësit e këtyre katër njësive përfaqësonin autoritetin e Sulltanit në Këshillin perandorak dhe kishin të drejtë që me nismë vetjake të dalin para Sulltanit dhe përgjigjeshin vetëm para tij, ndërsa para Kadiut mund të gjykohen vetëm nëse bëhej fjalë për kontestet gjyqësore të qytetarëve. Sulltani ka pasur të drejtën eksplicite për të marrë vendime për veprimtarinë e tyre publike. Sipas dispozitave të Kanun-names së Mehmed Fatihut është përshkruar më së miri roli dhe pozita e administratës së Perandorisë Osmane, me atë rast thuhej se: veziri i madh është koka e vezirëve dhe eprorëve ushtarakë dhe zëvendës absolut i Sulltanit; defterdari, përgjegjës për arkën e shtetit, por nën mbikëqyrjen e Ve-

zirit të madh. Të gjithë udhëheqësit administrativ dhe eprorët ushtarak, si: vezirët, mëkëmbësit, klasa ushtarake, raja dhe ulematë me lutje dhe kërkesa paraqiteshin te Veziri i madh, i cili nëse e shihte të arsyeshme, ia paraqiste Sulltanit, për të marrë pëlqimin e tij, e më pastaj jepej urdhri me vulë të Sulltanit. Në disa raste dhe situata Veziri i madh, si zëvendës i Sulltanit, kishte të drejtë që disa vendime t'i merrte vetë, me çka nënkupton se Veziri i madh ishte përfaqësuesi absolut i pushtetit ekzekutiv të Sulltanit.

Defterdari ishte përgjegjës për arkën shtetërore, kështu që pa lejen e tij nuk është realizuar asnjë hyrje apo dalje nga arka dhe për çdo muaj defterdari ka përgatitur raport, që i ka shkuar Vezirit të madh. Kërkesat për ndërrimin e defterdarit janë bërë drejtpërdrejt te Sulltani.

Kazaaskerët kanë qenë funksionarë shtetërorë, përgjegjës për zbatimin e Sheriatit. Ata kanë marrë vendimet përfundimtare në paditë gjyqësore në lidhje me jurisprudencën dhe Sheriatin. Po ashtu, kanë pasur të drejtë të bëjnë emërimin dhe shkarkimin e kadive.

Shejhul-islami, si kategoria e parë e ulemave, ka gëzuar autoritetin më të lartë intelektual dhe të pavarur nga Veziri i madh, duke përfaqësuar kështu autoritetin fetar të Sulltanit. Pasi që në zyrën e Vezirit të madh janë marrë vendime në lidhje me aktivitetet shtetërore, tre personalitetet gjithmonë kanë qenë në shërbim permanent të Vezirit të madh: qehajabeu, i autorizuar për çështje politike dhe ushtarake; çaush-basha, i cili i ka pranuar paditë gjyqësore; dhe reisul-kitabi, i cili ka qenë sekretari kryesor i Divanit Sulltanor dhe rojtar i dispozitave dhe ligjeve shtetërore. Në mbledhjet që janë mbajtur në rezidencën e Vezirit të madh, të lartëpërmendurit prezantonin si anëtarë qeverie, ndërsa përfundimisht nga shekulli XIX ushtruesit e këtyre detyrave emëroheshin si ministra sipas radhitjes, ministër i punëve të brendshme, ministër i punëve të jashtme dhe ministër i drejtësisë.

Si pjesë përbërëse e administratës provinciale, sulltanët emëronin dy përfaqësues të shtetit që kishin për detyrë qeverisjen e rajonit: ata ishin beu dhe kadiu. Beu i takonte klasës ushtarake dhe përfaqësonte pushtetin ekzekutiv, ndërsa kadiu vinte nga radhët e ulemave, i cili në emër të Sulltanit përfaqësonte drejtësinë. Veprimtaria e tyre ishte e ndërlidhur njëra me tjetrën, pasi që beu nuk kishte mundësi të bënte ekzekutimin e dënimeve para se të merrte vendimin nga ana e kadiut. Ndërkaq, kadiu nuk mund të zbatonte në vepër vendimin e tij me karakter gjyqësor. Kadiu urdhrat i merrte drejtpërdrejt prej Sulltanit dhe kishte mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë t'i drejtohet Sulltanit.

Sami Frashëri si hartuesi i vetëm i projektit për ri-organizimin administrativ të Perandorisë Osmane

Sipas studiueses turke, prof. dr. Selda Kaja Kilic dhe hulumtimeve të studiuesit shqiptar Kujtim Nuro, Sami Frashëri ishte ai i cili i vetëm hartoi projektin e riorganizimit administrativ të Perandorisë Otomane duke iu përshtatur kushteve të reja të kohës që ishin krijuar. Ky projekt i panjohur nga historiografia shqiptare dhe turke, është bërë i njohur për herë të parë nga studiuesja turke, prof. dr. Selda Kaja Kilic dhe transmetuar nga studiuesi shqiptar Kujtim Nuro. Ajo e ka gjetur projektin e përgatitur nga Sami Frashëri në arkivat e Stambollit dhe në publikimin e bërë prej saj thekson se: " ky dokument nuk ka tërhequr dhe aq vëmendjen".

Projekti i hartuar nga Sami



Frashëri nuk ka datë, por ashtu siç thekson dhe prof. dr. Selda Kaja Kilic, ai mund të ketë hartuar atë gjatë viteve 1880- 1899. Për këtë, në ndihmë të përcaktimit të datës, se kur Sami Frashëri e ka përgatitur projektin, vjen nënshkrimi i tij në përfundim të tij me shënimin: Sekretar i Komisionit të Inspektimit Ushtarak- Shemseddin Sami – vula. Sami Frashëri, detyrën e sekretarit të Komisionit të Inspektimit Ushtarak e mori në vitin 1880 me kërkesë të Sulltan Abdylhamitit të II. Ai e kreu këtë detyre deri në vitin 1892 dhe po gjatë këtij, Sami Frashërit do t'i ngarkohej detyra e kryesekretarit të komisionit të lartpërmendur, detyrë të cilën e mbajti deri në fund të jetës së tij. Gjatë kësaj kohe, Sami Frashëri ka përgatitur një numër të shumtë botimesh, ndërmjet tyre edhe veprën, "Shqipëria ç'farë ka qenë, ç'është dhe ç'farë do të jetë", e cila u botua në vitin 1899.

Mendoj se një ndarje e tillë e pushtetit juridiko-administrativ të Perandorisë Osmane në administratë qendrore dhe provinciale ka luajtur një rol të rëndësishëm në kryerjen e punëve administrative dhe është bërë model shembull për sistemet e tanishme politike.

(Për shkak të natyrës së revistës, hiqen fusnotat)

Ma.sc. Burim Bibaj

Vetëvrasja sipas Islamit dhe faktorët që shtyjnë drejt një akti të tillë

Vetëvrasja është një dukuri sociopatologjike dhe devijante mjaft e përhapur në botën bashkëkohore dhe si e tillë paraqet një gjendje të sëmurë në shoqëri. Ndërsa kjo dukuri fatkeqësisht ka përfshirë edhe vendin tonë.

Pas luftës në Kosovë, nga qershori i vitit 1999 e deri në vitet e fundit, kanë ndodhur më shumë se 1020 vetëvrasje, ndërsa numri i tentimvrasjeve është shumë më i madh. Ndryshe nga koha e paraluftës, nga viti 1945 deri në vitin 1998, numri i vetëvrasjeve të raportuara është shumë i ulët në krahasim me sot."Nga viti 1945 e deri në vitin 1998, në Kosovë zyrtarisht në organet e sigurimit nuk janë shënuar më shumë se dhjetë vetëvrasje. Ishin të rralla, sepse kishte mistere. Familjet patriarkale i deklaronin vdekje të natyrshme", shkruan gazetari Bajram Mjeku. Ai shton se as në periudhat mizore të tiranëve serbë, Rankoviq e Millosheviq nuk kishte vetëvrasje, pasi shqiptarët e konsideronin akt i ulët.

Çka është vetvrasja dhe cilët janë faktorët që shtyjnë drejt një akti të tillë

Vetëvrasje do të thotë ti japësh fund jetës me duart tuaja në çfarëdo mënyre qoftë ajo. Vetëvrasja është ti marësh jetën trupit që ia ka dhënë Allahu xh.sh. Jetën e ka dhuruar Allahu xh.sh dhe i vetmi që ka të drejtë ta marrë atë është po Allahu xh.sh.

Në shoqërinë tonë mund të merren në konsideratë një mori faktorësh, që shtyjnë individin drejt vetëvrasjes dhe se nuk janë të paktë.

Nëse kemi parasysh studimin e Durkheim-it , për vetëvrasjen dhe pokështu edhe ndarjen në katër grupe që ai i ka bërë vetëvrasjes, padyshim se në shoqërinë tonë ndeshemi me tipin e vetëvrasjes egoiste.

- Mosmundësia e integrimit të individit brenda për brenda shoqërisë, e shtyjnë drejt një akti të tillë. Ngase, ai e sheh veten të ndarë në raport me proceset të cilat zhvillohen në shoqëri.

- Çrregullimet mentale, humbja e besimit, kushtet e rënda ekonomike e sociale, stresi, depresioni, dukuritë si droga, alkooli, prostitucioni dhe dukuri të tjera negative, kanë të gjitha mundësitë në një përfundim të tillë, pra përfundim në vetëvrasje.

- Ndryshimet në jetën sociale, ekonomike të cilat kanë prekur gati të gjitha shoqëritë, por me theks të veçantë ato shoqëri të cilat janë më pak të zhvilluara dhe në tranzicion, normalisht që gjen evoluim më të shpejtë dukuria e vetëvrasjes.

- Sot ndeshemi edhe me një zhvillim kaq të hovshëm, të prekur nga procesi i globalizimit, dhe nga zhvillime kaq të shpejta, të cilat për individin në një formë ose në një tjetër janë të papërballueshme për integrim të shpejtë, normalisht e shtyjnë atë në një hamendësim për vetë rolin dhe rëndësinë e tij në shoqëri, dhe po kështu e shtyjnë atë drejt një përfundimi jo të kënaqshëm për të, zbehjen e rolit të tij në shoqëri.

Padyshim se në këtë rrafsh, rëndësi të veçantë në shoqërinë tonë ka efekti që ka pasur familja tradicionale (familja e tipit të gjerë), e cila ka pasur ndikim të veçantë në formimin dhe zhvillimin e individit. Ndërkaq, sot kur shoqëria jonë ndeshet me individualizimin sikurse edhe shumë shoqëri tjera, individi ka dëshmuar se është dukshëm më i dobët t'i përballojë sfidat me të cilat atakohet në situata të caktuara.

Prandaj, edhe situatat e tilla ngjallin padyshim dilema të mëdha në vetë individin, krijojnë një lloj ndjenje të pasigurisë dhe pafuqishmërisë së tij, gjë që e shtyn atë në një rrugë të tillë.

Si e trajton Islami vetëvrasjen

Jeta është një dhuratë nga i Madhi Zot, ndaj së cilës do të duhej të shtojmë kujdesin në nivelin më të lartë për ta ruajtur dhe kultivuar atë deri në momentin e vdekjes.Një person i cili ka sadopak besim tek Allahu xh.sh nuk mund të bëjë një gjë të tillë, jo nuk mund ta bëjë, por as nuk mund ta

mendojë një gjë të tillë sepse kjo vepër nuk është vepër njerëzore.

Se vetëvrasja është një nga mëkatet e mëdha, është theksuar në Kuran dhe hadith.

Allahu xh.sh në Kuran thotë: "O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete, dhe mos mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, All-llahu është i mëshirueshëm për ju. Kush e bën këtë qëllimisht dhe tejkalon kufijtë, Ne do ta hedhim atë në zjarr flakërues, dhe kjo për Allahun është e lehtë." Në këtë ajet kuranor, bashkë me vrasjen e njeriut përmend edhe punët e tjera të cilat quhen mosbindje ndaj Allahut xh.sh. si ngrënia e pasurisë së tjerëve në mënyrë të pa drejtë. Me këto vepra tregon se njeriu shkatërron jetën e tij në atë botë ku humbës del ai vetë.

Në luftën e Hajberit Pejgamberi a.s kishte lajmëruar shokët e tij për Kuzmanin, i cili në atë luftë kishte luftuar shumë dhe kishte sakrifikuar shumë, se ai do të hyjë në xhehenem. Pas këtij lajmi njëri nga shokët e Pejgamberit a.s e ndjek Kuzmanin gjatë luftës dhe e shikon që, nga dhimbja e plagëve të shumta nuk duron, hedh veten mbi shpatën e tij dhe vdes. Kur lajmërohet Pejgamberi a.s. për mënyrën e vdekjes së Kuzmanit thotë: "Midis njerëzve ka njerëz të tillë që në pamje të jashtme duken xhenetlinj nga veprat që bëjnë, por ata në të vërtetë janë xhehenemlinj. Ka dhe nga ata njerëz që duket sikur bëjnë vepra të xhehenemlinjëve por ata në të vërtetë janë xhenetlinj".

E kush e mbyt veten e tij në këtë botë, në ujë ose me litarë në atë botë do të dënohet në atë mënyrë. Pejgamberi a.s thotë: " Kush e mbyt veten në ujë, e ka mbytur për të hyrë në xhehnem. Kush e vret veten, e ka vrarë për të hyrë në xhehenem."

Ndërsa në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s thotë: "Kush bën vetëvrasje duke u hedhur nga ndonjë shkëmb, ai do të jetë në zjarr të Xhehenemit, ku do të dënohet duke e përsëritur aktin e tij përjetësisht. Kush bën vetëvrasje duke gëlltitur helm, ai do të jetë në zjarr të Xhehenemit, me helmin në dorën e tij, të cilin e gëlltit përjetësisht. Kush e vret veten e tij me ndonjë gjë të hekurt, do të dënohet në zjarrin e Xhehenemit me hekurin që do ta mbajë në dorë e me të cilin do të çaj barkun e tij, përgjithmonë."

Në momentin kur ndodh problemi, njeriu kujton se kjo botë bëhet e padurueshme, por kur kalon një kohë pas kësaj ngjarjeje, njeriu arrin ta kuptojë se ai problem që i ka ndodhur më parë nuk ka qenë dhe aq i padurueshëm sa të vetëvritet. Çdo lloj problemi me kohë kalon dhe lehtësohet dhimbja e tij. Urtësia e durimit në momentin e fatkeqësisë është që njeriu pas një kohe e kupton se nuk ka qenë fundi i botës nga ai problem.

Besimtari nuk e lë veten të shtypet nën ndjenjën e pa shpresë ndaj zgjidhjes së problemit ose të zgjedhë vetëvrasjen si zgjidhje të vetme të problemit.

Shumica e dijetarëve në lidhje me vetëvrasjen kanë rënë në një mendim se personi që vetëvritet nuk del nga feja, gjithashtu i falet edhe namazi i xhenazes. Imam Ebu Hanife dhe imamët e tjerë janë të mendimit se vetëvrasësit i falet xhenazeja, por nuk e fal atë namaz i pari i vendit, atë mund ta falë dikush tjetër nga besimtarët. Transmetohet se Pejgamberi a.s. nuk ia ka falur xhenazen Kuzmanit i cili kishte vrarë veten me shpatë por dihet shumë mirë se shokët e tij e kanë falur xhenazen e tij. Dhe Pejgamberi a.s nuk i ka ndaluar ata nga kjo vepër. Pejgamberi a.s mosfaljen e xhenazes e ka bërë që ta dënojë atë vepër dhe të tjerët të marrin mësim nga kjo.

Nuk ka ndonjë argument për qëndrimin e tij (të vetëvrasësit) gjithmonë në xhehenem. Për këtë arsye shpresohet që personi

i cili është vetëvrarë pasi të vuajë dënimin në xhehenem të hyjë në xhenet. Por kjo ekziston nëse personi gjatë vetëvrasjes ka qenë besimtar dhe për këtë vepër të tijën nuk ka besuar se është e lejuar.

Për fund

Përfundimisht trupi është amaneti më i madh që na ka dhënë Allahu xh.sh. neve, këtë na duhet ta ruajmë me shumë kujdes deri kur shpirti të dalë nga trupi pa ndërhyrjen e dorës së njeriut. Për këtë arsye njeriu duhet të durojë shumë ndaj problemeve e fatkeqësive ne jetë.

Referencat:
1. Z.Sulejmanov dhe N.Stojankovski, Socijalna patologija, Shkup 2002 fq.285-286. 2. http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/siguri/ne-kosove-pas-luftes-kane-ndodhur-1020-vetevrasje/ 3. David Émile Durkheim (1858-1917), është themelues i Institutit francez të Sociologjisë. 4. Nisa, ajeti 29-30. 5. Ibni Kethir, Tefsirul Kur'anil Adhim Stamboll 1985,II, 235. 6. Buhari, Kader, 5, Rikak, 33; Muslim, Iman, 179. 7. Buhari, Xhenaiz 84. 8. Muslim, Iman, 175; Tirmidhi, Tib, 7; Nesai, Xhenaiz, 68, Darimi, Dijat, 10; Ahmed b. Hanbel, II, 254, 478. 9. El-Askalani, Bulugu'l Meram, përkthimi në turqisht. A. Davudoglu, Stamboll 1970, II.fq. 276-277.

Myftiu Tërnava priti kryetarin e Dijanetit të Turqisë Ali Erbash

Prishtinë, 18 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Dijanetit të Turiqisë, prof. dr. Ali Erbash dhe delegacionin me të cilin ka ardhur. Pasi i dëshiroi mirëseardhje, Myftiu Tërnava e njohu mysafirin me historikun dhe organizimin e institucionit të BIRK-ut, duke theksuar bashkëpunimin e mirë që kanë me Turqinë, e veçanërisht me Dijanetin. Myftiu Tërnava po ashtu shprehu falënderime për presidentin Rexhep Tajip Erdogan, për qeverinë dhe popullin turk, të cilët vazhdimisht kanë mbështetur Kosovën në situatat më të vështira, e po ashtu vazhdojnë edhe më tej ta ndihmojnë për integrime në mekanizmat rajonalë dhe ata ndërkombëtarë. Nga ana e tij, kryetari i Dijanetit të Turqisë, prof. dr. Ali Erbash, falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe shprehu kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë. Ai njëherësh uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i dëshiruar mbarësi dhe punë të suksesshme. Ai premtoi përkrahjen e shtetit të Turqisë për Kosovën për realizimin e projekteve që do të jenë në të mirë të qytetarëve të Kosovës.(R.S)

Kryetari i Dijanetit të Turqisë Ali Erbash qëndroi në Kosovë

Prishtinë, 18 nëntor 2018

Një delegacion i lartë nga Dijaneti i Turqisë, i kryesuar nga kryetari Ali Erbash ka arritur në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë. Në pritje të tij kishte dalë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava me kabinetin e Kryesisë. Kryetari i Dijanetit Ali Erbash është mysafir i Kryesisë së BIK-ut dhe më pas zhvilloi një sërë vizitash dhe takimesh, fillimisht vizitoi Ambasadën Turke, më pas u takua në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, në të cilën u prit nga Myftiu Naim ef. Tërnava. Për namaz të drekës ishin në xhaminë "Sulltan Mehmet Fatih", për të vazhduar me vizitë vendit ku do të ndërtohet Xhamia Qendrore. Në vazhdim të agjendës ishte vizita në zyrën e përfaqësuesit të Dijanetit, kurse më pas vizituan tyrben e Sulltan Muratit. Kurse në mbrëmje mori pjesë në programin kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s.. (R.S.)

U mbajt program festiv me rastin e ditëlindjes së Muhamedit a.s.

Prishtinë, 18 nëntor 2018

Organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Diyaneti i Turqisë, në hotelin Emerald, me rastin e ditëlindjes së Muhamedit a.s., u mbajt program artistik fetar (Kuran, ilahi dhe ligjëratë).

Në këtë eveniment mori pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, kryetari i Dijanetit të Turqisë dr. Ali Erbash me delegacionin e tij, përfaqësues nga ambasada e Turqisë, përfaqësues të institucioneve të BIRK-ut, autoritete të jetës politike, kulturore, profesorë, hoxhallarë, studentë, nxënës e shumë të ftuar të tjerë. Një pjesë nga Kurani e lexoi Egzon Ibrahimi, më pas u dha një film dokumentar "Pejgamberi a.s. dhe rinia".

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava veç tjerash tha se me rastin e 12 rebiulevvelit, ditëlindjes së Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., kam nderin, kënaqësinë e respektin që, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame dhe në emrin tim personal, t'ju përgëzoj me urimet më të ngrohta. Tradita e festimit të ditëlindjes së Pejgamberit-Mevludi, te populli ynë është e kahmotshme, dhe si e tillë me shekuj është festuar si në ambientet familjare ashtu edhe në ambiente e institucioneve fetare.

"Më lejoni që, në emrin e Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të institucioneve dhe organeve të saj dhe në emrin tim personal, nëpërmjet këtij manifestimi t'ju uroj e t'ju përgëzoj për fillimin e aktiviteteve tona kushtuar lindjes së Pejgamberit tonë Muhamed Mustafasë alejhisselam. Këto manifestime për këtë vit i hapim pikërisht sot nga ky vend ku jemi tubuar që bashkërisht të rikujtojmë ardhjen e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s..

Prandaj, në këtë natë kaq madhështore e shumë domethënëse, le ta madhërojmë Allahun dhe të kërkojmë bekimet e Tij, kurse përshëndetje, salate e selame, le t'i dërgojmë Pejgamberit të Tij të fundit, Muhamedit a.s., familjes së tij dhe të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Kiametit"- tha Myftiu Tërnava

Më pas, ai tha se ky manifestim sivjet bëhet edhe më i begatë, sepse në mesin tonë kemi një mysafir të veçantë, e kemi kryetarin e DIJANET-it të Turqisë, prof.dr. Ali ef. Erbashin, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, të cilët na kanë nderuar me praninë e tyre dhe këtë manifestim e kanë bërë edhe më madhështor dhe janë bërë bashkë me ne për të kujtuar jetën, veprën dhe misionin e të Dërguarit, Muhamedit a.s....

Më pas, një fjalë rasti mbajti edhe kryetari i Dijanetit të Turqisë dr. Ali Erbash, i cili veç tjerash u shpreh se është i lumtur që po ndodhet për vizitë në Kosovë dhe si mysafir i BIRK-ut në Muajin e Mevludit. Kjo ngjarje është e veçantë për të gjithë ne. Rinia, gjithashtu është ardhmëria e një populli, është mundësia dhe pasuria më e madhe.

Shumica e atyre që iu përgjigjën ftesës së Pejgamberit për pranimin e Islamit në kohën më të vështirë në Mekë, përbëhej nga të rinjtë...

"Ndryshimet dhe zhvillimet e shpejta që po ndodhin në kohët moderne, si informacioni, komunikimi, transporti etj., janë duke e vështirësuar edhe më tepër punën e të rinjve, dhe në anën tjetër janë duke i lenë ata të dobët përballë rrjedhojave aktuale. Kështu që, ndër përgjegjësitë më të mëdha që kemi është që për veten tonë, të ardhmen dhe ahiretin, t'u prijmë në të drejtë dhe në të mirë rinisë. Që t'i bashkojmë me vlerat e besimit dhe qytetërimeve"- tha Myftiu Erbash.

Më pas u këndua pjesë nga mevludi nga Selim Buzolli, ilahi në gjuhën shqipe, arabe e turke, recitale, kurse duanë dhe lutjen në gjuhën arabe e bëri sekretari i përgjithshëm i BIRK-ut Resul Rexhepi. (R.S.)

Komandanti i KFOR-it, uroi zgjedhjen e Naim Tërnavës si Myfti i Kosovës

Prishtinë, 27 tetor 2018

Komandanti i KFOR-it, Salvatore Couci, ka uruar kryetarin e sapozgjedhur të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiun Naim ef. Tërnava për mandatin e ri.

Reisululemaja i BFI-së, Haxhi Sulejman Rexhepi uroi Myftiun Naim Tërnava

Prishtinë, 29 tetor 2018

Me rastin e zgjedhjes së Myftiut Naim Tërnava në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Reisululemaja i BFI-së ka dërguar një telegram urimi për Myftiun Tërnava.

"Ndiejmë kënaqësi të veçantë që organet përkatëse të BIK-ut, që përfaqësojnë të gjithë myslimanët e Republikës së Kosovës kanë vlerësuar angazhimin tuaj të deritanishëm në krye të këtij institucioni duke jua besuar edhe mandatin e radhës, gjë që gjithsesi është rezultat i sukseseve tuaja në zhvillimin e jetës fetare-islame në Republikën e Kosovës", thuhet në urimin e Reisululemasë së BFI-së. Krejt në fund, Reisululemaja luti Zotin Fuqiplotë që Myftiut Tërnava t'i japë shëndet dhe t'i ndihmojë në rrugën e hairit, drejt sukseseve të reja. (R.S.)

Sekretari i përgjithshëm i Ligës Botërore Islame uroi Naim Tërnavën me rastin e zgjedhjes si Myfti i Kosovës

Prishtinë, 29 tetor 2018

Sekretari i përgjithshëm i Ligës Botërore Islame, dr. Muhamed bin Abdulkerim el Isa, ka uruar për zgjedhjen e Naim ef. Tërnavës si Myfti i Kosovës. Ai në urimin e tij ka lutur Zotin që t'i ndihmojë në këtë përgjegjësi të madhe që ka. "Duke u lutur që Zoti të ju ndihmojë në këtë përgjegjësi të madhe, për të cilën e keni vërtetuar me veprat tuaja se jeni meritor për këtë detyrë", thuhet në urimin e sekretarit Muhamed bin Abdulkerim elIsa. (R.S.)

Dekani i FSI-së, së bashku me stafin akademik uruan Myftiun NaimTërnava

Prishtinë, 29 tetor 2018

Dekani i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, z. Fahrush Rexhepi së bashku me stafin akademik të këtij fakulteti uruan Myftiun Naim ef. Tërnava për zgjedhjen edhe për një mandat në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Dekani Rexhepi në emër të profesorëve dhe të stafit akademik uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri, me lutjen te Zoti që të ketë mbarësi dhe punë të bereqetshme. (R.S.)

Koordinatori pranë Zyrës për Çështje Fetare, vizitoi Bashkësinë Islame të Kosovës

Prishtinë, 29 tetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava priti në takim koordinatorin e Zyrës për Çështje Fetare, z. Furkan Avci. Ky i fundit uroi Myftiun Naim Tërnava për zgjedhjen e tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. (R.S.)

Kryetari i KMSH-së Skënder Bruçaj në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 31 tetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar Haxhi Skënder Bruçaj, i cili në emër të KKMSh-së uroi Myftiun Tërnava me rastin e zgjedhjes në krye të BIRK-ut.

Ai më këtë rast i dëshiroi Myftiut Tërnava shëndet dhe sukses duke lutur të Madhin Zot që t'i ndihmojë për realizimin e synimeve të përcaktuara si dhe për intensifikimin e bashkëpunimit të shkëlqyer që kanë dy komunitetet.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnava falënderoi kryetarin e KMSH-së, Skënder Bruçajn, për vizitën dhe shprehu gatishmërinë që BIRK-u dhe KMSh-ja edhe më të shtojnë bashkëpunimin në të mirë të popullit në mënyrë që proceset kombëtare dhe ato të administrimit fetar t'i shpiejnë përpara. (R.S.)

Kryetari i Malishevës Ragip Begaj në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 31 tetor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Malishevës, Ragip Begajn dhe kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Malishevës, Xhevat Kryeziun.

Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, në emër të Komunës së Malishevës, i uroi Myftiut Tërnava për zgjedhjen në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke shprehur bindjen se Komuna e Malishevës sikurse edhe më parë do të ketë marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë me Bashkësinë Islame të Kosovës për të mirën e qytetarëve të vendit.



Myftiu Tërnava falënderoi kryetarin Ragip Begaj për vizitën dhe shprehu gatishmërinë që bashkërisht të punojnë për t'i çuar proceset përpara. (R.S.)

Një delegacion i lartë nga Dijaneti i Turqisë në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 2 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti një delegacion të lartë nga Dijaneti i Turqisë, i kryesuar nga drejtori i Përgjithshëm për Marrëdhënie me Jashtë, z. Erdal Atalay. Drejtori Atalay përcolli urimet dhe përgëzimet më të sinqerta të kryetarit të Dijanetit të Turqisë, z. Ali Erbash-it, drejtuar Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavës, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ai uroi që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Dijanetit të Turqisë të vazhdojë edhe më tutje.

Erdal Atalay solli edhe telegram urimin e kryetarit të Dijanetit të Turqisë Ali Erbash, në të cilin thuhet:

I nderuari
Naim Tërnava,
Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës,
Me Emrin e Allahut Mëshiruesit
Mëshirplotit

Lajmin për zgjedhjen tuaj në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, pas zgjedhjeve të mbajtura me 27 tetor të vitit 2018, në Prishtinë, e morëm me shumë kënaqësi.

Me përzgjedhjen e grupit të votuesve prapë jeni në krye të një detyre shumë të rëndësishme, me përgjegjësi të lartë, të cilën deri më tani e keni kryer me shumë dinjitet, në shërbim të vëllezërve tanë besimtarë në Kosovë dhe dëshirojmë që bashkëpunimin e deritashëm mes institucioneve tona ta forcojmë edhe më.

Me këtë rast, më lejoni që personalisht t'ju uroi ju, Kryesinë e Bashkësisë Islame me të gjitha institucionet vartëse të saj për zgjedhjen tuaj, duke lutur Allahun e Madhërishëm që t'ju japë suksese e mbarësi. Lutemi që kjo zgjedhje t'u sjellë mirësi në rend të parë besimtarëve në Kosovë, Botës Islame dhe mbarë njerëzisë, në përgjithësi.

Me nderime dhe respektin më të përzemërt,

Prof. dr. Ali Erbash
Kryetari i Dijanetit të Turqisë

Reisululema i BFI-së, Haxhi Sulejman Rexhepi në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 7 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava priti në takim Reisululemanë e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Haxhi Sulejman Rexhepin. Reisululemaja uroi në emrin e tij personal, si dhe në emrin e Rijasetit të BFI-së, Myftiun Tërnava për zgjedhjen edhe për një mandat në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke lutur Zotin e Madhëruar që t'i japë shëndet dhe punë të suksesshme në udhëheqjen e BIRK-ut. Ai shprehu bindjen se bashkëpunimi vëllazëror dhe konstruktiv ndërmjet dy institucioneve do të vazhdojë edhe më tutje. Nga ana e tij, Myftiu Tërnava falënderoi Reisululemanë, Haxhi Sulejman Rexhepin për vizitën dhe urimet, duke shprehur gatishmërinë që institucioni i BIRK-ut dhe ai i BFI-së, do të shtojnë edhe më bashkëpunimin ndërmjet tyre për të mirën e popullit. (R.S.)

Kryetari i Fushë Kosovës Burim Berisha në vizit urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 7 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava priti në takim kryetarin e Fushë Kosovës, z. Burim Berishën. Kryetari Berisha e uroi Myftiun Tërnava për zgjedhjen në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës edhe për një mandat, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Nga ana e tij, Myftiu Tërnava falënderoi kryetarin Berisha për urimet dhe shprehu gatishmërinë që të bashkëpunojnë edhe më tej në të mirë të qytetarëve të vendit. (R.S.)

Arban Abrashi në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 7 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim deputetin e Kuvendit të Kosovës, z. Arban Abrashin. Deputeti Abrashi uroi Myftiun Tërnava për zgjedhjen në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe e përgëzoi atë për punën e deritanishme. Ndërkaq, Myftiu Tërnava falënderoi deputetin Abrashi për urimet dhe shprehu gatishmërinë që të punojnë të gjithë së bashku në të mirë të qytetarëve. (R.S.)

Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 7 nëntor 2018

Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Osman Havolli vizitoi Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, në të cilën u mirëprit nga Myftiu Naim ef. Tërnava. Kryetari Havolli e uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri në krye të institucionit të BIRK-ut, duke i uruar mbarësi dhe punë të suksesshme. Myftiu Tërnava e falënderoi kryetarin Havolli për vizitën dhe për urimet. (R.S.)

Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame të Kosovës në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 8 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti për urime udhëheqësen e Departamentit të Gruas në Bashkësisë Islame të Kosovës, znj. Vaxhide Podvorica-Bunjakun, e cila shoqërohej nga anëtaret e tjera të këtij departamenti. Znj. Bunjaku, në emrin e anëtarëve të Departamentit e uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri, duke i dëshiruar mbarësi dhe punë të begatshme në udhëheqjen e institucionit të BIRK-ut.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnava i falënderoi anëtaret e Departamentit të Gruas dhe kërkoi nga to që të vazhdojnë edhe më të punojnë për të ngritur dhe fuqizuar pozitën e femrës kosovare. (R.S.)

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 8 nëntor 2018

Kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnava, prit në takim kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, z. Xhafer Tahirin.

Kryetari Tahiri e falënderoi Myftiun Tërnava për mikpritjen si dhe e uroi atë për mandatin e ri në krye të institucionit të BIRK-ut, duke i dëshiruar suksese dhe punë të mbarë.

Ndërkaq, Myftiu Tërnava, e falënderoi kryetarin Tahiri për vizitën, si dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton, që bashkëpunimi i ndërsjellë mes BIRK-ut dhe Komunës së Vushtrrisë të vazhdojë edhe më tutje. (R.S.)

Kryetari i Dragashit Shaban Shabani në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 9 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava priti në takim kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Shaban Shabanin.

Myftiu Tërnava fillimisht i uroi mirëseardhje, e më pas e njohu edhe me punën dhe angazhimet e institucionit që ai drejton. Nga ana e tij, kryetari Shabani e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, si dhe e uroi atë për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Në fund, që të dy u pajtuan që të intensifikojnë edhe më shumë bashkëpunimin në të mirë të qytetarëve. (R.S.)



Kryetari i PD-së, z. Ferid Agani në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 9 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Partisë së Drejtësisë, z. Ferid Aganin, i cili ishte i shoqëruar edhe nga anëtarët e tjerë të kryesisë së kësaj partie.

Myftiu Tërnava i uroi mirëseardhje dhe e falënderoi për vizitën kryetarin Agani, e më pas e njohu edhe me angazhimet dhe punët e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kryetari i Partisë së Drejtësisë z. FeridAgani, e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, si dhe e uroi atë për zgjedhjen edhe për një mandat si Myfti i Kosovës, duke i uruar shëndet dhe punë të mbarë. (R.S.)

Diaspora uroi Myftiun Tërnava

Albanisch Islamischer Verband
Bashkësia Islame Shqiptare
Fédération Albanais de l'Islam
Associazione Albanese Islamic

Prishtinë, 9 nëntor 2018

Me rastin e zgjedhjes së Naim ef. Tërnavës, si Myfti i Republikës së Kosovës, me një telegram urimi kanë uruar edhe diaspora shqiptare, më konkretisht Bashkësia Islame Shqiptare e Zvicrës dhe Unioni i Qendrave Islame Shqiptare në Gjermani.

"Me rastin e zgjedhjes suaj si Myfti i Kosovës, më lejoni që, në emrin tim personal t'ju uroj, duke lutur Allahun e Madhërishëm që t'ju ndihmojë në punën dhe angazhimet tuaja të mëdha që keni para vetes. Ne jemi shumë të interesuar dhe të përkushtuar që të bashkëpunojmë ngushtë me Bashkësinë Islame të Kosovës, ndaj mbesim me shpresë se bashkëpunimi ynë do të jetë i vazhdueshëm", thuhet në telegramin e urimit të kryetarit të Bashkësisë Islame Shqiptare të Zvicrës, z. Fehim Abazit. (R.S.)

Kryesia e BIK-ut mbajti mbledhjen e parë pas zgjedhjeve

Prishtinë, 10 nëntor 2018

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e parë pas zgjedhjeve të mbajtura në tetor, nga të cilat dolën forumet dhe udhëheqësi i Bashkësisë Islame të Kosovës për periudhën 2018-2023. Në fillim të mbledhjes, Myftiu Naim ef. Tërnava, i cili siç dihet u zgjodh në krye të BIK-ut edhe për një mandat, falënderoi forumet e BIK-ut për besimin e dhënë që të drejtojë për periudhën vijuese 2018-2023. Ai po ashtu përgëzoi anëtarët e rinj të Kryesisë së BIK-ut për marrjen e besimit për të qenë pjesë e Kryesisë së BIK-ut. Myftiu Tërnava kërkoi nga anëtarët e Kryesisë që në përputhje me kompetenca që ua jep Kushtetuta e BIK-ut të kontribuojnë për mbarëvajtjen e jetës fetare dhe të angazhohen që të bëjnë e të japin më të mirën në funksion të misionit që u është ngarkuar e besuar nga Kuvendi i BIK-ut. Kryesia e BIK-ut, po ashtu, shqyrtoi edhe një sërë lëndësh nga kompetencat e saj kushtetuese dhe mori vendime përkatëse. (R.S.)

Kryetari i Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë uroi Myftiun Tërnava

Prishtinë, 12 nëntor 2018

Kryetari i Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë (ALKIG), z. Vahidin Behluli, nëpërmjet një telegrami, ka uruar Myftiun Naim ef. Tërnava, me rastin e zgjedhjes në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Në urimin e tij thuhet:

"Përmes këtij telegrami shfrytëzoj rastin që, në emrin tim personal dhe në emër të Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë ALKIG, t'ju uroj për zgjedhjen tuaj Myfti i Bashkësisë Islame të Kosovë. Ne jemi të bindur se përvoja juaj në udhëheqjen e BI-së së Kosovës është faktor shumë i fuqishëm për stabilitetin, mbarëvajtjen, dhe zhvillimin e mëtejmë të BI-së së Kosovës, si dhe për organizimin e jetës fetare në Kosovë. Ne ju falënderojmë për përkrahjen tuaj të pakursyer deri më tash dhënë komunitetit tonë këtu në Austri dhe njëherësh jemi të përkushtuar për bashkëpunim të ndërsjellë edhe në të ardhmen. Urojmë të keni shëndet, lehtësi për udhëheqje dhe shumë suksese në punën dhe angazhimet tuaja në krye të BI-së së Kosovës". (R.S.)

Kryetari i Drenasit, z. Ramiz Lladrovci vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 13 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovcin. MyftiuTërnava i uroi mirëseardhje dhe e falënderoi për vizitën kryetarin Lladrovci, e më pas e njohu atë me angazhimet dhe punët e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe kërkoi që bashkëpunimi ndërmjet BIRK-ut dhe Komunës së Drenasit të vazhdojë edhe më tutje për të mirën e qytetarëve. Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, si dhe e uroi atë për mandatin e ri si Myfti i Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. (R.S.)

Kryetari i Komunës së Shtimes Naim Ismalji në vizitë urimi te Myftiu Tërnava



Prishtinë, 13 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Komunës së Shtimes, z. Naim Ismajlin.

Myftiu Tërnava fillimisht i uroi mirëseardhje kryetarit Ismajli, e më pas e njohu atë me punën dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Nga ana e tij, kryetari Ismajli, e falënderoi për pritjen dhe e uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i dëshiruar mbarësi dhe suksese.

Që të dy u pajtuan që edhe më tej të vazhdohet bashkëpunimi ndërmjet BIRK-ut dhe Komunës së Shtimes në të mirë të qytetarëve. (R.S.)

Unioni i Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër uroi Myftiun Tërnava

Prishtinë, 13 nëntor 2018

Unioni i Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër, në emër të kryetarit të tij, hfz. Mehas Alija, të kryesisë dhe të të gjithë xhemateve shqiptare që veprojnë në kuadër të UBISHZ-së, uron Myftiun, Naim ef. Tërnava për zgjedhjen e sërishme për kryetar të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës. Po ashtu, urimet ua përcjellim të gjithë të zgjedhurve të rinj në kryesi të BIRK-ut. Ne shpresojmë që strukturës së re të BIRK-ut, Allahu t'u falë shëndet dhe mbarësi në punën dhe angazhimin e tyre në këtë mandat. Myftiut të nderuar, Naim ef. Tërnavës, i dëshirojmë shëndet, punë të lehtë dhe shumë suksese në këtë mision fisnik. Ngelim me shpresë se bashkëpunimi ynë, si dy institucione, do të vazhdojë edhe më tutje të jetë i dobishëm në të mirë të fesë dhe kombit tonë. Allahu xh.sh. qoftë me ju dhe me popullin e Republikës së Kosovës! (R.S.)

Kryetari i Komunës së Deçanit Bashkim Ramosaj uroi Myftiun Tërnava



Prishtinë, 14 nëntor 2018

Kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim kryetarin e Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosajn, i cili shoqërohej nga kryetari i KBI-së së Deçanit z. Rasim Bytyqi me staf. Myftiu Tërnava i uroi mirëseardhje dhe e falënderoi për vizitën kryetarin Ramosaj, e më pas e njohu atë me angazhimet dhe punët e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe kërkoi që bashkëpunimi ndërmjet BIRK-ut dhe Komunës së Deçanit të vazhdojë edhe më tutje për të mirën e qytetarëve.

Z. Ramosaj e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen, si dhe e uroi atë për mandatin e ri si Myfti i Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme, duke theksuar se kanë një bashkëpunim shumë të mirë me KBI-në në Deçan dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. (R.S.)

Ambasadori Shaban Murati në vizitë urimi te Myftiu Tërnava

Prishtinë, 15 nëntor 2018

Kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim, z. Shaban Muratin, Ambasador Karriere, i shoqëruar nga z. Mehdi Gurra, drejtor i Përgjithshëm i Fondacionit "Alsar" dhe z. Beqir Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike.

Myftiu Tërnava fillimisht u uroi mirëseardhje mysafirëve dhe i falënderoi ata për vizitën, e më pas i njohu me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Nga ana e tij, z. Shaban Murati, e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe e uroi atë për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i dëshiruar mbarësi dhe punë të suksesshme. (R.S.)



Myftiu Tërnava bashkëbisedoi me nxënësit e medresesë "Alauddin" në Prishtinë

Prishtinë, 15 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnava në ambientet e medresesë së mesme "Alauddin" në Prishtinë bashkëbisedoi me nxënësit e medresesë. Me leximin e bukur të disa ajeteve kuranore nga nxënësi Gentrit Osmani, drejtori i medresesë mr. Jakup ef. Çunaku i uroj mirëseardhje Myftiut dhe në emrin e shkollës e uroi për zgjedhjen në pozitën e Kryetarit të BIRK-ut edhe për një mandat. Pastaj, drejtori hapi bisedën me Myftiun duke kërkuar nga ai të ndajë disa përvoja personale duke qenë si ish-medreseist, pastaj mësimdhënës e drejtor i medresesë për disa vjet.

Myftiu Naim ef. Tërnava shpreh kënaqësinë e tij që ishte në medrese duke shtuar se kjo shkollë në çdo kohë dhe rrethana ka dhënë kontributin e vet për edukim fetar e atë kombëtar. Ai porositi nxënësit që edhe me tej të angazhohen në mësimin e drejtë të parimeve fetare nga bankat e kësaj shkolle, duke shtuar kujdesin se edukimi jo i drejtë fetar sjell pasoja të mëdha për shoqërinë njerëzore, sikur që tani jemi dëshmitarë të zhvillimeve të ndryshme gjithandej botës. "Së bashku dhe me ndihmën e Zotit të bëjmë shumë që të ndërtojmë këtë shoqëri tutje, me vlerat tona kombëtare e fetare dhe ne do të jemi akterë të rëndësishëm në të ardhmen brenda trojeve tona, Ndaj vlerat tona si morali, respekti, nderi, besa e shumë të tjera nuk duhen anashkaluar asnjëherë"- tha Myftiu Tërnava. Njëherit Myftiu i uroj nxënësit me rastin e muajit rebiulevvel, duke udhëzuar nxënësit që ta kenë shembull praktik figurën e Muhamedit a.s. dhe mësimet e tij. Më pas nxënësit e medresesë shtruan disa pyetje për të fituar dituri dhe dëgjuar nga përvoja e Myftiut Tërnava. (R.S.)

Myftiu Tërnava priti në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë

Prishtinë, 19 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Jan Braathu.

Myftiu Tërnava fillimisht i dëshiroi mirëseardhje ambasadorit Braathu, e më pas e njohu me organizimet dhe aktivitetet që po zhvillon BIRK-u. Ai po ashtu tha se kane një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë dhe se promovojnë vlera të respektit, dialogut ndërfetar, si dhe paqe ndërmjet besimeve. Ai çmoi edhe raportet shumë të mira që kanë me OSBE-në, sidomos në fushën e dialogut ndërfetar në Kosovë. (R.S.)

Myftiu Tërnava priti në takim përfaqësuesit e Bankës Islame për Zhvillim

Prishtinë, 20 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim përfaqësuesit e Bankës Islame për Zhvillim, z. Atiq Ahmad dhe z. Ahsanul Kibria. MyftiuTërnava fillimisht u uroi mirëseardhje dhe shprehu falënderimet e sinqerta për vizitën, e më pas i njohu ata me funksionimin dhe punët e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai falënderoi përfaqësuesit e bankës për bashkëpunimin e deritanishëm dhe kërkoi nga ta që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje. Nga ana e tij, z. Atiq Ahmad, falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtutjeshëm. Ai gjithashtu uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri në krye të institucionit të BIRK-ut, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. (R.S.)

Myftiu Tërnava ishte për ngushëllime në familjen Shala në Ponesh të Gjilanit

Prishtinë, 21 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, vizitoi për ngushëllime familjen Shala në fshatin Ponesh të Gjilanit pas aksidentit të datës 16 nëntor 2018, në të cilin humbën jetën katër anëtarë të kësaj familjeje. Me këtë rast, Myftiu Tërnava shprehu ngushëllime në emrin e tij personal dhe në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vdekjen e katër anëtarëve të kësaj familjeje, duke lutur Allahun e Madhëruar që ata t'i ketë graduar me gradë të lartë të Xhenetit, ndërsa familjarëve Zoti t'u japë sabër dhe gajret që ta kalojnë me lehtësi këtë ndarje nga më të dashurit e tyre. (R.S.)

Myftiu Tërnava priti në takim drejtoreshën e shoqatës "Down Syndrome Kosova"

Prishtinë, 21 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim drejtoreshën e shoqatës "Down Syndrome Kosova", znj. Sebahate Beqirin, e shoqëruar nga kryeimami i Këshillit të Bashkësisë Islame të Podujevës z. Bekim Jashari.

Myftiu Tërnava fillimisht i dëshiroi mirëseardhje mysafires, e më pas e njohu me organizimin dhe punën e BIRK-ut, me theks të veçantë aktivitetet bamirëse që ka ky institucion në ndihmë të shoqërisë.

Drejtoresha e shoqatës, znj. Sebahate Beqiri, falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen. Ajo foli rreth punës dhe angazhimit të kësaj shoqate, duke theksuar mënyrën e bashkëpunimit dhe ndihmës që mund të ofrojë BIRK-u për këtë kategori të shoqërisë.

Myftiu Tërnava tregoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton, që të përkrahet dhe të mbështetet kjo organizatë, në mënyrë që edhe ata individë ta ndiejnë veten se janë pjesë e shoqërisë dhe të mos lihen në harresë, ngase kanë nevojë që të ndihmohen prej nesh si shoqëri, në mënyrë që të promovohen, respektohen dhe të mbrohen të drejtat e kësaj kategorie të shoqërisë. (R.S.)

Myftiu Tërnava priti në takim përfaqësuesin rajonal të Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar

Prishtinë, 22 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim përfaqësuesin rajonal të Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar me seli në Sarajevë z. Klement Mahmud. Myftiu Tërnava e falënderoi z. Mahmud për vizitën dhe për bashkëpunimin institucional ndër vitesh me zyrën e Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar në Kosovë.

Ndërkaq, z. Klemen Mahmud, e falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për bashkëpunim në çështje të rëndësishme në fushën humanitare, si dhe e uroi atë për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. (R.S.)

Myftiu Tërnava priti në takim drejtorin e Fondacionit "Maarif" në Kosovë, z. Mesut Ozbaysar

Prishtinë, 22 nëntor 2018

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim drejtorin e Fondacionit "Maarif" në Kosovë z. Mesut Ozbaysar. Myftiu Tërnava pasi i dëshiroi mirëseardhje mysafirit, e njohu atë me aktivitetet që po zhvillon BIRK-u, në jetën fetare, si dhe theksoi marrëdhëniet e mira që ka BIRK-u me Fondacionin "Maarif".

Nga ana e tij, drejtori i Fondacionit "Maarif" në Kosovë z. Mesut Ozbaysar, theksoi se deri më tani kanë pasur një bashkëpunim shumë të mirë me BIRK-un, si dhe uroi që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje në të ardhmen. Ai po ashtu uroi Myftiun Tërnava për mandatin e ri në krye të BIRK-ut, duke i dëshiruar shëndet dhe suksese në punë. (R.S).

Bashkësisë Islame të Kosovës i dhurohen dy makina për shërbimet mortore

Prishtinë, 8 nëntor 2018

Unioni i Komunave të Turqisë, përmes një donacioni, ka dhuruar për Bashkësisë Islame të Kosovës dy makina, të cilat do të shërbejnë për kryerjen e shërbimeve mortore. Në këtë ceremoni të pranimdorëzimit të çelësave të këtyre makinave, e cila u mbajt në oborrin e xhamisë "Sulltan Mehmet Fatih" në Prishtinë, morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ambasadorja e Turqisë në Kosovë, znj. Kivilicim Kiliç, zëvendësdrejtori gjeneral i Hënës së Kuqe të Turqisë, z. Ismail Haki Turu, sekretari i Unionit të Komunave të Turqisë, z. Ahmed Kazan, si dhe kryetarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Prishtinës dhe të Gjilanit, këshillat e të cilëve do të jenë përfitueset e para të këtyre makinave.

Në fjalën e tij, sekretari i Unionit të Komunave të Turqisë, z. Ahmed Kazan, tha se ndihet i kënaqur që sot gjendet në mesin tonë. "Unë ua përcjell përshëndetjet më të sinqerta të kryetarit të Unionit të Komunave të Turqisë. Ne kemi respekt dhe dashuri për gjithë Ballkanin, por Kosova përbën një rast më unik dhe më të veçantë, ngase dashuria për popullin e Kosovës është më e madhe dhe më e posaçme. Shteti ynë ka një bashkëpunim të mirë me shte-

tin e Kosovës, por dëshira e madhe është që ky bashkëpunim të shtohet edhe më, në të mirë të dy vendeve", tha mes të tjerash z. Kazan.

Zëvendësdrejtori gjeneral i Hënës së Kuqe, z. Ismail Haki Turu, tha se me këto makina ne sollëm edhe shpirtin tonë së bashku. "Si anëtar i Kuvendit Komunal dhe si anëtar i Hënës së Kuqe, gjithmonë jam ndier i kënaqur kur kam punuar për popullin e Kosovës, porse ardhja ime në Kosovë, me jep një kënaqësi më të veçantë. Edhe pse jemi dy vende larg njëra-tjetrës, afërsia mes dy vendeve ekziston", tha ndër të tjerash Ismail Haki Turu.

Para të pranishmëve me një fjalë rasti u paraqit edhe ambasadorja e Republikës së Turqisë në Kosovë, znj. Kivilicim Kiliç, e cila shprehu falënderimet e veçanta për të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në këtë projekt. Ajo ndër të tjerash përmendi faktin se "Ky projekt dëshmon aferësinë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Pra nuk është vetëm me fjalë, por edhe me vepër. Turqia gjithmonë ka qenë afër popullit të Kosovës dhe me kënaqësi themi se bashkëpunimi dhe ndihma dhënë Kosovës do të vazhdojë edhe me tutje."

Ndërkaq, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, falënderoi në emrin e tij personal, në emrin e BIRK-ut, si dhe në emrin e gjithë besimtarëve të Kosovës popullin mik turk për ndihmën që ka dhënë në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova. "Të kthehemi në retrospektivë, para 550 vjetëve, e të kujtojmë në mendjet tona stërgjyshërit, të cilët e ndërtuan këtë xhami, që ne jemi sot në të, e të kujtojmë se përmes djersës së punës së tyre, ata lidhën një hallkë të fortë, e cila nuk do të shkëputet deri në Kiamet. Faleminderit Unionit të Komunave! Zoti jua dhëntë të gjitha të mirat! Zoti na bashkoftë edhe më shumë mes vete!", përfundoi fjalën e tij Myftiu Tërnava.

Në fund u bë edhe pranimdorëzimi i çelësave të këtyre makinave, të cilat nuk do të jenë të fundit në vazhdën e këtij aktiviteti. (R.S.)

Urimet dhe vizitat me rastin e zgjedhjes së Myftiut të Kosovës Naim ef. Tërnava për mandatin e ri

Në vijim paraqesim këshillat e BIK-ut që ishin për urim te Myftiu Tërnava:

KBI-ja e Istogut me imamë
KBI-ja e Bujanocit me imamë
KBI-ja e Mitrovicës me imamë
Këshilli i BI-së i Ferizajt me imamë
Këshilli i BI-së i Preshevës me imamë
Këshilli i BI-së i Klinës me imamë
Këshilli i BI-së i Prishtinës me imamë
Këshilli i BI-së i Pejës me imamë
Këshilli i BI-së i Obiliqit me imamë
Këshilli i BI-së i Podujevës me imamë
Këshilli i BI-së i Gjakovës me imamë
Këshilli i BI-së i Kaçanikut me imamë
Këshilli i BI-së i Drenasit me imamë
Këshillii BI-së i Prizrenit me imamë
Këshilli i BI-së i Vushtrrisë me imamë
Këshilli i BI-së i Gjilanit me imamë
Këshilli i BI-së i Shtimes me imamë
Këshilli i BI-së i Lipjanit me imamë
Këshilli i BI-së i Suharekës me imamë
Këshilli i BI-së i Kamenicës me imamë
Këshilli i BI-së i Deçanit me imamë
Këshilli i BI-së i Vitisë me imamë
Këshilli i BI-së i Rahovecit me imamë
Këshilli i BI-së i Dragashit me imamë
Këshilli i BI-së i Fushë Kosovës me imamë
Këshilli i BI-së i Malishevës me imamë

Nga medreseja "Alauddin"

Drejtori i medresesë së mesme "Alauddin" mr. Jakup Çunaku me stafin e mësimdhënësve dhe stafin e administratës
Koordinatori i medresesë së mesme "Alauddin" në Prizren Ramadan Uka me disa profesorë
Një grup i profesoreshave nga medreseja "Alauddin", paralelja në Prizren
Drejtoresha e konviktit të vajzave të medresesë së mesme "Alauddin", znj. Medina Gashi, së bashku me edukatoret
Profesoreshat e medresesë së mesme "Alauddin" (R.S.)

Kryeimami Bajgora mbajti ligjëratë në Xhaminë e Madhe të Ferizajt

Prishtinë, 20 nëntor 2018

Për nder të muajit të Mevludit, KBI i Ferizajt, mbajti manifestimin kushtuar ditëlindjes së Pejgamberit a.s.. Manifestimi u mbajt në xhaminë e madhe "Mulla Vesel Guta", në të cilën para të pranishmëve ligjëroi kryeimami i Republikës së Kosovës Sabri ef. Bajgora. Fillimisht të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua kryetari i Këshillit z. Bujar Hasani, i cili uroi për këtë muaj, duke e veçuar ditën e lindjes së Pejgamberit a.s., si një nga ditët më të rëndësishme. Më pas ligjëratën kryesore e mbajti kryeimami Bajgora, i cili tha se jemi ymet fatlum që jemi pasuesit e Pejgamberit a.s., të cilin Allahu e dërgoi në kohën kur njerëzimi kishte humbur çfarëdo ndjenje të besimit të pastër në Zotin e Madhëruar. "Ky Pejgamber erdhi si lutje e Ibrahimit a.s., i cili në Mekën e bekuar luti të Madhërishmin: "Dërgoju pejgamber nga mesi i tyre", pastaj erdhi si përgëzim i Isait i cili tha: "Pas meje do të vijë një pejgamber që do të quhet Ahmed". Sado që përpiqemi të themi fjalë, e kemi të vështirë të përzgjedhim fjalët e duhura, ngase ai nuk ishte një njeri i thjeshtë, por ishte i dërguar i Zotit, i Cili e zgjodhi atë që të jetë rahmet për gjitha krijesat. Zoti në Kuran, në shumë ajete e lavdëroi dhe e ngriti në piedestalin më të lartë të ahlakut Pejgamberin a.s", tha kryeimami Bajgora.

Ai gjithashtu foli edhe për rëndësinë dhe vlerën e salavateve kushtuar Pejgamberita.s., saqë Pejgamberi a.s. në një hadith ka thënë: "Ai që bie salavat mbi mua një herë, Allahu do të bjerë mbi të salavat 10 herë". Më pas, programi vazhdoi me pjesën kulturo-artistike, me Kuran, ilahi, si dhe pjesë nga mevludi. Mevlude janë paraparë të mbahen, ditëve të tjera në vijim, në xhamitë e tjera të komunës së Ferizajt. (B. Z)

Kryeimami Bajgora mbajti ligjëratë në Sallën e Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec

Prishtinë, 23 nëntor 2018

Me rastin e shënimit të Muajit të Mevludit, Këshilli i BI-së i Rahovecit, mbajti manifestim kushtuar këtij muaji në Sallën e Kulturës "Mesur Zyberaj" në Rahovec. Ky manifestim filloi me leximin e ajeteve të Kuranit, ndërsa më pas një fjalë rasti mbajti kryetari i KBI-së së Rahovecit z. Shani Sylka, i cili përshëndeti të pranishmit dhe uroi për këtë muaj, duke e veçuar këtë si një muaj të rëndësishëm në kalendarin islam, pasi në këtë muaj lindi krijesa më e mirë që shkeli në tokë.



Ligjëratën kryesore e mbajti kryeimami i Republikës së Kosovës z. Sabri Bajgora, i cili tha se fjalët janë të pafuqishme për të shprehur madhështinë e Pejgamberit a.s. "Lindja e tij erdhi si burim frymëzimi i shumë gjeneratave të kaluara dhe të sotme, erdhi në kohën kur prangat e skllavërisë kishin mbërthyer zemrat e robëruara të njerëzimit, erdhi atëherë kur çdo ndjenjë e moralit ishte venitur. Më në fund, në mesin e një bote të shprishur e të pashpresë, lindi dielli i të gjithë pejgamberëve, i cili ngrohi zemrat e atyre që ishin në amulli e mjegull", tha Bajgora.

"Përshkrimin më të denjë të Muhamedit a.s. e gjejmë në Kuran, në të cilin Allahu tregon vlerat më të mirëfillta me të cilat përshkruhet një qenie njerëzore. Allahu në Kuran thotë: "Ju në të dërguarin e Allahut keni shëmbëlltyrën më të mirë." (El Ahzab, 21). Personaliteti i tij paraqet baraspeshë të materies dhe shpirtërores, aftësisë dhe diturisë, ai arriti që fjalën e Zotit ta aplikonte më së miri në jetë", shtoi ndër të tjerash kryeimami Bajgora. Manifestimi u përmbyll me një program kulturo-artistik me ilahitë të kënduara nga vëllezërit Allajbeg. (R.S.)

Dua Hatme në fshatin Zaplluxhe të Dragashit

Dragash, 20 tetor 2018

Në xhaminë e fshatit Zaplluxhe të Komunës së Dragashit, me datë 20 tetor 2018, u mbajt duaja e hatmes së Kuranit për nxënësit e vijues mësim besimit, e organizuar nga imami i tyre Nail ef. Sinani.

Ishin 14 nxënës që mësuan leximin e Kuranit nga imami i tyre, i cili pa kursyer nga koha dhe mundi i tij, për 2 vjet arriti që këtyre nxënësve të moshave të ndryshme tua mësoj leximin e Kuranit.

Nxënësve ju dhanë certifikata nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame Dragash.

Nxënësit që bënë hatme janë: Fjolla Mehmeti, Vjollce Emini, Alejna Kamberi, Yllka Shemsidini, Romina Myrtezani, Riga Myrtezani, Rreze Myrtezani, Hira Fetahu, Elma Ahmeti, Medine Maliqi, Edina Hajdari, Arta Hyseni, Elvir Azizi dhe Delila Sinani.

(Xhafer Fejziu)

Haxhi Gani Saramati, e ndërton minaren e dytë të xhamisë

Më datë 03.08.2018, pas namazit të xhumasë, banorët e fshatit Mirëz (ish-Dobrusht), e bën përurimin e minaresë së dytë të xhamisë. Investitor i vetëm i kësaj minare madhështore është haxhi Gani Saramati me djemtë e tij, nga i njëjti fshat, donacion nga biznesi i tyre në Slloveni. Në tubim, bashkë me shumë qytetarë e hoxhallarë të kësaj ane, mori pjesë edhe kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mr. Besim ef. Berisha, i cili, në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, e falënderoi haxhi Ganiun dhe djemtë e tij për ndërtimin e kësaj minare, si dhe për kontributin e vazhdueshëm për interesin e përgjithshëm.

Vlen të përmendet se haxhi Gani Saramati, në vitin 2005, e ka ndërtuar xhaminë, përfshirë edhe minaren e parë. Po ashtu, ai ka kontribuar në asfaltimin e rrugës së fshatit, si dhe ka ndërtuar disa shtëpi për të varfrit, në regjionin e Prizrenit.

Fshati Mirëz i Prizrenit, relativisht është i vogël. Ai, gjendet në kilometrin e dytë të Autostradës Vërmicë – Merdare, në anën e majtë të rrugës së kombit, afërsisht 1.5 km në thellësi. Banorët e këtij fshati, që shtrihet pranë kufirit shqiptaro-shqiptar, kanë kontribuar mjaftë shumë për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

El-hamdulilah, edhe një minare – bukuroshe më shumë, për të gjithë ata që hyjnë në Kosovë, nga jugu i saj.

E lusim Allahun e Madhërishëm, që të gjitha veprat e mira të kësaj familjeje, t'ua pranojë për sevap dhe t'i shpërblejë me mirësitë e Tij, në këtë botë dhe në ahiret….! (O. Bislimaj)

Këshilli i Bashkësisë Islame i Pejës

Shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

Imam, hatib dhe mualim në xhamitë e fshatërave:
Qyshk - Pejë
Leshan - Pejë
Poqestë - Pejë
Raushiq - Pejë
Kryshec - Pejë
Jabllanicë e madhe - Pejë
Drelaj - Rugovë - Pejë

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. *Të kenë të kryer Medresenë, FSI-në ose Fakultetin e Studimeve Islame jashtë vendit (diploma e vërtetuar nga Kryesia);*
2. *T'u përmbahen Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, rregulloreve e vendimeve të Kryesisë dhe rregullores e vendimeve të Këshillit;*
3. *Të kenë aftësi komunikuese dhe organizative për çështje fetare;*
4. *Të jenë të shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;*
5. *Të mos kenë vërejtje në punë, nëse paraprakisht kanë qenë të punësuar;*
6. *Të kenë iniciativë dhe kreativitet në punë;*
7. *Të jenë nënshtetas të Republikës së Kosovës*

Dokumentet e kërkuara:

Krahas kërkesës për punësim, duhen bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- *Diploma e Medresesë dhe e Fakultetit;*
- *Certifikata e lindjes;*
- *Certifikata shëndetësore;*
- *Certifikata se nuk është nën hetime ose i dënuar;*
- *Vërtetimi për përvojën e punës;*
- *Deklaratë me shkrim se ka për t'i kryer të gjitha shërbimet fetare;*
- *CV – ja, të dhënat personale, kualifikimet ose dëshmitë për aftësim profesional;*
- *Letërnjoftimi (fotokopje)*

Të gjitha dokumentet të jenë në origjinal!

Vërejtje:

Dokumentet dorëzohen në zyrën e Këshillit të KBI-së së Pejës.

Dokumentet e pakompletuara, si dhe ato që arrijnë pas afatit të paraparë, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në revistën "Dituria islame".

Këshilli i Bashkësisë Islame i Gjakovës

Shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës:

Arkëtar në KBI të Gjakovës

Kandidati i interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. *Të ketë të kryer Medresenë, FSI-në ose Fakultetin e Studimeve Islame jashtë vendit (diploma e nostrifikuar nga Kryesia e BIRK-ut);*
2. *T'u përmbahet Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, rregulloreve të Kryesisë dhe vendimeve të saj dhe rregullores së Këshillit dhe vendimeve të tij;*
3. *Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi;*
4. *Të jetë i shëndoshë psikikisht dhe fizikisht;*
5. *Të mos ketë vërejtje për punën e tij, nëse paraprakisht ka qenë në punë;*
6. *Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në KBI;*
7. *Të ketë njohuri të punës me kompjuter.*

Dokumentet e kërkuara:

Krahas kërkesës për punësim duhen bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- *Diploma e Medresesë dhe e Fakultetit;*
- *Certifikata e lindjes;*
- *Certifikata shëndetësore;*
- *Certifikata se nuk është nën hetime as i dënuar;*
- *Vërtetimi për përvojën e punës;*
- *Deklarata me shkrim se ka për t'i kryer të gjitha shërbimet;*
- *CV – ja, të dhënat personale, kualifikimet ose dëshmitë për aftësim profesional.*
- *Dokumenti i identifikimit (fotokopje).*

Të gjitha dokumentet të jenë në origjinal!

Vërejtje: Dokumentet dorëzohen në zyrën e KBI-së në Gjakovë.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të paraparë, nuk do të merren në shqyrtim.

Të ardhurat personale realizohen sipas rregullores së KBI-së.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në revistën "Dituria islame".

AUTOR: AGIM GASHI	NEPER KATRORE, PAS SHENJËS, SHKRUANI EMRIN E MBIEMRIN E KRYETARI TË BIK-ut	A.N.	HEQJA E MAZËS	BURIMI, GURRA	REPER SPANJOLL, REY GARCIA	VENDI I TË PARËVE TANË (pashq.)			DY ZANORE	AZOTI	NXËNËS I SHKOLLËS USHTARAKE	GË KA DITURI, E MENÇUR	PJESË E MPREHTË E THIKËS	ILAÇ	SHUMË E MADHE
SHTYLLË E BESMIT							NJË NGA SAHABËT E MUHAMEDIT a.s.	PYETJET PËR OPINIONE / SHOSHA							
BANORE E NJË KRAHINE SHQIPTARE										NJERIU I PARË / N.M.I.					
SKICA, PIKTURA									VËREHET / ILIA DHIMITRI						
SHOOK (lv.)				BEKIMET / EDUKIMI									NOTE MUIZIKORE / I NJË PARTIE POLITIKE		
SHIFRA B					I RENDITUR									AZOTI / MË I MADH I MUNDSHËM	
ZANORJA E TRETË		JUNIOR / SHENJË NË TRUP									BARAZIM NË SHAH				
	NGJESH / ATO GË JANË FAVORITE											JO SHUMË / I PJERRËT			
F.U.			INDIA / IRNOSEM								GJERSA				
OLJETAR (arab.)											INSTITUTI I PAVARUR STUDENTOR				AJËR (ang.)
5 ROMAK		RIJEKA / VEPËR E VERDIT									ISH-PRESID. SHQIPTAR, RAMIZ				
TRI ZANORE				ANIMACIONET							AGIMI (dim.)				
PËRPUTHJA E VARGJEVE NË FUND TË VARGUT											OKËS				
IDENTITET			NORVEGJIA / SABRI KIÇMARI								NATIONAL ACADEMIC LEAGUE				MIKU, SHOKU
LLOJ ENE UJI					HERDI DRENICAK, LATI (shq.)	PËRPILIM	BLETË KRYESORE	PESHA E ENËS (sh.shq.)		DOMENI I GJERMANISË	KyÇ / HAPËSIRA DIELLORE			XHAULI / PJESË E SHKOGUR E FJALIMIT	
ENERGJIA		VEGËL PUNE (sh.shq.) / AFËRSI							MBIN / PËREMËR PRONOR				DISA / PJESË E KËMISHËS		
TANTALI			VENDET KU SUNDOJNË IMAMËT / Ë.M.K.									EMËR I HUAJ M. / EMNAK I MIRËS			
	MOSHË E RE / ADEM DEMAÇI									E PESHOVA / LLOJ KRJIMI LETRAR					
SHTET NË EUROAZI							BANOR I SHBA-së / ZANORE								
TREGIMET ME DIKTAT									KUSARI						

“ËSHTË Ë VËRTETË SE

ALLAHU

DHE **ENGJËJT E TIJ**

ME MADHËRIM E MËSHIROJNË

PEJGAMBERIN.

O JU QË KENI BESUAR,

MADHËROJENI PRA ATË

(DUKE RËNË SALAVATE)

DHE PËRSHËNDETENI

ME SELAM.”

(El Ahzab: 56)